


Pranuar me Primitjeve	14.09. 20 22	
Njesia Jedinec	Numri E-01	Shtojca Dodatak
15-052/01-49600		



KOMUNA E LIPIJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN



R A P O R T
I PUNËS I ZYRËS SË KRYETARIT DHE
DREJTORATEVE KOMUNALE
JANAR – QERSHOR
2022

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit.....	3
Përmbledhje Ekzekutive.....	5

ZYRA E KRYETARIT

1. Zyra e Protokollit	5
2. Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore	5
3. Avokatja Publike Komunale	6
4. Sektori për Marrëdhënie me Publikun	8
5. Njësia për Auditim të brendshëm	9
6. Sektori i Personelit	10
7. Sektori pronësor – juridik	13
8. Zyra Lokale për Komunitete	14

DREJTORATET KOMUNALE

1. Drejtorati për Administratë.....	15
2. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	19
3. Drejtorati për Arsim	27
4. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport	36
5. Drejtorati për Buxhet dhe Financa	38
6. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim	45
7. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.....	47
8. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.....	48
9. Drejtorati për Infrastrukturë	50
10. Drejtorati për Inspeksion.....	52
11. Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.....	55
12. Drejtorati i Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.....	57
13. Drejtorati i Prokurimit.....	59

FJALA HYRËSE E KRYETARIT

Të dashur qytetarë të Komunës së Lipjanit,

I nderuar kryesues i Kuvendit Komunal,

Të nderuar këshilltar, media e ju të pranishëm,

Më lejoni që para jush ta prezantoj raportin gjashtë mujor të punës së zyrës sime dhe të drejtorateve komunale.

Sigurisht që në raport janë të prezantuara në mënyrë të detajuar rezultatet e arritura, vështirësitë dhe sfidat që na kanë përcjell në punën tonë.

Para se të ndalëm në disa pika që ja vlen të përmenden në fjalën time hyrëse, dua të ua rikujtoj se kjo periudhë por edhe në atë të cilën gjendemi është një ndër më të vështirat që po kalojmë si vend, ku inflacioni dhe krizat e vazhdueshme ekonomike e socio-ekonomike që po godasin Republikën e Kosovës dhe jo vetëm, kanë reflektuar e po vazhdojnë të reflektojnë edhe në punën tonë si ekzekutiv komunal.

Pavarësisht kësaj mund të them me përgjegjësi të plotë se ne kemi arritur që gjatë kësaj periudhe gjysmë vitin 2022 ta përmbyllim me sukses ashtu edhe qysh e kishim planifikuar në planin tonë të punës.

Në vazhdimësi jemi angazhuar që të gjithë qytetarëve lipjanas t'iu ofrojmë kushte dhe shërbime sa më cilësore. Jam i kënaqur me rezultatin e arritur nga Komuna e Lipjanit, ku performanca e mirë në zbatim të ligjit dhe transparencës e llogaridhënies, ka bërë që Lipjani të renditet si komuna e dytë në nivel vendi dhe nga kjo renditje kemi fituar grant në vlerë prej mbi 1 milion euro (1,021,108.38).

Një ashtu komuna jonë është përfituese edhe e 422,351.00 eurove, donacionit nga GIZ – Gjerman, për skemën “Gara për Mjedis të Pastër” si dhe përfituese e dy kamionëve për grumbullimin e mbeturinave.

Për ne nuk janë të rëndësishme vetëm projektet në vlerë monetare, por edhe projektet që krijojnë standard të qëndrueshme dhe që ndihmojnë komunën në ndërtimin e kapaciteteve tona humane për një periudhë afatgjatë. Ndihem mirë që jemi në mesin e tetë komunave të përzgjedhura nga USAID, për implementimin e projektit “Integriteti i Komunave të Kosovës”, projekt ky që do të implementohet në periudhën e ardhshme 5 vjeçare (2022 - 2027).

Në gjashtë mujorin që lamë pas, një rëndësi e vaçant i është kushtuar funksionalizimit të Zonës Ekonomike në Qytagë, një zonë mjaft e rëndësishme për zhvillimin ekonomik jo vetëm për komunën e Lipjanit po edhe më gjerë. Vlenë të theksohet se është proceduar dhe aprovuar në Kuvendin Komunal propozim vendimi për fillimin e procedurave për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në këtë zonë dhe presim që shumë shpejt të kemi biznese që do të fillojnë aktivitetin e tyre aty.

Edhe në vitin 2022 kemi vazhduar me subvencionimin e Klubeve Sportive dhe këto klube do të gjejnë përkrahje të vazhdueshme në Komunën e Lipjanit. Janë subvencionuar gjithësej 19 Klube Sportive në vlerë prej mbi 100 mijë euro. Gjithashtu gjatë këtij gjashtë mujori kemi financuar edhe botime të librave si dhe aktivitete të ndryshme kulturore dhe rinore.

Gjate kësaj periudhe ndonëse për shkak të ngritjes së çmimeve punimet kanë stagnuar në disa projekte që kanë qenë në vazhdim nga vitet paraprake, kemi mbikqyrjen, dinamiken dhe ecurinë e punimeve në projektet siç janë: Objekti i Administratës së Komunës, objekti i palestrës sportive në Lipjan, rruga “Marie Shllaku” deri në fshatin Rufc, rruga Lipjan-Rubovc, rrugët në lagjen e Akllapit, Asfaltimi i rrugicave në Rubovc, Janjevë, Akllap, Rufc, Banullë, Zllakuqan, Krojmir dhe Vërshevc faza II.

Disa projekte janë duke i zhvilluar punimet në teren, disa të tjera janë në përfundim të punimeve, ndërsa projekte të tjera të planifikuara në kuadër të investimeve kapitale për vitin 2022, janë kontraktuar dhe pritet fillimi i punëve në ditët në vazhdim.

I nderuar kryesues,

Të nderuar këshilltar komunal dhe

Ju të dashur qytetarë,

Konstatoj se në aktivitetet tona objektiv e përhershme mbetet qeversija e ligjshme, transparente dhe llogaridhënëse. Mirëpo çdo herë periudhat raportuese reflektohen edhe me sfida të ndryshme që kemi para vetës.

Më lejoni ta mbyll fjalën time duke e ripotencuar edhe në fund, krizën e inflacionit të lartë që po përballemi i gjithë vendi si dhe pasojat e COVID19 të cilat e kanë vështirësuar skajshmërisht jetën e qytetarit, ky edhe mbetet shqetësimi yni i lartë pavarësisht që ne si ekzekutiv komunal i kemi kompetencat e limituara fatkeqsisht nga ato qëndrore, por unë i siguroj qytetarët e Lipjanit se gjithmonë dhe në çdo kohë jemi duke punuar për të përmirësuar jetën e çdo personi në këtë komunë, kjo ka qenë është dhe do të mbetet objektivi im parësor.

Imri Ahmeti

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport për periudhën janar - qershor 2022, paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara nga Kryetari i Komunës dhe qeverisja lokale. Raporti është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportim të Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Edhe në këtë periudhë Janar - Qershor 2022, angazhimi kryesor i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale ka qenë përkushtimi për zbatimin e rendit, ligjit dhe dicitelnes në punë. Në vazhdim po e paraqesim raportin që përmban informata për punën e Zyrës së Kryetarit dhe të gjitha Drejtorateve dhe zyrave në kuadër të komunës.

ZYRA E KRYETARIT

ZYRA E PROTOKOLLIT

RËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Zyra e protokollit gjatë periudhës raportuese janar – qershor 2022 është angazhuar maksimalisht për organizimin sa më të mirë të të gjitha aktiviteteve të organizuara nën patronatin e Kryetarit të Komunës si dhe organizimin e takimeve të ndryshme.

Zyra e Protokollit në Komunën e Lipjanit ka kryer këto punë:

- Organizimin e takimeve protokollare të kryetarit të komunës;
- Evidentimin dhe mbikqyrjen e takimeve të kryetarit të komunës;
- Organizimin e takimeve të kryetarit me qytetarët e komunës së Lipjanit;
- Organizimin e një takimi publik ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale;
- Bashkëpunim me drejtoratet e komunës për aktivitetet e organizuara nën patronatin e kryetarit.

SEKTORI PËR PËRFAQËSIM DHE ÇËSHTJE LIGJORE

Përmbledhje e përgjithshme e raportimit

Gjatë periudhës raportuese vazhdimisht është bërë përcjellja e dispozitave ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës.

Sipas kërkesave të Drejtorateve të administratës komunale dhe sektorëve të komunës janë dhënë këshilla juridike në përgatitjen e akteve nga kompetenca.

Gjatë tërës periudhës raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform dispozitave ligjore në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi

Për lëndët e adresuara Kryetarit të Komunës nga kompetenca e Drejtorateve dhe e Zyrës së Kryetarit është udhëzuar nëpunësi për dorëzimin e shkresave që lëndët t'i dërgojnë Drejtoratet përkatëse ndërsa lëndët e Zyrës së Kryetarit të përpunuesit sipas kompetencës.

Punët dhe aktivitetet e realizuara (implementuara) gjatë periudhës raportuese

Gjatë periudhës janar-qershor 2022, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore pa lëndët e përfaqësimit nga kompetenca e Avokates publike komunale me kërkesë të Kryetarit ka përgatitur Vendime, Urdhëresa, Shkresa të ndryshme,

Marrëveshje, Kontrata, Propozim Rregullore dhe PropozimVendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës të cilat i kemi specifikuar në tabelën në vijim:

Statistikat

Aktet e përgatitura nga Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore për periodën janar-qershor 2022:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendimet	<u>177</u> vendime (62 vendime me karakter të përgjithshëm, ndërsa 115 vendime me karaktertë jo të përgjithshëm personal-individual)
2.	Shkresat	192
3.	Kontrata	19
4.	Marrëveshje	440
5.	PropozimRregullore	1
6.	PropozimVendime	38

AVOKATJA PUBLIKE KOMUNALE

Përmbledhje e përgjithshme e raportimiti:

Sipas lëndëve të pranura nga zyra për pranimin e lëndëve dhe të regjistruara në regjistrin e lëndëve Avokatja Publike Komunale, brenda afatit të kërkuar bën këtë raport të punës me sa vijon;

Lëndë të bartura nga vitet paraprake janë 1428 lëndë, ndërsa të pranura deri më datë 30.06.2022 janë 161 lëndë. Në procedurë kanë qenë gjithsej 1589 lëndë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë të përfunduara 84 lëndë.

Në procedurën administrative kemi bashkëpunuar me të gjitha drejtoratet komunale për sigurimin e provave materiale për seancat gjyqësore dhe kompletimin e lëndëve, por kemi dhënë edhe ndihmë juridik kur kanë kërkuar drejtoratet përkatëse.

Punët dhe aktivitetet e realizuara:

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 266 seanca gjyqësore, kemi ushtruar 45 ankesa, 133 përgjigje në padi në procedurë civile, procedurë përmbartuese kemi ushtruar 8 prapësime dhe 3 ankesa në procedurë përmbartimore.

Si palë e dëmtuar kemi marr pjesë në seancat gjyqësore në procedurë penale duke propozuar që kërkesa pasurore juridike të realizohet gjatë të njëjtës procedure për dëmin e shkaktuar për se cilën lëndë veq e veq.

Statistikat:

Paraqesë skemën tabelave të lëndëve në procedura të ndryshme dhe atë me sa vijon:

Nr.	Llojet e procedurave	Lëndë të bartura	Lëndë të Pranuar	Nr. i përgjithshëm i lëndëve	Lëndë në Gj.Th.P-Dega ne Lipjan – P.Privat	Lëndë në Gjykatë Apelit	Lëndë në Gjykatë Suprem	Lëndë Poedur Administrative	Lëndë të Kryera	Lëndë në Procedurë
1.	Procedurë penale	10	0	10	/	/	/	/	0	10
2.	Procedurë civile	1249	138	1387	1285	45	3	/	54	1333
3.	Procedurë përmbarese	139	22	161	159	2	/	/	46	115
4.	Procedurë administrative	19	2	21					20	1
5.	Gjithsejtë	1417	162	1579	1444	47	3		104	1459

Gjatë kësaj periudhe të raportimit kanë vazhduar në procedurë civile për lëndët e ish „Kosovatransit“ janë 10 lëndë që kërkojnë kompensimin e të ardhurave personale prej vitit 1990 deri 1999 duke u bazuar në Aktit për pranim dorëzim të ish „Kosovatransit “ në mes të AKP-së dhe Komunës së Lipjanit të nënshkruar në vitin 2012 dhe shuma e kërkuara për të gjitha lëndët është 113,335.43 €, e krejt kjo është si pasoj e pranimit të NP „Kosovatrans“ në Lipjan sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike dhe aktit të cekur më lart, lidhur me këtë çështje në procedurë është edhe një lëndë me numër të përgjithshëm të punëtorëve prej 83 punëtorë të cilët kërkojnë kthim në punë dhe kompensim e të ardhurave personale nga viti 1990 deri 1999.

Në konteste civile janë 1387 lëndë prej tyre janë fituara 34 lëndë, 3 lëndë janë kontest pune në shumën e përgjithshme mbi 59'000.00 €, 4 janë në pronësi, një „Kosova trans“ për kompensimin e pagave nga viti 1992 deri 1999 në vlerë prej 16,968.00 €, të tjerat janë kompensime dëmi në shumën e përafërt prej prej 85,000.00 €.

Në procedurë përmbarese deri me 30 Qershor 2022 janë gjithsejtë 161 lëndë prej tyre janë ekzekutuara 46 lëndë, ndërsa të pa ekzekutuar janë 115 lëndë dhe borxhi i mbetur i Komunës–debitorit deri ne këtë fazë mund të jetë mbi 280,000.00€+ kamata dhe shpenzimet e procedurës i cili borxh është i punëtorëve të arsimit – DKA, punëtorëve të shëndetësisë, shpronësim dhe Operatorë Ekonomik.

Në procedurë penale i kemi dërguar mbi 80 aktgjykime MBZHR - Agjencisë së Pyjeve të Kosovës dhe tani ky agjencion është duke ekzekutuar këto lënd me përmbareues privat por ende nuk kemi informatë se a janë përfunduar apo janë ende në procedurë.

Çështje tjetër që ende ka mbetur të rregullohet është edhe çështja e zjarrfikësve në mes të Komunës dhe MPB-Agjencinë e Emergjencës së Kosovës nga se është i pa definuar mire statusi i tyre se punëtorë të kujt janë, ndërsa Komuna pritët që për se cilin punëtor-zjarrfikës ti paguan përafërsisht nga 5,000 € për punën gjatë festave, ndërrimin e natës, fundjavës dhe shtesat tjera që po i kërkojnë shpenzimet e udhëtimit dhe shujtën.

Sfidat

Gjatë periudhave raportuese të kaluara por edhe kësaj periudhe, kanë qenë sfida kryesore që edhe kanë paraqitur problem gjatë mbrojtjes ligjore të interesave të Komunës, mungesa e dokumentacioneve nga arkiva dhe mangësia, vështirësitë për gjetjen e dokumenteve arkivore të viteve të paraluftës.

Gjithashtu sfidë tjetër është e Kontratave kolektive të arsimit dhe shëndetësisë në të cilat Komuna nuk është fare nënshkruese e tyre por janë ministritë përkatëse, të cilat nuk kanë menduar fare për gjetjen e mënyrës së ekzekutimit të obligimeve që rrjedhin nga këto kontratë në procedurë administrative në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i komunave në procedurë gjyqësorë dhe të krijohen shpenzime të pa nevojshme.

SEKTORI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Përmbledhje e përgjithshme e raportimit

Sektori për Marrëdhënie me Publikun edhe përgjatë periudhës raportuese janar-qershor 2022 është angazhuar maksimalisht në realizimin e detyrave dhe përmbushjen e obligimeve në mënyrë që Komuna e Lipjanit të vazhdojë të jetë ndër të parat sa i përket transparencës dhe llogaridhënies.

Në web faqen zyrtare të Komunës janë publikuar material të ndryshme në mënyrë që qytetarëve tu ofrohen të dhënat e nevojshme. Kjo web faqe ka qenë edhe një udhëzim shtesë dhe transparent në të cilën janë publikuar të gjitha vendimet, shkresat, njoftimet, rregulloret, raportet e shpenzimeve financiare, kontrata, planifikimi i buxhetit, ndarja e subvencioneve si dhe shumë material të tjera.

Po ashtu, edhe gjatë këtij gjashtë mujorshi me një transparencë të plotë janë zhvilluar punimet e të gjitha seancave të Kuvendit, të cilat janë transmetuar në kanal zyrtarë të komunës në Youtube.

Punët dhe aktivitetet e realizuara (implementuara) gjatë periudhës raportuese

Gjatë periudhës janar – qershor 2022, Sektori për Marrëdhënie me Publikun ka kryer punët në vijim:

Është bërë përcjellja e aktiviteteve të kryetarit të komunës, aktiviteteve të tjera komunale Brenda dhe jashtë komunës dhe pastaj përgaditja e lajmeve për publikim në web faqen zyrtare, rrjetet sociale si dhe në media të ndryshme;

Sipas kërkesave të Drejtorateve dhe sektorëve të tjerë janë publikuar materialet e ofruara për zyrën e informimit;

Janë publikuar në web faqe të gjitha vendimet e kryetarit, të gjitha vendimet dhe rregulloret nga sektori i Kuvendit në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe; Publikimi i raportit të kryetarit, Publikimi i raporteve të drejtorëve për çdo muaj; Po ashtu janë publikuar në web faqe vendime, njoftime dhe konkurse të shumta të cilat janë ofruar në zyrën për informim; Konkursët me kërkesën e përgjegjës ve janë publikuar në gazetën ditore, po ashtu, është bërë publikimi i materialeve nga procedurat e prokurimit.

Gjatë kësaj periudhe janë vizituar të gjitha projektet që janë implementuar në terren dhe janë bërë fotografidhe video inqizime për nevoja të zyrës si dhe të njejtat janë arhivuar, janë ofruar informata për gazetarë duke ju referuar kërkesave të tyre si dhe janë pranuar dhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike si dhe punë të tjera që dalin në kuadër të zyrës për informim.

Statistikat

Sektori për Marrëdhënie me Publikun gjatë periudhës janar – qershor ka publikuar rreth 160 lajme në web faqen e Komunës, janë pranuar gjithësejtë 18 kërkesa për qasje në dokumente publike, ku 17 prej tyre u është lejuar qasja dhe një kërkesë është refuzuar pas interpretimeve ligjore që kemi pranuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi. Janë publikuar në web faqe raporti i kryetarit për vitin 2021 dhe plani i punës për vitin 2022, është bërë publikimi i mbi 46 vendimeve të kryetarit, janë publikuar 140 njoftime, 70 konkurse, 13 marrëveshje, 42 vendime të kuvendit, 1 rregullore dhe 1 plan, 8 shqyrtime publike, mbi 303 materiale të ndryshme nga aktivitetet e prokurimit (Kontrata 60), Publikimi i materialeve të kuvendit për 7 seancat, Procesverbale të kuvendit dhe komiteteve 15, Publikimi i raporteve dhe materialeve të buxhetit, raporti për Qasjenë Dokumente Publike për vitin 2021 si dhe material të tjera të ndryshme me interes për publikim.

Janë realizuar rreth 500 foto e video inqizime nga aktivitetet e ndryshme komunale.

Takimet e ndryshme

Janë zhvilluar takime të shumta me gazetarë nga mediet e ndryshme të shkruara dhe elektronike. Po ashtu takime janë zhvilluar edhe me përfaqësues të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që monitorojnë punën e Komunës së Lipjanit. Gjatë kësaj periudhe, takime kemi pasur edhe me qytetarë të cilët i janë drejtuar zyres sonë për informata rreth komunes.

Sfidat

Sfiduese mbeten problemet e shumta rreth mos funksionimit të web faqes zyrtare të komunës, problem këto që po e vështirësojnë shumë punën në zyrën për informim.

NJËSIA PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

Përmbledhje e përgjithshme e raportimit

Me aprovimin e ligjit mbi kontrollin dhe menaxhimin financiar me të cilin ishte ndryshuar koha e dorëzimit të planit vjetor të punës në Ministrinë e Financave pas aprovimit nga Komiteti i Auditimit dhe Kryetari i Komunës, në Muajin Dhjetor 2021 është përpiluar Plani Strategjik Trevjeçar për vitet 2022-2024, me planin strategjik janë paraparë të gjitha fushat e Auditimit të cilat duhet të mbulohen me aktivitete Audituese nga NJAB për një cikël trevjeçar të Auditimit, duke i renditur sipas shkallës së Rrezikut për çdo fushë si dhe duke i paraparë fushat me rrezik të lartë për çdo vit në fushëveprim të Auditimit .

Pas vlerësimit të rrezikut për secilën fushë të identifikuar, është bërë rangimi i detyrave të punës të cilat janë auditive të rregullta të planifikuara, duke u bazuar në shkallën e rrezikut për fushat e identifikuar në Planin Strategjik dhe kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore të cilat i ka Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Nga plani strategjik 2022-2024 , është bazuar Plani vjetor i punës i NJAB-së për vitin 2022 me qëllim të planifikimit të Auditimeve efektive për vitin 2022. Pra, janë planifikuar detyrat e punës për çdo entitet që do të auditohet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas rangimit të prioriteteve në planin vjetor të punës .

Angazhimi i NJAB në gjashtëmuorin e parë ka pasur për synim realizimin e Auditimeve të planifikuara sipas planit të punës të aprovuar për vitin 2022 dhe kryerjen e rishikimeve për auditimet e kryera , pasi që drejtorët e drejtorive ku është kryer auditimi kanë përgatitur plane të veprimit për implementimin e rekomandimeve , ndërsa NJAB pas rishikimit ka përgatitur informatë me shkrim me të cilën ka njoftuar edhe ZKA - në lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve nga NJAB.

Punët dhe aktivitetet e realizuara (implementuara) gjatë periudhës raportuese

1. Auditimi i Procedurave të Prokurimit për vitin 2021.
2. Auditimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë për periudhën Shkurt 2021-Janar 2022, në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa.
3. Auditimi i të hyrave nga ngarkesat dhe tarifat për shfrytëzim të pronave komunale në DHP dhe DZHE .
4. Auditimi i procedurave të shpenzimeve në Drejtorinë e Shëndetësisë –QKMF .
5. Auditimi i përdorimit të menaxhimit të veturave zyrtare në Administratën Komunale.

Të gjitha raportet finale pas pranimit të planit të zbatimit nga përgjegjësit e drejtorateve ku është kryer Auditimi, u janë dorëzuar përmes arkivit drejtorëve të drejtorateve përkatëse dhe zyrës së kryetarit, si dhe janë dërguar për tu shqyrtuar në komitetin e Auditimit në periudha tremujore .

Gjatë periudhës Janar –Qershor 2022, NJAB, përmes rishikimeve të auditimeve ka monitoruar edhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve të cilat janë dhënë me rastin e kryerjes së auditimeve të brendshme dhe për të cilat menaxhmenti (zyrtarët përgjegjës të entiteteve ku është kryer auditimi), ka përgatitur planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të NJAB-së.

Në këtë periudhë janë kryer edhe pesë rishikime të auditimeve sipas orarit të paraparë për rishikim .

NJAB ka marrë pjesë edhe në përgatitjen e planit të zbatimit të rekomandimeve për rekomandimet e pranuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, si dhe ka kryer Rishikimin e progresit të zbatimit të rekomandimeve.

Statistikat

Gjatë gjashtë mujorit të parë, nga NJAB janë finalizuar pesë (5) Auditime të rregullta të planifikuara, janë përfunduar sipas planit vjetor të punës për vitin 2022,

Po ashtu janë kryer edhe gjashtë (6) Rishikime të Auditime të kryera më herët nga NJAB me qëllim të monitorimit të progresit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së dhe dërgimi informatave të shkruara përgjegjëse të entiteteve të audituara dhe menaxhmentit (kryetarit të komunës) lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve apo progresin e arritur.

Në mesin e rishikimeve të kryera ka qenë edhe rishikimi i kryer për planin e zbatimit të rekomandimeve i vitit 2021 për PVF të vitit 2020, të pranuar me raportin e ZKA –it , rishikim i dytë i cili është kryer para datës 31.03.2022, që i referohet një raportit nga viti paraprak.

Më datën 20.05.2022 pas pranimit të raportit final të Auditorit të Zyrës Kombëtare, brenda afatit prej 30 ditëve në Muajin Qershor 2022, në bashkëpunim me grupin për trajtimin e rekomandimeve dhe koordinatorin e grupit është përgatitur edhe Plani i Zbatimit të rekomandimeve të ZKA –it ,për rekomandime e pranuar nga auditori i jashtëm pas auditimit të PVF për vitin 2021. Ky Plan është dorëzuar me kohë në ZKA –it dhe këto rekomandime pritet të zbatohen gjatë vitit 2022.

Gjatë gjashtë mujorit të parë është mbajtur një trajnim më saktësisht në Muajin Qershor 2022me DEMOS –in, me temën Roli i Auditimit të brendshëm në organizatat buxhetore .

Takimet e ndryshme

Gjatë këtij gjashtë mujori janë mbajtur edhe dy takime të rregullta me Komitetin e Auditimit ku janë shqyrtuar puna e NJAB-së për periudhat TM4-2021 së bashku me Raportin Vjetor të punës së NJAB-së për vitin 2021, takim është mbajtur me komitetin në Muajin Janar 2021,Raporti për Tremujorin e parë 2022, (TM1-2022) , takimi është mbajtur në Muajin Prill 2022.

SEKTORI I PERSONELIT

Përmbledhje e përgjithshme e raportimit

Në kuadër të fushë veprimtarisë së saj dhe në përputhje me kornizat ligjore në fuqi, që përfshinë shërbimin civil dhe atë publik të Komunës së Lipjanit sektori për personel është angazhuar në kryerjen e punëve me përgjegjësi të plotë në hartimi e vendimeve dhe shkresave brenda fushëveprimit të Sektorit për Personel, vlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe koordinimin e trajnimeve të stafit, Rregullimin dhe digjitalizimin e dosjeve të stafit dhe futjen në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe në dosje personale, të tjera ndryshimet, transferimet, pagesat retroaktive, largimet bëhen nga Zyra e Personelit për Sistem të Pagave si dhe (kërkesa të ndryshme individuale të stafit: pushime, vërtetime)etj.

Punët dhe aktivitetet e realizuara (implementuara) gjatë periudhës raportuese

Sektorit për Personel ka sistemuar formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të zyrtarëve duke i vendosur nëpër dosje fizike dhe elektronike si dhe raportimin pranë MPB/MAP – it për përqindjen e vlerësimit, përgatitja e planit të trajnimit përvlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe koordinimin e trajnimeve të stafit duke ju drejtuar me një kërkesë të tillë MPB/MAP – it , punimi i vendimeve të ndryshme sipas kërkesave të palëve dhe zyrtarëve të

administratës komunale kërkesa të ndryshme individuale të stafit: pushime, vërtetime etj, si dhe përgatitja e formularëve për ndryshime, transferimet, pagesat retroaktive për Sistem të Pagave.

Statistikat

Për më shumë, në formë statistikore, gjeni të bashkangjitur një tabelë, pjesë e këtij raporti përmbljedhës.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Raporti 6 mujorJanar,Shkurt,Mars,Prill,Maj,Qershor	6
2	Tabela informuese për Antikorrupsion	1
3	Pushime mjekësore.	70
4	Pushime vjetore.	88
5	Vendim për pushim përdëllimi	1
5	Pushime mjekësorë Covid-19	4
6	Punimi i listës për dëshmi të vaksinimit Covid-19	1
7	Punimi i listës për pagesë për sistem të pagave për anëtarët e kuvendit	186
8	Punimi i listave për ardhje-shkuarje për Kulturë, Rini dhe Sport	3
9	Punimi i listave për ardhje dhe shkuarje për praktikant me pagës nga ministria	170
10	Publikimi i konkursit për Praktikantë me pagesë	129
11	Regjistrimi i kërkesave për praktikantë me pagesë	32
12	Punimi i listave për ardhje-shkuarje për praktikantë	16
13	Kërkesa për ID- kartela zyrtare	16
14	Punimi i formularëve për ndryshime	15
15	Pëlqimpër transferim të përkohshëmpër vendin e punës	1
16	Raporti i listave ardhje dhe shkuarje për punëtorët	15
17	Punimi i formularëve për punëtorët e larguar – drejtor	8
18	Punimi i formularëve për punëtore të rinj	20
19	Punimi i formularëve për transferim bankar	6
20	Punimi i formularëve për retroaktiv	11
21	Punimi i planit të punës dhe vlerësimi zyrtarëve komunal në SIMBNJ	13
22	Punimi i formularit me te dhënat për zyrtaret publik për MBPB	2
23	Përgjigje në Ankesë	16
24	Përgatitja e Kontratave për Praktikantë	32
25	Vërtetim për kryerjen e praktikës	3
26	Vërtetim për përvojë të punës për punëtorët	28
27	Vendime për kryerjen e praktikës	7
28	Vendim për Transferime	22
29	Pëlqim për Transferime	12
30	Printimi, shpërndarja dhe mbledhja e listave të pagave	220
31	Shkresa të ndryshme zyrtare për mes email-ve zyrtare	138
32	Vendim për Pushim të Lehonisë	3
33	Vendim për formimin e komisionit të përhershëm rekrutues	12
34	Vendime për përfundimin e marrëdhënies së punës me arritjen e moshës së pensionimit	2
35	Vendim për ndërprerje e marrëdhënies së punës	3
36	Raporti i listave ardhje dhe shkuarje për punëtorët	84
37	Kërkesa për aprovim të konkurseve	14
38	Punimi i përshkrimit të detyrave të punës	12
39	Punimi i formularëve për largim	3
40	Vendim për shkarkim	1
41	Vendim për emërim	6
42	Kompletimi i dosjeve me te dhëna personale sipas ligjit të ri	47
43	Vendim për pagë shtesë me rastin e pensionimit	2
44	Vendimin për lirim nga detyra	2
45	Njoftim për arritjen e moshës së pensionimit	4
46	Njoftim për përfundimin e procedurës brenda kategorisë në ZLK	6

47	Njoftime përfundimtare për kandidatin fitues	2
48	Punimi i formularëve për interviste	5
49	Njoftim për Komisionin Disiplinor	1
50	Ftese për Komision Disiplinorë	2
51	Vendim për anulim të konkursit për zyrtar i bibliotekës	1
52	Vendim për anulim të konkurseve të brendshme	2
53	Verifikimi paraprak i Aplikacioneve për pozitën e punës Zyrtar për Biblioteka	26
54	Verifikimi paraprak i Aplikacioneve për aprovim për pozitën e punës Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1, Zyrtar për Kadastër, Zyrtar për Shërbime me Qytetar dhe Zyrtar për Arkiv 1.	135
55	Verifikimi paraprak i Aplikacioneve për refuzim për pozitën e punës: Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1, Zyrtar për Kadastër, Zyrtar për Shërbime me Qytetar, Zyrtar për Shëndetësi dhe Zyrtar për Arkiv 1.	78
56	Vendim për refuzim të aplikacioneve për pozitën e punës: Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1, Zyrtar për Kadastër, Zyrtar për Shërbime me Qytetar, Zyrtar për Shëndetësi dhe Zyrtar për Arkiv 1.	78
57	Njoftim për përfundimin e periudhës provuese	2
58	Përgjigje në kërkesë që nuk kenë masa disiplinore	1
59	Njoftim për kryetarin për ekspert të jashtëm	1
60	Vendim për emërim të ekspertit të jashtëm	1
61	Kontratë Pune për Ekspert të jashtëm	1
62	Njoftim për Covid - 19	1
63	Njoftim për test me shkrim	26
64	Vendime për refuzim pas testim me shkrim	1
65	Njoftime për përfundimin e rezultateve të kandidatëve	9
66	Njoftim për pozitën e punës zyrtar leje ndërtimore	1
67	Njoftim për verifikim paraprak	21
68	Njoftim për publikimi të konkurseve të brendshme dhe të jashtëme	21
69	Njoftim për kandidatin e suksesshëm pas përfundimit të procedurës të rekrutimit për praninë dhe pas afatit të ankimimit	2
70	Kërkesa për aprovim të konkurseve të brendshme	3
71	Mbajtja e testit me shkrim dhe intervista për katër pozita: Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1, Zyrtar për Shërbime me Qytetarë, Zyrtar për Kadastër, Zyrtar për Arkiv 1	8
72	Kërkesë për mjete buxhetore për pagesë retroaktive	8
73	Verifikimi paraprak i Aplikacioneve për pozitën e punës udhëheqës i sektorit për Mirëqenie Sociale	1
74	Njoftim për test me shkrim dhe intervistë për pozitën e punës udhëheqës i sektorit për Mirëqenie Sociale	2
75	Kërkesa të ndryshme	7
76	Kërkesë për aprovim të konkursit lëvizje paralele	4
77	Përgjigjeje në Kërkesat e KPMK-së	9
78	Përgjigjeje në kërkesat e Avokatës Komunale	18
79	Përgjigjeje në Kërkesë DSHPS	2
80	Përgjigjeje në shkresa për masa disiplinore	2
81	Vendime për punë shtesë	1
82	Vendime për verifikim paraprak të procedurave të rekrutimit	6
83	Vendim për pagesë shtesë	3
84	Vendim për kthim në vendin e punës	3
85	Vendim për shfuqizim	2
86	Vendim për pushim të përdëllimit	3
87	Vendim me dorëheqje nga puna	1
88	Vendime për refuzim të aplikacioneve	7
89	Vendim për pushim të lehonisë	2
90	Vendim për pushim me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë	2
91	Vendime për Udhëtime Zyrtare	3
92	Vendime për formimin e komisionit rekrutues	4

93	Verifikimi paraprak i Aplikacioneve për pozitën e punës Zyrtar i Depos 1	19
94	Pëlqimi	1
95	Pëlqime për vendin e punës se punëtorëve	8
96	Punim i formularit për deklarim të rregullt vjetor të pasurisë 1 deri 31 mars 2021 në formular Excel	1
97	Shkresë njoftim për mbarim të funksionit të anëtarit të asamblesë së Kuvendit Komunal	1
98	Shkresë njoftim për emërim të funksionit të anëtarit të asamblesë së Kuvendit Komunal	1
99	Shkresë njoftim për të gjithë zyrtaret e lartë publik që nënshkruhen me marrjen e njoftimit për deklarim të pasurisë së rregullt	83
100	Pushim Martesor	2
101	Ftesa dy për Komisionin Disiplinor	2
102	Vendim për statusin e nëpunësve civil	43
103	Shkresa lidhur me njoftimin e zyrtarëve të lartë publik për deklarimin e pasurisë së rregullt muajin mars	46
104	Vendime për punë shtesë	3
105	Përgjigje në kërkesë	7
106	Përgjigje në shkresa të ndryshme zyrtare	4
107	Pushim i Atësisë	1
108	Publikimi i konkurseve për lëvizje paralele	6
109	Publikimi i konkursit në Shëndetësi dhe arsim	4
110	Kërkesë për Komision Disiplinor	3
111	Vendim për Autorizim	2
112	Kompletimi i lëndëve për Auditor të Brendshëm	32
113	Vendim për formimin e komisionit rekrutues	3
114	Ftese për Komision rekrutues për lëvizje brenda kategorisë	2
115	Sistemi i të dhënave Personale të zyrtarëve të Administratës Komunale në SIMBNJ	14
116	Imella zyrtare	108
117	Regjistri për dosjet personale	33
118	Regjistri për auditorët e jashtëm	1
119	Njoftim për vlerësim	15
120	Gjithsejtë	2441

SEKTORI PRONËSORO – JURIDIK

Përmbledhje e përgjithshme e raportimit

Sektori Pronoro – Jurudik në periudhën raportuese ka bërë përcjelljen e dispozitave ligjore të miratuara nga Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës.

Gjatë tërë periodes raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform dispozitave ligjore në fuqi janë përgatitur një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

Punët dhe aktivitetet e realizuara (implementuara) gjatë periudhës raportuese

Me kërkesë të Kryetarit janë përgatitur: Vendime, Pëlqime, Marrëveshje Bashkëpunimi, Propozim – Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës, dhe Shkresa të ndryshme nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

Statistikat

Aktet e përgatitur nga Sektori Pronësoro-Juridik, Janar-Qershor 2022:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Shkresa	71
2	Propozim-Vendim	3
3	Pëlqime	2
4	Vendime	8
5	Marrëveshje Bashkëpunimi	1
6	Kontratë	1

Sektori Pronësoro-Juridik gjatë periudhës raportuese mujet Janar-Qershor 2022 në procedurë administrative ka pranuar 105 lëndë.

ZYRA LOKALE PËR KOMUNITETE

Gjatë kësaj periudhe, ZKKK-ja, krahas aktiviteteve tjera të rregullta, ka punuar në zgjidhjen e problemit të familjeve të riadhesuara, punën me organizatat jo qeveritare, zgjerimin e akomodimit të familjeve të riadhesuara dhe ndihmën për krijimin e familjeve private.

Po ashtu kemi zhvilluar takime me ministri, kemi punuar në rregullimin e arkivit të ZKKK-së, kemi bërë vizita familjeve, janë ndarë 300 shportatë mbeturinave për komunitetin rom dhe ashkali donacion nga organizata VoRAE, kemi marrë pjesë në Komitetin për Komunitete dhe në KKS, si dhe pjesëmarrje në komisione të ndryshme dhe në tryeza diskutimi.

Është mbajtur takimi me "Advancing Together" në lidhje me informacionin e familjet e kthyer dhe braktisja e nxënësve të shkollave të mesme të komunitetit serb. Kemi marrë pjesë në seminarin e organizuar nga GIZ mbi menaxhimin e rrezeve në procesin e riintegrit të personave të riadhesuar. Me CARITAS kemi realizuar projektin për përgatitjen e Draft Planit të Veprimit për Riintegrim. Me CRPK kemi marr pjesë në trajnimin për rritjen e kapacitetit të institucioneve lokale në fushën e diskriminimit dhe rritjen e vetëdijes së komuniteteve pakicë dhe mundësitë e realizimit të të drejtave të njeriut

Kemi marrë pjesë në trajnimin për data bazën MZP. Kemi marrë pjesë në seminarin për legalizimin e objekteve banesore të organizuar nga VoRAE. Në organizim të CARITAS morem pjesë në tryezën me zyrat tjera nga rajoni i Prishtinës në lidhje me hartimin e Planit të Veprimit për riadhesim për periudhën 2023 – 2025. Kemi marrë pjesë në konferencat rajonale në organizim të KOSINT me temën fuqizimin e zyreve lokale komunale për komunitete dhe kthim. Është mbajtur takimi me përfaqësuesit e FSK-së në lidhje me konkursin për kadet. Kemi vizituar shtëpitë në Medvec të cilat janë ndërtuar për familjet e riadhesuara. Është përgaditur draft Plani i Veprimit për kthim të qëndrueshëm 2022 – 2025. Në organizimin e UNMIK dhe UNHCR është mbajtur takim rajonal me përfaqësuesit e MZP, Ministrise së Pushtetit Lokal, përfaqësuesit e komunave dhe shefat e zyrës për komunitete dhe kthim. Në vazhdimësi jemi angazhuar në zgjidhjen e problemeve të familjeve të riadhesuara.

DREJTORATET KOMUNALE

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME E RAPORTIT

Në periudhën gjashtë mujore të vitit 2022 në Drejtorin për Administratë janë realizuar detyra dhe obligime në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

Janë zhvilluar takime të rregullta, si dhe koordinimin e punëve me shefat e sektorëve, raporte të rregullta javore, mujore tek Kryetari i Komunës, takime në nivelin qendror në bazë të agjendave.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE

Përgjatë kësaj periudhe në bashkëpunim me menaxherët kemi bërë evidentimin e kontratave që skadojnë përgjatë këtij viti, e që janë të ndërlidhura me Administratën si dhe i kemi proceduar tutje për Planifikim të Prokurimit për vitin vijues si dhe janë bërë planifikime shtesë të nevojshme për Drejtoratin e Administratës.

Në sektorin për Administratë të Përgjithshme, në qendrën për shërbimi me qytetarë gjatë kësaj periudhe gjashtë mujor, ka pasur rritje të numrit të kërkesave në shërbimet me qytetarë, konkurs për praktikant si dhe konkurse në drejtoratin e arsimit. Në konkurset për rekrutim në shërbimin civil ka filluar të bëhet aplikimi në mënyrë elektronike. Gjatë kësaj periudhe janë kryer në mënyrë efikase dhe me korrektësi të gjitha shërbimet që janë ofruar drejtpërdrejt me qytetarë, si në regjistrimin e të gjitha shkresave të adresuar nga personat fizik dhe juridik në sistemin e intranetit.

Të gjitha shkresat e adresuar nga arkiva e MAPL -së për Komunën e Lipjanit janë regjistruar dhe protokolluar në sistem të intranetit, shkresa, konfirmime ligjore, njoftime etj.

Puna me komisione është në procedurë të vazhdueshme për arkivimin e lëndëve në bartjen për në komunë të re, në komisionin për koordinimin dhe procesit të lëndëve arkivore, zhvendosjen e stafit dhe inventarit të punës në objektin e ri të komunës.

Gjatë kësaj periudhe kemi qenë pjesë e punëtorisë e organizuar nga Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ), në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me temë “Praktikat e digjitalizimit dhe inovacionit në nivel lokal”. Qëllimi i këtij takimit ka qenë të diskutojë për rëndësinë e të dhënave të hapura (Open Data) në qeverisjen lokale për hartimin e politikave të bazuara në evidencë, si dhe problemet kryesore të cilat qytetarët dhe zyrtarët komunalë i hasin në komunën e tyre.

Asociacioni i Komunave të Kosovës në kuadër të koordinimit të objektivave dhe aktiviteteve në takimin e radhës të Kolegjiumit të Drejtorëve Komunal për Administrate Komunale në diskutimin e temave dhe shqetësimeve të adresuara nga autoritetet lokale, në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë të Kolegjiumit për fushën e administrimit lokal.

Është mbajtur një takim nga kolegji për administratë lokale, ku qëllimi i këtij takimit ka qenë formimi dhe funksionimi i kolegjiave për të ndihmuar në analizimin e çështjeve të pushtetit lokal, me qëllimin e përmirësimit të shërbimeve komunale. Në atë takim është diskutuar për funksionimin e dobët të Ueb faqeve Komunale, E-pasuria, Kontratat që janë të lidhur me AQP- në, E- Kiosku – pengesat në zbatimin e udhëzimit administrativ Nr. 01/2022 për dokumentet e gjendjes civile.

Takim një ditë organizuar nga Projekti DEMOS rreth hapjes së të dhënave komunale. Qëllimi i takimit ishte të sqarohet koncepti i hapjes së të dhënave dhe të vlerësohet gatishmëria e komunave në këtë proces.

Në sektorin e Gjendjes Civile gjatë këtyre muajve të gjitha shërbimet janë realizuar në mënyrë transparente, dhe me korrektësi me shërbime të shpejta të cilat janë dhënë për qytetarët.

Respektivisht në udhëzim administrativ (MPB) Nr.01/2022 për dokumentet e Gjendjes Civile, për përdorim brenda vendit lëshohen në letër të bardhë standarde të formatit A4, ndërsa dokumentet e Gjendjes Civile për përdorim jashtë vendit lëshohen në letër të veçantë sipas specifikave të përcaktuara nga Agjencia e Regjistrimit Civil, ashtu siç janë lëshuar deri më tani.

Po ashtu edhe ndryshimi i procesverbalit i pranimit të atësisë/amësisë nuk është më dokument i Gjendjes Civile, i cili duhet t'i lëshohet qytetarit, ky dokument përdoret për procedurat e brendshme të Gjendjes Civile, dokument i cili

mbahet në dosjen e qytetarit, si dhe Dëshmia e Vdekjes më nuk lëshohet nën mbikëqyrjen apo autoritetin e Agjencisë së Regjistrimit Civil, respektivisht të Drejtoratit të Gjendjes Civile, ky dokument tani e tutje lëshohet në një formular me logon e Komunës tonë.

Në Sektorin për punë të Kuvendit dhe komiteteve, janë realizuar të gjitha punët në kuadër të planit, ku është bërëpërgatitja e materiali në mënyrë fizike, mbajta e procesverbaleve, Hartimi i ekstrakteve për 7 mbledhje të Kuvendit të Komunës, Gjashtë mbledhje të Komitetit për politikë dhe financa, Katër mbledhje të Komitetit për Komunitete, Tri mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si dhe për disa mbledhje të Komitetit për Arsim, Komitetit për Shëndetësi, Komitetit për Kulturë Rini e Sport.

Për mbledhjet e përmendura më lartë të Kuvendit, ju është dërguar materiali në mënyrë elektronike Kryetarit, Nënkryetarëve, Drejtorëve, Anëtarëve të Kuvendit, Zyrës së Informimit si dhe në Ministrin përkatëse. Si dhe punë të ngjashme si përgatitja e vendimeve e rregulloreve të aprovuara etj.

Aktet juridike nënligjore të aprovuara në Kuvend fillimisht janë dërguar në Ministrin përkatëse për të vlerësuar ligjshmërinë e tyre, mandej në publikim në ueb faqe të komunës, kështu me radhë për t' krijuar plotfuqishmëri dhe zbatues të tyre.

Përveç kësaj, gjatë këtij gjashtëmujori janë përkthyer dhe lekturuar materialet për mbajtjen e mbledhjeve të sipërpërmendura dhe 48 vendime, 1 rregullore, plane dhe strategji të aprovuara në Kuvend si dhe, shumë materiale tjera të ndryshme. Janë bërë edhe shumë orë përkthim simulant me gojë.

Në sektorin për Mirëmbajtje dhe Operim, të gjitha punët janë kryer në mënyrën më të mirë deri tek mirëmbajtja dhe sigurimi i veturave dhe gjendjen e tyre të vazhdueshme teknike, si dhe kontrollimi i karburanteve të shpenzuara.

Të gjitha veturat janë të pajisura me pjesë kontrolluese (GPS).

Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për periudhën janar – qershor ka realizuar aktivitete të ndryshme për të nxitur dhe motivuar gratë në regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, organizimi i tryezave për motivimin e grave në zonat rurale për të zhvillua biznes të ndryshme, duke ofruar një ngritje vetëdijes së grave në projekte të ndryshme, përfaqësimit dhe të drejtave të barazisë gjinore në interes të përgjithshëm.

Po ashtu, është bërë regjistrimi i të dhënave në programin e Ministrisë së Financave për OJQ-të nga Komuna e Lipjanit që janë përfitues të subvencioneve përmes thirrjes publike.

Së bashku me Grupin e Grave në Lipjan, në mbështetje të Organizatës për Siguri në Evropë (OSBE) Misioni në Kosovë, kemi organizuar debat me zyrtarët komunal të pushtetit lokal, me asambleistët si dhe përfaqësues të komuniteteve jo shumicë. Qëllimi i takimi ishte avancimi, promovimi dhe motivimi i grave për pjesëmarrje dhe për tu zgjedhur në këshillat lokal të fshatrave dhe lagjeve urbane.

Kemi qenë pjesë e punëtorisë për Strategjinë dhe Planit të Veprimit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje për Komunën e Lipjanit, 2022-2025.

Në kuadër të projektit "Gratë dhe të Rinjtë të bashkuar për zhvillimin e komunitetit dhe trashëgimia kulturore" implementuar nga organizata The IdeasPartnership është prezantuar në hapjen e ekspozitës e cila është mbajtur nga nxënësit e Sh.F.M.U "Shtjefën Gjeçovi në Janjevë.

Po ashtu kemi qenë edhe pjesëmarrës në Panairin të prodhimeve bujqësore të grave në komunën e Lipjanit.

STATISTIKAT: SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Në formë tabelore të statistikave, kemi paraqitur raportin për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022, ku janë paraqit të dhëna dhe informacione për Drejtorinë e Administratës.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Ekstrakt i lindjes	1891
2	Certifikatë e martesës	342
3	Certifikatë vdekje	46
4	Certifikatë Vendbanimi	163
5	Vertetim nga arkiva	97
6	Certifikatë Shtetësie	84
7	Certifikatë e Statusit martesor	84
8	Certifikatëtë lindjes	1436
9	Certifikatë e Bashkësisë familjare	426
10	Aktvendime nga lëmia e gjendjes Civile dhe Akt Vdekje	//
11	Gjithësejt	4569

SEKTORI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHËSHME

Nr.	Emërtimi i Llojit të Punës	Sasia
	• Protokollimi i kërkesave, ankesave si dhe aktet tjera te personave fizik dhe juridik, në Qendrën për Shërbime me Qytetarë	
1	Kërkesa të regjistruara nga personat fizikë dhe juridik	5926
2	Kërkesa për mbajtës familje dhe shtesa për fëmijë jashtë vendit	496
3	Kërkesat gjendjes civile të regjistruara në sistemin e intranetit	18633
	• Pranimi dhe Dërgimi i shkresave bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar të brendshëm zyrtarit të postes së institucionit.	
4	Aktvendime të Shpërndara	202
5	Ftesa të Shpërndara	810
6	Vendime të Shpërndara	381
7	Fletëparaqitje për Gjykatë	71
8	Njoftime të Shpërndara	282
9	Të Arritura me Postë	232
10	Të Dërguara me Postë	979
11	Fatura tatimore të Qirasë	141
12	E veçantë për të raportuar harxhimet në të holla për dorëzim në postë janë 1687,50€	
	• Zyrtari i Pranimit/Logjistikës	
13	Futja e të dhënave në SIMFK – Freebalanc	983
14	Komentet në raportin e pranimi të mallit me modul të blerjes.	983
15	Pranimin e mallit të cilën është porositur malli nga furnitorët ekonomik.	274
16	Përgatitja e formularëve të shënimeve për mallrat e pranuar me anë të kërkesës interne nga organet përkatëse të cilët kanë kërkuar furnizim të mallit.	274
17	Përgatitja e formularëve për mallin e pranuar me anë të fletë dërgesës nga operatorët ekonomik, hyrje - dalje	274
18	Regjistrimi i faturave në librin e faturave hyrës	282
19	Shpërndarja e mallit të pranuar nga operatorët ekonomik.	274
20	Regjistrimi i Faturave të Op. Ek. Hyrje – Dalje për inventarizimin dhe paisjeve të IT në programin E-Qeverisja	128
21	Stoqe të grumbulluar me material në depon e komunës	34
22	Gjithsej	31659

SEKTORI PËR PUNË TË KUVENDIT DHE KOMITETEVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Mbajtja e procesverbalit nga mbledhjet e KK	7	120 faqe
2.	Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e KK	7	104 faqe
3.	Nxjerrja e Vendimeve dhe akteve të tjera nga mbledhjet e Kuvendit	48	139 faqe
4.	Përkthimi i Ekstrakteve	13	35 faqe
5.	Përkthime zyrtare-simultane në organe të ndryshme	41	100 orë
6.	Përkthimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorateve	113	242 faqe
7.	Përkthimi i shkresave të tjera	46	84 faqe
8.	Fotokopjimi	215	37000 faqe
9.	Mbajtja e Procesverbalit nga mbledhjet e KPF-së	6	55 faqe
10.	Nxjerrja e Ekstrakteve nga mbledhjet e KPF-së	6	43 faqe
11.	Mbajtja e procesverbalit dhe Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e komiteteve tjera dhe komisioneve të ndryshme	14	95 faqe
12.	Mbajtja e procesverbalit dhe nxjerrja e ekstraktit nga mbledhja e KKSB	3	25 faqe
13.	Përgaditja e ftesave të ndryshme për mbledhje dhe tubime të ndryshme.	46	490 faqe
14.	Përgaditja e rexhistrave të ndryshëm (për meditet e anëtarve të Kuvendit dhe komiteteve e të ngjajshme).	56	97 faqe
15.	Të ndryshme(dërgimi i dokumenteve për veb faqe,dokumenteve të skenuara në MAPL etj. të ngjajshme)	185	770 faqe
16	Rregullore,Plan, Korrniza e të ngjajëshme-Strategji dhe plan	4(1Reg.+3...)	77 faqe
17	Lektorim të materialeve të ndryshme (rregullore, vendime ekstrakte,raporte,ftesa etj. të ngjajëshme)	281	360 faqe
19.	Gjithsejt	1091	397346 faqe
20.			Përveq kësaj që pasqyrohet me faqe janë edhe 100orë përkthim me gojë.

SEKTORI PËR MIRËMBAJTJE DHE OPERIM

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Furnizim me lëndë djegëse - karburant përgjenerator dhe mesatarja e harxhimeve.	2	150 LITRA
2	Furnizimi me lëndë djegëse /naftë/ për ngrohje qendrore	2	4500 LITRA
3	Furnizim me lëndë djegëse – karburant për automjete	114	7521.85 Litra karburante
4	Evidentimi i kilometrave të kaluara të automjeteve dhe mesatarja e shpenzimeve.	114	88630 km mes; 8.48 lit/100 km
5	Harxhimet e ujit të pijshëm	/	
6	Furnizim me material teknike për mirëmbajtje të objekteve	/	
7	Furnizim me material higjenik	/	
8	Ndërrimi – meremetimi i dorëzave për dyer të drurit	10	
9	Rregullimi dhe deblokimi i ujit nyjën sanitare	10	
10	Mirëmbajtja e higjienës në sipërfaqe	/	3200 m ²
11	Mirëmbajtja e parkut - kositja e barit,		
12	Sërvisimi i automjeteve	5	
13	Sërvisimi i gjeneratorëve	/	
14	Sërvisimi i kalldatorëve	/	

15	Sërvisimi i centralit kundër zjarri (Alarmi)		
16	Sërvisimi i aparateve kundërzjarri		
17	Bartja e zyrtarëve komunal në trajnime-Prishtinë me kombi	231	
18	Vazhdimi i regjistrimit të automjeteve	6	
19	Mirëmbajtja e teknologjisë kompjuterike		
20	Vendosje e pompave zhytëse në pishinë		2 pompa
21	Kërkesa për vetura zyrtare	1010	
	Gjithsej	1504	

NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZI GJINORE

Trajnime	Takime	Debate	Tryezë e rrumbullakët	Të ndryshme
13	12	1	2	Këshilla dhe sugjerime me palë në zyre 81

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale gjatë kësaj periudhe kohore është fokusuar në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Punës për vitin 2022 si dhe implementimin e rekomandimeve nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës kundër pandemisë Covid19.

Kemi vazhduar me ofrimin e kushteve të përshtatshme për vaksinim si dhe për testim kundër pandemisë Covid19, dhe ofrimin e shërbimit dhe trajtimit të pacienteve të prekur me Covid19 dhe ofrimin e testeve përmes ekipit mobil në terren si në shkolla, institucione dhe në shtëpi.

Është shënuar Viti i Përsoneve me Aftësi të Kufizuara, përmes lëshimit në përdorim të Ashensorit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan. Ky projekt ka rëndësi të veçantë për personat me aftësi të kufizuara ngase ju ofron qasje të lirë në marrje të shërbimeve shëndetësore në katin e dytë dhe të tretë në QKMF.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË PERIUdhës RAPORTUESE

Me qëllim të implementimit të plotë të konceptit të mjekësisë familjare, fuqizimit të mjekut dhe infermierit si dhe ofrimin e shërbimeve adekuate për pacientin, ne kemi marrë hapa konkret duke marrë vendim për riorganizimin e ordinancave. Me këtë vendim janë krijuar hapësira të mjaftueshme për katër ordinanca në katin e dytë dhe katër ordinanca në katin e parë. Secila ordinancë do të përmbaj dy ordinanca, njera për mjekun e tjetra për infermier. Kartelat e pacientëve do të barten në secilën ordinancë dhe secili pacient do të regjistrohet te mjeku i tij/saj familjar.

Në kuadër të riorganizimit, me qëllim të evitimit të fluksit të ngarkuar brenda në QKMF, barnatorja do të zhvendoset në katin e parë dhe shërbimi do të ofrohet nga hyrja e veçantë.

Poashtu, shërbimet laboratorike do të zhvendosen në lokacion të veçantë dhe me hyrje të veçantë. Edhe ky ndryshim do të ju ndihmojë pacientëve dhe personelit mjekësor ngase do të shkarkohet numri i pranuesëve të shërbimeve brenda QKMF-së dhe do të krijohen mundësi të respektimit të distancës dhe zvogëlimit të mundësive për infeksion.

Theks i veçantë gjatë këtij gjashtë mujori i është dhënë zgjerimit të komunikimit me personelin mjekësor, komunikimit në mes të personelit shëndetësor dhe pacientit si dhe anasjelltas me qëllim të krijimit të kushteve më të mira të punës, rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit dhe avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve mjekësore duke vendosur pacientin në fokus. Në këtë drejtim, në mbështetje nga OSBE, janë mbajtur dy diskutime publike një ditore në të cilat kanë marrë pjesë afër 40 pjesëmarrës nga personeli shëndetësor dhe mbi 30 qytetarë. Po ashtu, me mbështetje nga AQH, është organizuar dhe mbajtur një trajnim për personelin mjekësor, të urgjencës dhe menaxhmentin e QPS-së në fushën e komunikimit dhe komunikimit me media.

Kujdes i veçantë i është kushtuar higjienës në ambientet e institucioneve shëndetësore në Komunën e Lipjanit me qëllim të ofrimit të sigurisë për pacientin dhe personelin shëndetësor. Si rezultat, është shënuar avancim i dukshëm në mirëmbajtjen dhe pastertinë brenda ambienteve të QKMF-së.

Në fushën e sigurisë shëndetësore, si komponentë e menaxhimit kualitativ të shërbimeve mjekësore, është duke u bërë avancim dhe jemi duke e përcjellur për së afërmi këtë proces. Përmirësimi i kushteve për stafin mjekësorë dhe për pacientin si dhe ofrimi i shërbimeve adekuate është trajtuar me kujdes. Që nga muji Shkurt 2022, për së afërmi është monitoruar furnizimi i ordinancave me material dezinfektues dhe higjienike si dhe pajisja e secilës ordinancë dhe sallës me çarçaf të ri. Asnjë pacient nuk është shërbyer pa u respektuar protokoli i higjienës dhe pa u vendosur çarçafët e ri për secilin pacient i cili ka marr shërbim.

Furnizimi me material mjekësor dhe laboratorik është kryer sipas kërkesave nga shefat e sektorëve, mirëpo furnizimi me barna dhe material mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë nuk është duke u bërë në tërësi. Furnizimi me insulinë është duke u bërë me vonesë nga depo qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë ndërsa furnizimi me barna për hipertension nuk është duke u bërë me rregull, ka mungesë për periudha të gjata kohore dhe kemi probleme të mëdha.

Kemi bashkëpunuar ngushtë me Solaborate dhe AQH-në rreth implementimit të pilot projektit të telemjekësisë në AMF Kraishtë.

Bashkëpunimi me AQH-në ka qenë i shkëlqyeshëm rreth implementimit të planeve dhe projekteve për insitucionet shëndetësore në Komunën e Lipjanit.

Në këtë periudhë raportuese kemi përkrahur projektin kujdesi për nënat e reja dhe fëmijët deri në moshën tre vjeçare. Do të vazhdojmë me përkrahjen dhe do të angazhohemi për sigurimin e një veture për kryerjen e vizitave në terren.

Në muajin Qershor 2022 kemi bërë përgatitjet për rritjen e kapaciteteve dhe riorganizimin e punës në QKMF me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe përballje me rritjen e numrit të pacientëve si pasojë e rritjes së temperaturave dhe ardhjes së bashkëatdhetarëve nga diaspora gjatë muajve Korrik dhe Gusht. Më tutje, kemi marrë vendim për ngritjen e kapaciteteve të urgjencës duke dërguar mjek dhe infermier shtesë me qëllim të mbajtjes së urgjencës në funksion dhe gatishmëri të plotë për intervenim gjatë këtyre muajve të cilët pritet me qenë të ngarkuar.

Poashtu, kemi organizuar takime me stafin menaxherial në QKMF dhe jemi duke u përgatitur të marrim vendim për zgjatjen e orarit në QKMF deri në ora 21:00.

Në këtë muaj kemi rekrutuar dy mjek të ri dhe janë kryer procedurat e rekrutimit për një mjek dhe një stomatolog të cilët pritet të fillojnë punën në muajin Korrik. Jemi duke bërë vlerësimet dhe përgatitjet si dhe kemi filluar procedurat për shpalljen e katër vendeve të reja të punës për mjek, me qëllim të evitimit të mungesës së mjekëve.

Projektet kapitale të shpallura dhe në procedura të prokurimit:

- Renovimin e Tualeteve në QKMF Lipjan,
- Shtruaraj e Dyshemesë me EPOKSIT në QKMF Lipjan,
- Renovimi i QKMF Lipjan Faza II
- Blerja e Autoambulancave
- Renovimi QMF Shalë dhe QMF Magure.
- Furnizim me Aparatura Mjekësore për QKMF Lipjan.

Eshtë nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit (MOU) në mes të Komunës së Lipjanit dhe AQH-së për renovimin e QMF-Gadime.

Kemi punuar ngushtë me Qendrën për Punë Sociale (QPS-në) me qëllim të identifikimit të vështërsive, sfidave dhe avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve sociale. Kemi punuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Përfshirjen Sociale 2022-2024.

Kuvendi Komunal ka aprovar Strategjinë për Përfshirje Sociale 2022-2024 dhe Planin e Veprimit për implementim të kësaj strategjie. Të gjitha procedurat ligjore janë respektuar, si mbajtja e dëgjimeve publike, konsultimi me komitetet relevante të Kuvendit Komunal dhe konsultimet me OJQ.

QENDRA KRYESORE E MJEKESISE FAMILJARE

Përmbledhje e vizitave dhe shërbimeve mjekësore ne QKMF, QMF dhe AMF-Lipjan

Janar-Qershor 2022	Numri i vizitave mjekësore	Numri i shërbimeve shëndetësore	Përqindja e referimeve në shërbimet sekondare dhe terciare
Janar	19169	24673	7.73%
Shkurt	18566	21716	7.06%
Mars	19445	22067	10.73%
Prill	15669	15293	6.00%
Maj	17969	18005	11.33%
Qershor	14089	18083	9.40%
Gashtëmujoiriparë 2022 gjithësej	104907	119837	8.70%
Vizita dhe shërbime shëndetësore Gjithësej	224744		

Vaksinimi me vakcina atnti Covid -19 Janr-Qershor 2022

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
Doza I	521	174	54	29	31	8	817
Doza II	844	298	122	51	39	20	1374
Doza III	1678	421	70	29	39	7	2244
Doza IV	0	0	0	0	0	0	0
Total	3043	893	246	109	109	35	4435

Testime me teste rapide antigjen Janar-Qershor 2022

Emertimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
Pozitiv	1069	606	19	7	8	41	1750
Total	3316	2913	473	158	165	111	7136
Perqindja	32%	31%	4%	4%	5%	37%	25%

Trajtime me terapi me infuzione të pacientëve të infektuar me Covid-19 Janar Qershor 2022

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Gjithësej
	365	837	29	29	0	60	1320

Aktivitetet tjera të realizuara dhe ne realizim e sipër Janar -Qershor 2022

Në fillim të vitit ka filluar realizimin projektit nga DSHPs, për përmirësimin e kushteve të punës në sektorin e Urgjencës.

Pëfundimi i renovimit dhe funksionalizimi i telemjekësisë në AMF-Kraishtë nga AQH.

Broshura për njoftimin e qytetarëve lidhur me KPSH dhe shërbimet të cilat ofrohen në këto institucione, për edukim lidhur me përdorimin e kripes dhe sheqerit, diabetin dhe hipertensionin etj. Donacion nga AQH.

Pjesmarrja në Konferencen ndërkombëtare të shërbimeve shëndetësore të Integruara në Odense-Danimarkë 23-25 Maj 2022.

Vizita studimore në Kujdesin Primar Shëndetësor në Slloveni 19-22 Qershor 2022

Debati i hapur për sfidat e shërbimeve shëndetësore me stafin e KPSH-Lipjan i organizuar nga Drejtorati i DSHPS-së, me mbështetje të OSBE-së.

Shërbime të reja të ofrimit të shërbimeve shëndetësore nga KPSH-Lipjan për këtë periudhë janë:

1. Vizita në shkolla për higjienë, me kërkesë të drejtorëve të shkollave, (vizitat sistematike në shkolla nuk janë zhvilluar për shkak të pandemisë)
2. Implementimi i pilot projektit të telemjekësisë dhe rrjedhës së pacientit.
3. Klasa për nëna dhe këshillimi grupor me qifte të reja.
4. Analiza shtesë CPR, ALT dhe AST.
5. Fushatat vaksinimi në komunitetin Ashkali, Rom dhe Egjiptian në bashkëpunim me UNICEF dhe OJQ "SunFlowers" nga komuniteti.
6. Memorandum bashkëpunimi me OJQ PRAK në formimin e këshillit të pacientëve.

Orari i punës në KPSH-Lipjan

-Vizitat mjekësore dhe shërbimet shëndetësore në QKMF janë ofruar nga ora 07:00 deri në ora 20:00. Urgjenca dhe Materniteti kanë punuar 24 orë. Shërbimet e mjekësisë familjare, pediatrikë, stomatologjisë nga 12 orë në dy ndërrime, shërbimet në QMF në dy ndërrime me orar 12 orë dhe shërbimet në AMF 8 orë në një ndërrim.

Departamenti i Mjekësisë Familjare

Në sektorin e mjekësisë familjare puna me mjekë ka qenë e organizuar mirë, mbulimi i punkteve përveç AMF-Smallushë, Rubovc dhe pjesërisht Babush, ka qenë i mirë. AMF në Banullë është demoluar nga persona të pa përgjegjshëm.

Në sektorin e Infermierisë është arritur koordinim i mirë në organizimin dhe shpërndarjen e punëve gjatë pandemisë, si në kryerjen e raportimeve me kohë, planifikimin dhe shfrytëzimin e pushimeve pa penguar procesin e punës, si dhe mbajtja e disa takimeve radhazi lidhur me përmirësimin e cilësisë së punës infermierore në bashkëpunim me drejtorinë dhe koordinatoren e QEV-it, po ashtu janë organizuar planifikim i trajnimeve të stafit dhe shënimi i ditëve të caktuara në shëndetësi. Ky shërbim po bart punën e kryerjes së stazhit të gjithë praktikantëve të infermierisë, gjithsej 286 praktikant/e.

Sektorin e barnatoreve: Kemi një përmirësim në shpërndarjen, planifikimin si dhe evidentimin e stokut. Barnatotja është vendosur në katin e parë të QKMF-së dhe pajisur me higroskop, termometra për ambientit të deponimit të barnave dhe frigorifereve.

Në planifikimin e dozave të insulinës dhe intervenimin sipas mundësive buxhetore në blerjen e barnave komerciale, sepse furnizimi me barna nga lista esenciale në Barnatoren Qendrore të MSH është tejte i dobët nga sasia e planifikuar diku rreth 70%.

Janë kryer planifikimet për vitin 2022. Kemi kriju dosjet për secilin pacient me diabet, neuroleptik psiko - trop, po vazhdojmë me identifikimin e grupeve të caktuar që është e domosdoshme të kenë dosjet shëndetësore. Numri i pacientëve insulinë varës është rreth 330.

Furnizimi nga financimi komunal ka qenë mbi 16,840.00 euro dhe ka qenë furnizimi i mirë përkundër kërkesave të shtuara nga trajtimi i pacientëve me Covid-19.

Sektorin e shërbimit te emergjencës:

Stafi

Stafi përbehet nga tetë mjek dhe trembëdhjetë Teknik/Infermiere Medicional/e si dhe njësia e transportit me nga 1 vozitës për çdo ndërrim.

Orari punës

Shërbimi i urgjencës dhe materniteti në QKMF ofron shërbime 24 orë në ditë.

Në këtë shërbim gjate një ndërrimi, janë nga dy mjek për arsye të vëllimit të madhe të punës dhe mundësisë së daljes në teren të ekipes mjekësore me prezencën e mjekut. Ky shërbim është i ngarkuar me numër të madh të pacientëve dhe kështu edhe shpenzuesi i më shumë se gjysmës së furnizimit me material mjekësor dhe terapi shpenzohet nga ky shërbim.

Spektori i Stomatologjisë: Në këtë sektor aparatura është në gjendje të përmirësuar, ka rritur cilësinë e ofrimit të shërbimeve stomatologjike. Pas renovimeve në këtë shërbim si dhe pajisjen me karrige stomatologjike sipas planifikimit kemi përmirësimin e cilësisë së vizitave stomatologjike. Kemi kryer servisimi e disa aparaturave përfshi edhe rëntgenin e dhëmbëve i cili është kthyer në funksion por është shume i vjetëruar.

Spektori Maternitetit: Ky shërbim ka shënuar rënie të lindjeve, por tani janë orientuar vizitat dhe këshillat për nëna dhe fëmijë deri në tre vjeç, po ashtu edhe klasa për nëna, jemi duke realizuar vizita shtëpiake, kurse vizitat gjinekologjike-obstetrike kryhen nga dy mjek gjinekolog. Renovimi i objektit ka përmirësuar dukshem kushtet e punës si dhe pajisja me ECHO e CTG aparat. Gjatë këtij viti ka qenë objekti i maternitetit në shfrytëzim për vaksinim me vakcina anti-Covid-19 deri më 15 Qershor 2022, ku nga kjo datë është vendosur në QKMF.

Shërbimi i Pneumoftziologjisë: Kemi zvogëlim të numrit të sëmurëve me TBC gjithësej në periudhën Janar-Qershor 2022 kemi 18 raste.

Spektori i Laboratorit:Kemi një aparatur të mirë tani. Analiza e HbA1c/Hemoglobina e glikogjenizuar ka filluar të ofrohet. Gjatë vitit nuk kemi pasur vështirësi në furnizim me material laboratorik, kemi shtuar edhe 4 analiza në këtë sektor.

Departamenti i Administratës

Administrata dhe personeli i QKMF-së në Lipjan gjatë fillimit të vitit 2022 ka kryer punët në mënyrë profesionale duke u bazuar në dispozitat ligjore që janë aktualisht dhe ka kryer këto punë duke përpiluar këto akte juridike, si në vijim :

Nr.	Emërtimi i Aktit	Nr. i aktive
1	Aktvendimepërshfrytëzimetpushimitvjetor	98
2	Aktvendime për pagesën e punës së nates,jashtë orarit,festave	52
3	Aktvendimembimasatdiciplinor(Vërejtje)	1
4	Lëshimetëvërtetimepërprovajtëpunëspërishpunëtorveaktual	25
5	Evidentimidheprocedimi i pushimevemjekësore	60
6	Evidentimidhe procedimi i lindjeve ne njësin e maternitetit	/
7	Aktvendimetpërpushimet e Lehonispërpunëtorvet	1
8	Largimngapuna me vetëdeshirdhetëlarguar me procedurterregullt	2
9	Pushimet pa pagesë	3
10	Rekrutimetërejatëpunëtorve	3
11	Vertetima që kanë përfunduar praktiken në QKMF	134
12	Vërtetimaqëkanqenëpraktikvullnetarenë QKMF	4
13	Akvdimepërdaljenë pension tëpunëtorve	2
14	Akvdimpërnderprerjen e punëspunëtorveqëkanëvdekur	/
15	Aktvendimetëndryshmedheshkresatëndryshme .	50
16	Ndryshimenë listen e pagavetëpunëtorvepërvitin 2022	100
17	Pregaditja e pagesespërshstesat Covid-19	6
18	Pregaditja e Autorizimeve për praktik (Nga asistentja Znj. GanimeteKrasniqi)	286
Gjithësej:	Lëndet e punuarjanë:	826

Sektori i personelit të QKMF-së në Lipjan, duke u bazuar në dispozitat ligjore që janë aktualisht në fuqi, gjatë muajve janar - qershor ka kryer këto punë duke përpiluar këto akte juridike, si në vijim:

- Rekrutim të 8 pozitave si dhe 5 largime të punëtorëve që kanë bërë kërkesë me vetëdëshirë për shkëputje të kontratës së punës, për arsye të ndryshme.
- Kompletimi i dosjeve të personelit.
- Përgaditja e formularëve për vlerësimin e punëtorëve dhe detyrat e punës.
- Konsultimi dhe dhënja e ndihmës juridike punëtorëve lidhur me të drejtat e tyre etj.

Sektori i Financave:

Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit është kryer sipas planit si dhe zotimi i mjeteve për pagesa të ndryshme ka qenë me kohë sa i përket te hyrave nga participimi kemi këtë pasqyrë:

Raporti i shpenzimeve Janar-Qershor 2022

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Vlera në €
1	Pagat dhe medijtjet	875,268.87
2	Pagat jubilarë	3,393.03
3	Mallra dhe shërbimet	46,311.34
4	Komunaliet	19,337.54
TOTALI		944,310.78

Edukimi Pasdiplomik Specialistik:

Në kuadër të edukimit specialistik nga QKMF-Lipjan janë gjashtë (6) mjekë në specializim të mjekësisë familjare. Në specializim kemi edhe dy mjekë, një në Pediatri dhe një në Biokimi, të cilët pas përfundimit të specializimit do të kthehen në QKMF-Lipjan.

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional(ZHVP)

1. Në kuadër të ZHVP-së është mbajtur shënimi i ditës kundër TBC me datë 24 Mars 2022, si dhe me rastin e shënimit të ditës së shëndetësisë me 7 prill kemi mbajtur një ligjëratë me qytetar të Komunës së Lipjanit ku janë njoftuar me strukturën organizative, shërbimet e KPSH, sasinë dhe cilësinë e shërbimeve si dhe vështirësitë tona dhe të qytetarëve në marrjen e shërbimeve shëndetësore në KPSH.
2. Dita botërore e Hipertensionit, në përkrahje të AQH-së, aktivitet në sheshin "Adem Jashari" dhe në lagjen te Xhamia, më 17 Maj 2022.
3. Ligjërat me qytetar pacient në AMF Kraishite, me banor nga Ribari i Madh dhe Kraishita, nga OJQ KOPF.
4. Karnevali Përshendetje, me aktivitete vetëdijësuese në fshatin Sillovi,
5. Pjesëmarrja e stafit superior dhe të mesëm në kongrese dhe trajnime është përkrahur nga menaxhmenti,
6. Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare të përkrahur nga AQH.

Konkluzione:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në Kujdesin Primar në Komunën e Lipjanit përkundër vështirësive me pandeminë, nuk është ndërprerë asnjë shërbim tjetër dhe janë realizuar në besueshmëri nga qytetari ku dëshmohet me 213084 vizita mjekësore dhe 282123shërbime shëndetësore.

Prioritet i vitit 2022 do të jetë promovimi i KPSH-së dhe puna në teren, në edukimin dhe promovimin e shëndetit, implementimi i telemjekësisë, në veçanti me sëmundjet kronike jo ngjitëse, dhe grupet më të ndjeshme.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Qendra për Punë Sociale (QPS) duke qenë institucion publik profesional i nivelit Komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale, brenda territorit administrativ të komunës, edhe gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar veprimtari profesionale me interes të veçantë shoqëror në ofrimin e përkujdesjes sociale, këshillimit ose në raste të veçanta ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale, brenda kompetencës teritoriale ku edhe vepron.

Në QPS, në kuadër të veprimtarisë së shërbimeve sociale për mbrojtje të qytetarëve në nevojë pavarësisht rrethanave të tyre 24/7 ditë në javë, vepron "Organi i Kujdestarisë", si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh.

NUMRI I KLIENTËVE QË MARRIN SHËRBIME NGA QPS

Klientët dhe shërbimet në kuadër të Shërbimit Social.

Klientët	Numri i rasteve	Shërbimet	Numri i rasteve
Fëmijë të braktisur	1	Këshilla martesore dhe sociale	55
Klient në nevojë për këshillim martesor	19	Besim i fëmijëve-kontak.	17
Fëmijët me sjellje asociale	27	Kujdestari	5
Të mitur konflikt. ligjin	93	Sh. Të miturve –delikuencë.	116
Viktimat e dhunës.	29	Vendosje në strehim famil.	1
Fëmije me AK	13	Vlerësime për të mitur	2
Femije të keqtrajtuar, abuzuar.	4	Vendosje adoptim vendor	0
Të moshuarit në nevojë për shërbime	4	Shërbime për fëmijët në spital	1
Klient për strehim familjar të fëmijëve.	1	Vendosja e fëmijëve në strehim	4
Martesa të të miturëve	3	Bashkim familjar	1
Persona të vendosur në ISSH	0	Strehim për viktimat e dhunës	3
Punë e rrezikëshme e fëmijëve	1	Shërbime për fëmijët me AK.	86
Viktimat e trafikimit	1	Fëmijë në adoptim vendor	0
Viktimat e dhunës për strehim	2	Intervenimi i viktimave	26
Fëmijët e prindërve të penguar në detyrë prindrore.	7	Intervenim në kujdestari	71
Ri-integrim i fëmijëve	0	Shërbime për të rriturit me AK.	3
Kujdestaria për fëmijë të pa shoqëruar	5	Sanim i marrëdhënieve familjre	1
Persona të vendosur në (SHPMFPF) Prishtinë.	0	Përfaqësues rtë përkohshëm	14
Viktimat e krimeve seksuale	4	Ndihmë materiale për fëmijët me AK.	20
Klient tjerë me kërkesë për shërbime administrative dhe profesionale.	208	Intervenimet e pergj.	1101
Totali:	424	Totali	1530

SHËRBIMI I NDIHMAVE SOCIALE

Objektivi SHNS ka qenë zbatimi i ligjshmërisë, si dhe organizimi i punës në shërbim. Në sajë të këtij objektivi QPS-SHNS në mënyrë intensive dhe të përkushtuar me tërë potencialin njerëzor e profesional ka zhvilluar aktivitete në ngritje të kualitetit në shërbim, për zbatim dhe realizim të Ligjit, respektim të procedurave dhe kritereve ligjore në përzgjedhje të familjeve në nevojë për ndihmë sociale.

Shërbimi i asistencës sociale si çdo herë edhe përgjatë këtij gjashtëmujori ka vepruar me aktivitete sipas plan programit për përfshirje sociale që në parim; askush mos të mbetet mbrapa, përkundër një periudhe jo të zakonshme dhe mjaft sfidues, si rrjedhojë e post-covid 19.

Në vazhden e aktiviteteve sociale nuk ka munguar aktivitetet me mbështetje materiale me institucione, organizata vendore dhe ndërkombëtare dhe shoqëri civile, përfshirë: UNDP, IOM, Islamik Relif Kosova, Bashkësin Islame dhe Shoqatën Bereqeti, Ambasaden e Emirateve të Bashkuara, persona fizik dhe juridik të vullnetit të mirë, përfshir edhe humanistin e rregullt (Xhemajl Krasniqi nga fsh. Smallushë, i cili jeton dhe vepron në Germani) etj.

Punë të tjera administrative, siç janë vërtetimet që janë apo nuk janë në asistencë sociale, konstatime zyrtare etj.

Pasqyra e familjeve dhe pagesave në asistencë sociale.

MUAJI	NUMRI I FAMILJEVE	SHUMA
JANAR	1314	179,350.00
SHKURT	1283	173,370.00
MARS	1297	178,520.00
PRILL	1296	349,420.00
MAJ	1288	175,070.00
QERSHOR	1289	174,020.00

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, shërbimi asistencës sociale ka kryer edhe pune të tjera si:

- Bashkëpunim me Këshillin e Bashkësisë Islame në Lipjan (KBI), për të cilën sipas kërkesës së tyre janë përzgjedhur 100 familje shfrytëzuese të ndihmës sociale për pako ushqimore të dhuruar nga KBI.
- Bashkëpunim me Islamic Relief of Kosova rreth përzgjedhjes së 180 familje shfrytëzuese të ndihmës sociale për pako ushqimore.
- Bashkëpunim me DPSF për të cilën sipas kërkesës së Emirateve të Bashkuara Arabe janë përzgjedhur 50 familje shfrytëzuese të ndihmës sociale për pako ushqimore.
- Bashkëpunim me “Jetimat e Ballkanit”, sipas kërkesës së Komunës, ku janë përzgjedhur 200 familje shfrytëzuese të ndihmës sociale për pako ushqimore të cilat janë dhuruar nga kjo organizatë.
- Bashkëpunim me organizatën “Qatar Charity” në Kosovë sipas kërkesës së Komunes janë përzgjedhur 400 familje shfrytëzuese të ndihmës sociale për pako ushqimore të dhuruar nga Qatar Charity.

SHËRBIMI ADMINISTRATIVO – FINANCIAR

Shërbimi Administrativ-Financiar ka zhvilluar aktivitet në harmoni me legjislacionin përkatës për punë administrative dhe financiare, në kuadër të planit buxhetor dhe sipas afateve procedurale dhe planifikuese. Janë administruar të gjitha kërkesat në kohë dhe lëndet janë në zyrat përkatëse ekzekutive në nivel komune.

Aktivite e veçanta: Pjesmarrja dhe kontributi në hartimin e strajegjisë për shërbime sociale dhe familjare si dhe në hartimin e planit të veprimtimit për zbatim të strategjisë.

Zbatimi i plan-programeve në kuadër të QPS-ës dhe MM, siq është:

- OFAP- mbështetje e fëmijëve në strehim familjar;
- Shërbimet për fëmijë dhe foshnja,
- Shërbimet e integruara shëndetsore dhe Sociale për personat e moshuar me smundje kronike.

SHTËPIA ME BAZË NE KOMUNITET

Gjendja e përgjithshme gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore Janar –Qershor të vitit 2022 ka qenë mirë, të gjitha obligimet financiare të cilat janë bart nga viti 2021 të furnitorëve janë kryer me kohë.

Në muajin Shkurt 2022 një rezidente e cila ka qenë banore e komunes së Prizrenit mirëpo nën përkujdesje të institucionit tonë është transferuar në SH.K –Prizren.

Gjatë kësaj periudhe në procedurë të prokurimit janë dy projekte për fasadimin dhe izolimin e aneks objektit si dhe instalimi i rrymes, kanalizimit, ujësjellësit, nxemjes si dhe disa punë tjera sipas paramasës dhe parallogarisë.

Gjendja shëndetsore e rezidentëve

Gjendja shëndetsore e rezidentëve gjatë ketyre muajve në përgjithësi ka qenë e mirë, rezidentët kanë pasur disa probleme të vogla shëndetsore ku janë trajtuar nga stafi i QKMF, stafi i shtëpisë së komunitetit si dhe kontrollat psikiatrike sipas nevojës në QKUK – kliniken e psikiatrisë.

AKTIVITETET E ZHVILLUARA

Në muajin Maj është realizuar vizita e parë në Prevall për të gjithë rezidentët dhe stafin e SH.K, dhe çdo gjë ka shkuar në rregull. Po ashtu, brenda objektit zhvillohen aktivitete të lira me rezidentë si menyra e të ushqyerit, mbajtja e higjienës personale, mbajtja e higjienës në dhomat e gjumit, si dhe lojra të ndryshme.

Gjatë periudhës Janar – Qershor të vitit 2022 kemi pasë furnizim të mjaftueshëm të artikujve ushqimor, higjienik, veshmbathje, pajisje tjera të nevojshme për shtëpinë dhe furnizim me barna.

Gjatë kësaj periudhe kemi bërë mirembajtjen e oborrit, aktivitete me rezident, shetitje 7 netë dhe 8 ditë në Prevallë, furnizimet sipas nevojave, pagesa e kujdestarive, pagesa e pakos emergjente sipas vendimeve qeveritare .

STRUKTURA MOMENTALE E REZIDENTËVE NË SHTËPINË E KOMUNITETIT- LIPJAN

STRUKTURA E REZIDENTEVE			
NACIONALITETI	NUMRI	FRMRA	MESHKUJ
SHQIPËTAR	8	4	4
ROM	1	1	
BOSHNJAK	1	1	
NUMRI I PËRGJITHSHEM	10	6	4

DREJTORATI PËR ARSIM

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtorati i Arsimit, gjatë muajve janar – qershor 2022, përkundër vështirësive të shkaktuara nga pandemia Covid-19 ka arritur të realizoj aktivitetet e planifikuara dhe të realizoj punë të cilat ndikojnë pozitivisht në realizimin sa më të mirë të procesit edukativo- arsimor dhe ngritjen e vazhdueshme të cilësisë. Fillimi i gjysëmvetorit të dytë ishte më 10.01.2022 për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme pas pushimit dimëror.

Komuna e Lipjanit, respektivisht Drejtoria Komunale e Arsimit, ka nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi mes :

- Ipko Foundation, qëllimi i memorandumit është realizimi potencial i programit Bridge nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, në partneritet me BONEVET. Në program do të përfshihen 40 nxënës të moshave 14-18 në mësim pas-shkollor, të cilët për një periudhë 2 vjeçare mësojnë gjuhën angleze, trajnohen në programe STEM dhe tjera që ata të mund të edukohen në Amerikë apo të gjejnë punësim në Kosovë, të dyja me qëllim kontributin në shoqërinë Kosovare.
- Ballkan Green Foundation, qëllimi i memorandumit është realizimi i aktiviteteve të projektit "Turneu i Gjelbër". Trajnimin e nxënësve të shkollave të mesme të larta në të menduarit kritik dhe kreativ.
- ETEA, qëllimi i memorandumit është realizimi i projektit, rregullimi i bibliotekës shkollore me strategjinë e lexim-kuptimit, projekt i cili është implementuar në Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan.

Shkolla ShFMU "Nezë Bujani" në Bujan është fituese e projektit:

- "Fit for Jobs" nga GIZ-i gjerman, projekti ka për qëllim përgatitjen e nxënësve për mësim dhe është projekt që do të zgjas 3 vite.

Shkolla ShMP "Adem Gllavica" në Lipjan është përfituese e projektit:

- "Fit for Jobs" nga GIZ që ka për qëllim asistimin në lidhjen e marrëveshjeve për mësimin në vendin e punës (MVP) si dhe asistimin gjatë zbatimit në MVP që do të nisë në shtator të vitit shkollor 2022, trajnimin e instruktorëve për mësimin në vendin e punës dhe trajnimin për shkathtësi të buta (soft skills).
- Lux – DEV në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit, që ka për qëllim mbështetjen e shkollës për profilet që i përkrah LUX-DEV, me literaturë, pajisje të kabinetëve, trajnime, furnizim me pajisje e vegla për profilet instalues elektrik, instalues i ngrohjes dhe klimatizimit e ujësjellesit, metalpunues dhe mbështetja e shkollës për procesin e njohjes së mësimin paraprak (NjMP): trajnimi i stafit të shkollës, asistimi gjatë procesit të akreditimit për NjMP.

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me UNICEF-in ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me ShFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, ShFMU "Nezë Bujani" në Bujan, ShFMU "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë, ShFMU "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve dhe ShFMU "Kadri Beba" në Ribar i Madh. Memorandumi ka për qëllim, realizimin e projektit "Mjedisi i digjitalizuar shkollor për t'i mbështetur mësimdhënësit dhe nxënësit për të mësuar gjatë tërë jetës". Lidhur me këtë është mbajtur edhe trajnim 2 ditor për mësimdhënësit.

Më datë 15.06.2022 ka filluar ndërtimi i objektit të ri shkollor në Ribar të Madh.

Është bërë vlerësimi i dosjeve për mësimdhënësit e fushave: Programi parafillor dhe fillor, Artet, Jeta dhe puna, Shkencat Natyrore, Matematika, Shoqëria dhe Mjedisi si dhe Edukimi fizik. Trajnimi i mësimdhënësve të këtyre fushave është kryer në vitin 2021, ndërsa janë pajisur me certifikata nga MASHT-i gjatë kësaj periudhe.

Fakulteti i Edukimit në bashkëpunim me UNICEF-in dhe DKA-në ka mbajtur trajnim për edukatorët nga Komuna e Lipjanit. Trajnimi ka pasur për qëllim përgatitjen profesionale të edukatoreve në shërbim dhe aspekte tjera të arsimit në fëmijëri të hershme.

Plotësimi dhe dorëzimi i databazës për nxënësit parafillor në të gjitha shkollat fillore për vitin shkollor 2021-2022 tek Caritasi Zvicerran, pastaj është përgatitur edhe raport për të gjitha Komunat, mbi të dhënat për edukimin parafillor.

Me vendim të Task Forcave të shkollave përkatëse në rastet kur numri i personave të infektuar me Covid-19 ka qenë i lartë disa shkolla kanë kaluar në mësim online: ShFMU "Emin Duraku" në Banullë ka kaluar në mësim online nga data 18.01.2022-21.01.2022, ShFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, cikli 6-9 ka kaluar në mësim online nga data 24.01.2022-28.02.2022, ShML Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan ka kaluar në mësim online nga data 26.01.2022-07.02.2022 dhe Çerdhja është mbyllur nga data 26.01.2022-07.02.2022.

Nga Caritasit Zvicerran dhe Projekti Shpresë është mbajtur trajnim 2-ditor për koordinatorët e cilësisë në nivel shkolle me temën "Ngritja e kapaciteteve të Kordinatorëve për Sigurimin e Cilësisë në fushën e arsimit parafillor".

Shkolla Dimërore e Skijimit në bashkëpunim me MASHT-in dhe Komunën ka organizuar realizimin e projektit për nxënësit e klasave të 7-ta, konform kësaj pas aplikimit është përzgjedhur të merrë pjesë klasa e VII⁴ nga ShFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan. Projekti ka për qëllim promovimin e kapaciteteve të Kosovës për zhvillimin e sportit malor – skijimit.

Komisioni komunal për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta ka bërë vlerësimin pedagogjik të mbi 30-tridhjetë fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në kuadër të marrëveshjes me UNICEF-in përmes IPKO Foundation është përmbyll instalimi i internetit në 16 shkolla të Komunës.

Për nderë të festës së 7 Marsit Ditës së Mësuesit, DKA ka ndarë mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar në nivel shkolle. Gjithashtu është bërë përzgjedhja e punëtorit më të mirë në nivel Komune për vitin 2022.

Është mbajtur mbledhje me drejtorët e të gjitha shkollave fillore dhe të mesme në të cilin takim janë diskutuar çështje të ndryshme me rëndësi rreth procesit edukativo-arsimor në shkolla. Në njërën nga mbledhjet është lansuar edhe programi (ARSLIP.SOFT) për udhëheqjen e statistikave shkollore dhe çështjeve tjera administrative.

Bazuar në U.A Nr.106/2020, për vlerësimin e performancës së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar është bërë vlerësimi për 2-dy drejtor të shkollave.

Më datë 13.05.2022 ka përfunduar viti shkollor për nxënësit maturant.

Më datë 06,10,11 dhe 12 Maj është mbajtur testi PISA. Në këtë test kanë marrë pjesë 9 shkolla me 200 nxënës (ShFMU "Dy Dëshmorët" në Dobrajë e Madhe, ShFMU "Ibrahim Banushi" në Shalë, ShFMU "Rexhep Akllapi" në Akllap, ShFMU "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë, ShFMU "Vezir Kolshi" në Baicë, SHML Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan, SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan, Maarif School of Kosova dhe Mehmet Akif).

Është bërë miratimi i propozim rregullores mbi plotësimin dhe ndryshimi mbi ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Lipjanit.

Më datë 04.06.2022 dhe 14.06.2022 është mbajtur testi i arritshmërisë, test të cilit i janë nënshtruar gjithsej 897 semimaturant. Më datë 22.06.2022 është bërë shpallja e rezultateve të testit në fjalë.

Më datë 18.06.2022 është mbajtur testi i maturës shtetërore, test të cilit i janë nënshtruar gjithsej 979 maturant. Rezultatet e testit të maturës janë shpallur më datë 27.06.2022

Më datë 27.06.2022 është shpall konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të për Gjimnaze dhe shkollat Profesionale, për vitin shkollor 2022/2023.

Janë përgatitur të dhënat rreth suksesit të nxënësve për gjysëm vjetorin e dytë për vitin shkollor 2021/2022.

Sipas kalendarit shkollor, më datë 03.06.2022 ka përfunduar mësimi për nxënësit semimaturantë (klasa e 9-nëntë) dhe për nxënësit e shkollave të mesme 10 dhe 11, ndërsa për nxënësit e shkollës fillore (parafillorët dhe klasa 1-8) ka përfunduar më datë 17.06.2022.

Më datë 10.06.2022 është mbajtur testi ICILS (faza pilot), në të cilin test kanë marrë pjesë nxënësit e ShFMU "Emin Duraku" në Banullë (klasa e VIII).

Ka filluar furnizimi i shkollave me lëndë djegëse (dru).

Bazuar në kërkesën e MASHT-it është bërë planifikimi dhe përgatitjet administrative për furnizimin e nxënësve me tekste shkollore për vitin 2022/2023.

Në mbështetje të Komunës së Lipjanit, ShFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan në ditën e shënimit të shkollës ka organizuar mbajtjen e panairit të Gjuhës, Artit, Shkencës dhe Teknologjisë P-gjashtë. Panairi në fjalë ka pasur karakter edukativ, socializues, rekreativ dhe garues.

Në kuadër të Memorandum Mirëkuptimit mes DKA-së, Organizatës ETEA dhe ShFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan është bërë hapja dhe funksionalizimi i bibliotekës shkollore me strategjinë e lexim-kuptimit.

Pjesëmarrja e zyrtares për arsim në konferencën përmbyllëse të projektit Shpresë në bashkëpunim me Caritasin Zviceran me temën "Fuqizimi i akterëve dhe përmirësimi i shërbimeve për një edukim parafillor cilësor" dhe pjesëmarrja në trajnimin për zyrtarët komunal për arsim gjithëpërfshirës në kuadër të Projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshilli i Evropës "Ndërtimi i Kapaciteteve për Përfshirje në Arsim – INCLUDE".

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:

- Formular për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim – skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë dhe
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Janë realizuar aktivitete kulturo-artistike me rastin e shënimit të ditëve të shkollave.

Janë realizuar kërkesa të ndryshme në drejtorate Brenda komunës dhe institucione të tjera lidhur me kompletimin e dokumentacioneve rreth fillimit të implementimit të investimeve kapitale të planifikuara në sektorin e Arsimit për vitin 2022 (kërkesa për hartimin e projekteve, kërkesa për leje ndërtimore, kërkesa për fillimin e procedurave të prokurimit, kërkesa për kyqje të ujësjellësit dhe për pëlqim në kyqje- furnizimi me energji elektrike)

Kërkesë Thesarit për:

- Rihapjen e nënkodit buxhetor për Qendrën Korrektuese në Lipjan,
- Për alokim të parakohshëm në kategorinë kapitale - Ndërtimi i Çerdhës në Slovi.

Kërkesë MASHT-it për:

- Ndërtimin e Çerdhës në Magure,
- Furnizimi i disa shkollave me mjete didaktike,
- Furnizimi i Çerdhës së fëmijëve në Gadime me inventar shkollor dhe
- Furnizimi i disa shkollave në Komunën e Lipjanit me rikuizita sportive.
- Furnizim me pako të pajisjeve laboratorike nga lëndët shkencore: Kimi, Fizikë, Biologjia etj, për disa shkolla të Komunës sonë.

Kërkesë urgjente për komisionin komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në kulmin e ShFMU "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve, si pasojë e motit jo të mirë.

STATISTIKAT

Të dhënat mbi numrat e të testuarve, infektuarve dhe të shëruarve në shkolla gjatë periudhës Janar-Qershor 2022

Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve	Mësimdhënës të:			Personel tjetër të:			Nxënës të:		
	testuar	infektuar	shëruar	testuar	infektuar	shëruar	testuar	infektuar	shëruar
1055	258	114	114	67	18	18	433	307	307

Rezultatet e testit të arritshmërisë 2022

Nr.	Shkollat	Nr i nx në testin e arritshmërisë	Nr i përgjithshëm i poenave	Nr i nx. me 100 deri 200 poena	Pozitiv me %	Nr i nx me 1-100 poena	Negativ me %	Përqindja në nivel shkollë	Gjithësejt femra	Femra me 100-200 poena	Femra mbi prapun e kalushmërisë me %	Gjithësejt meshkuj	Meshkuj me 100-200 poena	Meshkuj mbi prapun e kalushmërisë me %	Totali
1	"Vëllezërit Frashëri"	161	18,403	114	70.81	47	29.19	57.30%	82	69	84.14%	79	45	56.96	92.253
2	"Ismail Luma"	79	6988	22	27.85	57	72.15	44.35%	38	16	42.10%	41	6	14.63	35.0365
3	"Zenel Hajdini"	55	5188	25	45.45	30	54.55	47.00%	23	11	47.82%	32	22	68.75	25.85
4	"Dy Dëshmorët"	36	2813	4	11.11	32	88.89	39.23%	12	2	16.66%	24	2	8.33	14.1228
5	"Ibrahim Banushi"	36	2749	4	11.11	32	88.89	38.45%	18	1	5.55%	18	3	16.67	13.842
6	"Haradin Bajrami"	59	4231	9	15.25	50	84.75	42.97%	28	3	76.66%	31	6	19.35	25.3523
7	"Enin Duraku"	47	5115	29	61.70	18	38.30	54.32%	23	15	65.21%	24	14	58.33	25.5304
8	"Hasan Zyko Kamberi"	46	4180	18	39.13	28	60.87	46.00%	28	10	35.71%	18	8	44.44	21.16
9	"Migjeni"	34	2922	9	26.47	25	73.53	41.50%	18	4	22.22%	16	5	31.25	14.11
10	"Ernest Koliqi"	32	2761	11	34.38	21	65.63	56.03%	14	7	0.50%	18	4	22.22	17.9296
11	"Shijefën Gjeçovi"	23	1647	2	8.70	21	91.30	37.60%	9	2	22.22%	14	0	0.00	8.648
12	"Kadri Beba"	35	2729	7	20.00	28	80.00	41.10%	14	3	21.42%	21	4	19.05	14.385
13	"Skenderbeu"	24	1940	6	25.00	18	75.00	41.49%	14	5	35.71%	10	1	10.00	9.9576
14	Kater Dëshmoret	21	1494	2	9.52	19	90.48	35.00%	7	1	14.28%	14	1	7.14	7.35
15	"Vëllezërit Domanekn"	16	1266	3	18.75	13	81.25	40.00%	8	3	37.50%	8	8	100.00	6.4
16	"Hasan Prishtina"	17	1924	16	94.12	1	5.88	56.58%	8	8	100.00%	9	8	88.89	9.6186
17	"Ibrahim Krasniqi"	16	1857	13	81.25	3	18.75	58.03%	7	6	85.71%	9	6	66.67	9.2848
18	"Nezë Bujani"	11	1072	7	63.64	4	36.36	49.35%	2	2	100.00%	9	5	55.56	5.4285
19	"Felmi Agani"	11	975	3	27.27	8	72.73	46.00%	6	1	16.66%	5	2	40.00	5.06
20	"Drita"	10	1026	6	60.00	4	40.00	51.35%	4	2	50.00%	6	2	33.33	5.135
21	"Rexhep Aklapi"	7	458	1	14.29	6	85.71	31.28%	5	1	20.00%	2	0	0.00	2.1896
22	"Vezi Kolshi"	25	2037	3	12.00	22	88.00	39.16%	9	0	0.00%	18	3	16.67	9.79
23	"7 Marsi"	27	2633	11	40.74	16	59.26	48.76%	12	8	66.66%	15	3	20.00	13.1652
24	"17 Shkurti"	14	1565	7	50.00	7	50.00	49.21%	10	6	60.00%	4	1	25.00	6.8894
25	"Mehmet Akif"	42	5652	39	92.86	3	7.14	67.28%	25	24	96.00%	17	15	88.24	28.2576
26	"IMSK"	13	1814	13	100.00	0	0.00	69.76%	6	6	100.00%	7	7	100.00	426.746
	Gjithësejt	897	85,439						430	222	5162.79%	469	188	40.09	47.5748

Rezultatet e testit të maturës 2022

Nr.	Shkollat	Nr i nx. në testin e maturës	Numri i nx. që kanë kaluar	Positiv me %	Nr i nx. që nuk kanë kaluar	Negativ me %	Totali
1	SHMP "Adem Gllavica"	341	88	25.80	253	74.19	8797.8
2	Gjimnazi "Ulpiana"	507	420	82.84	87	17.16	41999.88
3	SHMLM - Shalë	52	25	48.07	27	51.92	2499.64
4	"Mehmet Akif"	67	66	98.50	1	1.49	6599.5
5	"IMSK"	12	10	83.33	2	16.67	999.96
Gjithësejt		979	609	62.21	370	37.79	60896.78
							62.20304

Planifikimi për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të (dhjetë) të Gjimnazeve dhe të shkollave Profesionale, për vitin shkollor 2022/2023

Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan

Nr.	Klasa	Drejtimi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1	X	Gjimnazi Natyror	6	192
2	X	Gjimnazi Shoqëror-Gjuhësor	7	224
Gjithsej:			13	416

Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan, paralelja e ndarë fizike në Gadime

Nr.	Klasa	Drejtimi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1	X	Gjimnazi Natyror	1	32
2	X	Gjimnazi Shoqëror-Gjuhësor	1	32
Gjithsej:			2	64

SHMLM "Shaqir Hoxha" në Shalë

Nr.	Klasa	Drejtimi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1	X	Gjimnazi Natyror	1	28
2	X	Gjimnazi Shoqëror-Gjuhësor	1	28
Gjithsej:			2	56

SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan

Nr.	Klasa	Drejtimi	Profili arsimor	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1	X	Ndërtimtari	Arkitekturë	2	54
2	X	Makineri	Instalues Elektrik	1	27
3	X	Makineri	Instalues i Ngrohjes e Klimatizimit dhe Ujësullësimit e Kanalizimit	1	27
4	X	Makineri	Metalpunues	1	27
5	X	Transport dhe trafik	Trafik Rrugor	1	27
6	X	Ekonomi	Banka financa dhe Sigurime	1	27
7	X	Ekonomi	Kontabilitet dhe Shitje	1	27
8	X	Ekonomi	Marketing dhe Shitje	1	27
9	X	Ekonomi	Logjistika dhe Operimi në	1	27

			Magazinë		
10	X	Juridik	Juridik-Administratë dhe shërbime të zyrës	2	54
11	X	Bujqësi	Agrobiznes	1	27
12	X	Bujqësi	Hortikulturë	1	27
13	X	Teknologji e Informacionit dhe komunikimit	Informatikë	1	27
Gjithsej:				15	405

SHMLM "Shaqir Hoxha" në Shalë

Nr.	Klasa	Drejtimi	Profili arsimor	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1	X	Ekonomi	Kontabilitet	1	28
2	X	Makineri	Automekanik	1	28
Gjithsej:				2	56

Suksesi i nxënësve në fund të periudhës së III-tretë për vitin shkollor 2021/2022 (1-5)

Suksesi i nxënësve në fund të Periudhës së tretë (III) të vitit shkollor, 2021/2022

Arsimi fillor (1-5)

Komuna: LIPJAN

Klasa	Grupi	Gjinia	Detyrimi	Suksesi pozitiv					Gjithsej me sukses të pamjaftueshëm					Mungesat	Orët mësimore			Mësimorja			
				Shkelqeshëm	Mirë	Mirë	Mirë	Mirë	pa kualifikim të pamjaftueshëm	pa kualifikim të pamjaftueshëm	pa kualifikim të pamjaftueshëm	pa kualifikim të pamjaftueshëm	pa kualifikim të pamjaftueshëm		pa kualifikim të pamjaftueshëm	pa kualifikim të pamjaftueshëm	pa kualifikim të pamjaftueshëm		pa kualifikim të pamjaftueshëm	pa kualifikim të pamjaftueshëm	
1	63	M	504	332	69	65	35	501	0	0	0	0	3	504	6289	1110	7399	14067	13700	367	3.85
		F	430	326	54	36	14	430	0	0	0	0	0	430	1845	614	1724				4.03
		GJ	934	658	123	101	49	931	0	0	0	0	3	934	8134	1724	9123				4.37
		%		70.45%	13.17%	10.81%	5.25%	99.68%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.32%	100.00%				100.00%	97.39%	2.61%	
2	60	M	511	293	102	75	40	510	0	0	0	0	1	511	4106	1129	5235	13227	12858	369	3.92
		F	460	303	84	45	25	457	0	0	0	0	3	460	1862	693	1822				3.85
		GJ	971	596	186	120	65	967	0	0	0	0	4	971	5968	1822	7857				4.33
		%		61.38%	19.16%	12.36%	6.69%	99.59%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.41%	100.00%				100.00%	97.21%	2.79%	
3	61	M	470	231	102	82	52	467	1	1	1	3	0	470	4459	1365	5834	15282	14976	306	3.51
		F	460	291	88	47	30	456	0	1	2	3	1	460	2027	1275	2640				3.79
		GJ	930	522	190	129	82	923	1	2	3	6	1	930	6496	2640	8474				4.01
		%		56.13%	20.43%	13.87%	8.82%	99.25%	0.11%	0.22%	0.32%	0.65%	0.11%	100.00%				100.00%	98.00%	2.00%	
4	64	M	519	220	114	119	52	505	5	2	6	13	1	519	4067	2395	6462	18101	17724	377	3.58
		F	462	308	82	44	22	456	2	1	3	6	0	462	2317	685	3080				3.97
		GJ	981	528	196	163	74	961	7	3	9	19	1	981	6384	3080	9542				4.13
		%		53.82%	19.98%	16.62%	7.54%	97.96%	0.71%	0.31%	0.92%	1.94%	0.10%	100.00%				100.00%	97.92%	2.08%	
5	53	M	507	220	119	110	50	499	3	0	3	6	2	507	4140	1133	5273	12403	12087	316	3.45
		F	475	292	90	60	32	474	0	0	0	0	1	475	1767	693	1826				4.21
		GJ	982	512	209	170	82	973	3	0	3	6	3	982	5907	1826	7099				4.33
		%		52.14%	21.28%	17.31%	8.35%	99.08%	0.31%	0.00%	0.31%	0.61%	0.31%	100.00%				100.00%	97.45%	2.55%	
1	301	M	2511	1296	506	451	229	2482	9	3	10	22	7	2511	23071	7132	30203	73080	71345	1735	3.66
		F	2287	1520	398	232	123	2273	2	2	5	9	5	2287	9818	3960	13778	100.00%	97.63%	2.37%	3.97
5	4798	GJ	4798	2816	904	683	352	4755	11	5	15	31	12	4798	32889	11092	13778				4.24
		GJ		58.69%	18.84%	14.24%	7.34%	99.10%	0.23%	0.10%	0.31%	0.65%	0.25%	100.00%							

Suksesi i nxënësve në fund të periudës së III-tretë për vitin shkollor 2021/2022 (6-9)

Suksesi i nxënësve në fund të Periudhës së tretë (III) të vitit shkollor, 2021/2022

Arsimi i mesëm i ulët (6-9)

Komuna: LIPJAN

Klasa	Grupi	Gjinia	Numri i nxënësve	Suksesi pozitiv						Githasë me sukses të pamjaftueshëm						Mungesat			Orët mësimore			Mësimorja
				Shkëlqyeshëm	Shkëlqim	Mirë	Mjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Githasë me sukses të pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	Pamjaftueshëm	
6	47	M	458	102	92	132	57	383	42	13	17	72	3	458	5305	1490	6795	12069	11487	582	3.10	
		F	402	158	120	80	21	379	15	4	0	19	4	402	2067	886	2376					3.41
		GJ	860	260	212	212	78	762	57	17	17	91	7	860	7372	2376	9171					3.60
		%		30.23%	24.65%	24.65%	9.07%	88.60%	6.63%	1.98%	1.98%	10.58%	0.81%	100.00%								100.00%
7	48	M	469	82	76	131	106	395	22	13	36	71	3	469	5749	2234	7983	13577	12734	843	2.91	
		F	396	168	99	77	36	380	10	1	3	14	2	396	2557	943	3177					3.45
		GJ	865	250	175	208	142	775	32	14	39	85	5	865	8306	3177	11160					3.49
		%		28.90%	20.23%	24.05%	16.42%	89.60%	3.70%	1.62%	4.51%	9.83%	0.58%	100.00%								100.00%
8	49	M	443	66	64	121	112	363	34	14	27	75	5	443	5436	3438	8874	13788	13194	594	2.77	
		F	452	187	108	91	33	419	18	4	9	31	2	452	2965	1475	4913					3.36
		GJ	895	253	172	212	145	782	52	18	36	106	7	895	8401	4913	13787					3.47
		%		28.27%	19.22%	23.69%	16.20%	87.37%	5.81%	2.01%	4.02%	11.84%	0.78%	100.00%								100.00%
9	45	M	447	66	98	144	90	398	14	14	17	45	4	447	5220	2577	7797	11674	10849	825	2.92	
		F	409	176	129	79	19	403	2	1	1	4	2	409	2420	1009	3586					3.44
		GJ	856	242	227	223	109	801	16	15	18	49	6	856	7640	3586	11383					3.57
		%		28.27%	26.52%	26.05%	12.73%	93.57%	1.87%	1.75%	2.10%	5.72%	0.70%	100.00%								100.00%
6	189	M	1817	316	330	528	365	1539	112	54	97	263	15	1817	21710	9739	31449	51108	48264	2844	2.93	
F		1659	689	456	327	109	1581	45	10	13	68	10	1659	10009	4313	14322	3.41					
GJ		3476	1005	786	855	474	3120	157	64	110	331	25	3476	31719	14052	14322	3.53					
%			28.91%	22.61%	24.60%	13.64%	89.76%	4.52%	1.84%	3.16%	9.52%	0.72%	100.00%									

Suksesi i nxënësve në fund të periudës së III-tretë për vitin shkollor 2021/2022 (10-12)

Suksesi i nxënësve në fund të Periudhës së tretë (III) të vitit shkollor, 2021/2022

Arsimi i mesëm i lartë (10-12)

Komuna: LIPJAN

Klasa	Gjinia	M	F	Gj	Suksesi pozitiv					Gjithësi me sukses të pamjaftueshëm					Përqindja	Orët mësimore	Muzezat			Përqindja	
					Shprehjet e shprehjes	Mbështetja	Mbështetja	Mbështetja	Mbështetja	Mbështetja	Mbështetja	Mbështetja	Mbështetja	Mbështetja			Mbështetja	Mbështetja	Mbështetja		Mbështetja
10	32	M	400	26	68	114	30	238	66	49	45	160	2	400	2989	2137	5126	8119	7835	284	2.90
		F	403	71	99	111	16	297	62	34	8	104	2	403	1919	827	2964				
		Gj	803	97	167	225	46	535	128	83	53	264	4	803	4908	2964	8090				
		%		12.08%	20.80%	28.02%	5.73%	66.63%	15.94%	10.34%	6.60%	32.88%	0.50%	100.00%							
11	32	M	396	39	48	97	45	229	60	72	28	160	7	396	3446	2755	6201	7610	7366	244	2.87
		F	370	79	92	97	14	282	43	31	11	85	3	370	2039	1232	3987				
		Gj	766	118	140	194	59	511	103	103	39	245	10	766	5485	3987	10188				
		%		15.40%	18.28%	25.33%	7.70%	66.71%	13.45%	13.45%	5.09%	31.98%	1.31%	100.00%							
12	38	M	421	39	74	151	75	339	42	21	0	63	19	421	2428	1832	4260	4873	4768	105	3.00
		F	406	140	122	109	19	390	7	4	0	11	5	406	1498	922	2754				
		Gj	827	179	196	260	94	729	49	25	0	74	24	827	3926	2754	7014				
		%		21.64%	23.70%	31.44%	11.37%	88.15%	5.93%	3.02%	0.00%	8.95%	2.90%	100.00%							
10	102	M	1217	104	190	362	150	806	168	142	73	383	28	1217	8863	6724	15587	20602	19969	633	2.93
		F	1179	290	313	317	49	969	112	69	19	200	10	1179	5456	2981	8437				
		Gj	2396	394	503	679	199	1775	280	211	92	583	38	2396	14319	9705	24024				
		%		16.44%	20.99%	28.34%	8.31%	74.08%	11.69%	8.81%	3.84%	24.33%	1.59%	100.00%							

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetarë)

- Takime të ndryshme me qytetarë, përkritazi me çështjet që ndërlidhen me Arsimin,
- Takime të vazhdueshme të Task forcës në nivel Komune, duke vlerësuar gjendjen dhe duke rekomanduar shkollat se si të veprojnë me rastet e paraqitura për personel dhe nxënës të shkollave,
- Takim me përfaqësues të policisë së Kosovës, me të cilët është diskutuar rreth realizimit të ligjëratave që janë me rëndësi për nxënësit në shkolla,
- Takime me përfaqësues të organizatave të ndryshme (The Ideas Partnership, Ipko Foundation, Vorae etj), me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë,
- Takim me përfaqësuesit e GIZ-it me të cilët është diskutuar rreth bashkëpunimit me shkollën ShFMU "Nezë Bujani" në Bujan dhe SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan të cilat janë duke e realizuar projektin "Aftësim për Punësim,
- Vizita e zëvendës ministrit të arsimit në Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, i cili ka parë nga afër implementimin e projekteve të digjitalizimit, projekt i financuar nga UNICEF-i,
- Takim i rregullt në MASHT rreth politikave të reja në procesin arsimor,
- Me përfaqësuesit e Shkollës Maarif-Qallapek dhe me përfaqësuesit e shkollës Mehmet Akif-Banullë me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellë,
- Takim me përfaqësuesit e UNICEF-it dhe Organizatës Qendër Humane dhe
- Takime të vazhdueshme me drejtorët e shkollave.

SFIDAT

- Mbrojtja nga infeksioni Covid-19, kundër të cilit janë marrë masat parandaluese,
- Orari i shkurtër i orës mësimore (minutazha e orës e shkurtuar),
- Zëvendësimi i personelit arsimor i cili gjatë kësaj kohe ka qenë i infektuar me Covid 19,

- Pamundësia e mbulueshmerisë së orëve mësimore në rastet kur kemi pasur mësimdhënës të cilët kanë qenë të infektuar me COVID-19,
- Pamundësia për të zëvendësuar punëtorët të cilët shkojnë në pushim mjekësor pa paralajmrim,
- Zvogëlimi i numrit të nxënësve në disa shkolla dhe
- Risistemimi i punëtorëve arsimor të cilët humbin normat për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve.

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajve janar-qershor 2022 kemi realizuar aktivitetet dhe punët e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport duke iu përshtatur aktivitetëve të zakonshme për një punë më të efektshme. Në këtë formë në DKRS janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale dhe qendrore.

Synim i yni edhe gjatë kësaj periudhe ka qenë që të arrihen suksese në funksion të aktivitetëve kulturore, rinore dhe sportive konform kopetencave që i kemi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE

Gjatë periudhës që lam pas kemi zhvilluar aktivitete të ndryshme. Është shënuar Ditën e Pavarësisë së Kosovës me një varg aktivitetesh, ku edhe këtë vitë është mbajtur turneu në futboll të vogël "Kupa e Pavarësisë 2022", po ashtu është mbajtur seanca solemne e Kuvendit të Komunës, është hapur ekspozita me emrin "E duam Kosovën" nga nxënësit e SHFMU "Vëllezërit Frashëri" dhe SHFMU "Ismail Luma", në bashkëpunim me DKRS-në, si dhe është mbajtur program artistik në shtëpinë e kulturës "Tahir Sinani". Gjithashtu janë nderuar të rënë me kurora lulësh, në ditën e Pavarësisë së Kosovës është dekoruar me mirënjohje sportistja e vitit 2021 Antoneta Budakova, si dhe është organizuar Marshi i Pavarësisë.

Më 31 mars 2022 Kuvendi i Komunës ka aprovuar Planin e Veprimtari Rinor Lokal 2022 – 2024. Ky plan është dokument strategjik që përfshin interes vitale dhe nevojat e të rinjve për një periudhë tre vjeçare dhe është hartuar përmes një procesi të gjerë konsultativ. Pra, për përcaktimin e prioriteteve strategjike dhe objektivave në kuadër të këtij plani, kemi organizuar takime konsultative si dhe draft – plani ka qëndruar për një muaj në diskutim publik.

Gjatë muajve janar – qershor 2022, DKRS ka organizuar aktivitete të ndryshme për të shënuar data të caktuara, siç janë: Dita e Martirëve të Komunës së Lipjanit ku janë nderuar të rënë për liri në ditët e tyre në fshatrat e komunës së Lipjanit, Sllavi, Ribar i Vogël, Hallaq i Vogël, Blinaj, Kleqk, Tërbusc, Leletiq, Akllap, Grackë e vogël. Është shënuar Dita e Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit u është organizuar akademi përkujtimore si dhe kemi nderuar me kurora lulësh dëshmorët në ditët e tyre të rënjes. Po ashtu janë organizuar aktivitete të ndryshme për Ditën e Çlirimit të komunës sonë, homazhe pranë varrezave dhe lapidarëve të dëshmorëve, homazhe dhe vendosja e luleve tek shtatorja e Adem Jasharit si dhe koncert festiv për të shënuar këtë ditë.

Në janar të vitit 2022 Komuna e Lipjanit, Kuvendi i Komunës ka themeluar komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport dhe kryesues i këtij komiteti është zgjedhur, Rinor Murati.

Në bashkëpunim me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare janë zhvilluar aktivitete të ndryshme rinore. Në bibliotekën e qytetit është mbajtur punëtorja 3 ditore PODIUM, me të rinjëve e Komunës së Lipjanit, ku nga 10 grupe pjesëmarrëse kanë fituar 5 projektet më të mira me ide më avokuese në të mirë të shoqërisë. Po ashtu aktivitete rinore janë zhvilluar edhe në bashkëpunim me organizatën Ipko Foundation.

Klubet Sportive po gjejnë përkrahje ta vazhdueshme nga Komuna e Lipjanit. Këtë periudhë janar – qershor janë përkrahur 19 Klube Sportive në vlerë prej 110,000.00 euro, ku në mes Komunës dhe Klubve Sportive janë nënshkruar kontratat e mbështetjes financiare nga thirrja publike.

DKRS po ashtu ka organizuar aktivitete sportive për shënimin e ditës Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe, është mbajtur maratona në vrapim "Know and address antigypsyism" e financuar nga VoRAE, tek shtigjet e ecjes, si dhe kemi përkrahur organizimin e turnireve tradicionale në futboll të vogël, "Shaqir Hoxha" dhe "Xhavit Kozhani".

Sa i përket sektorit të sportit, kemi kërkuar nga koordinatori i sportit që të hartoj një orar të klubeve sportive që shfrytëzojnë QAS-në, duke inkuadruar ekipet e reja.

DKRS ka zhvilluar takime të ndryshme në këtë periudhë raportuese. Kemi takuar përfaqësues së ambasadës amerikane për mundësinë e bashkëpunimit me komunën tonë, rreth projekteve në të mirë të të rinjve, kulturës dhe sportit në Lipjan, është mbajtur takimi me Ministrinë e Kulturës për mundësinë e bashkëpunimit për themelimin e tetarit të qytetit, si dhe është mbajtur takimi në mes të Ministrisë së Kulturës, UNDP-së dhe përfaqësues të Komunës së Lipjanit për projektin e rivitalizimit të Janjevës,

Gjatë kësaj periudhe janë kryer edhe pune dhe aktivitete të tjera:

Kemi përgaditur raportin vjetor të Bibliotekës së Qytetit, për Bibliotekën Kombëtar

Është realizuar ora e hapur e baletit "OPEN CLASS" në ambientin e hapur të sheshit "Adem Jashari", nga shkolla e baletit "Angels" në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit,

Janë dhuruar 170 ekzemplarë nga autori i tre librave Sefer Tasholli, për pasurimin e bibliotekës së qytetit të Lipjanit,

Një grup i vallëtarëve dhe një grup orkestral kanë marrë pjesë në festivalin mbarëkombëtar të instrumentistëve të vegjël në Fush Arrëz të Shqipërisë, ku nga juria vlerësohen me vendin e dytë,

Kemi përkrahur aktivitetin e 1 qershorit të organizuar në sheshin e qytetit të Lipjanit dhe po të njejtën ditë kemi nderuar me kurora lulesh fëmijën e vrarë në ditën e fëmijëve në 23 vjetorin e rënjes, Uran Amerllahun,

Kemi përkrahur dhe kemi marr pjesë në përrurimin e librit "Libri Magjik", të autore-mësuesës, Miradie Shamolli Leku, kemi bërë përrurimin e disa librave të botuar me financim të komunës së Lipjanit,

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

- Sektori i Arkivit është duke ju ofruar shërbime palëve sipas kërkesave të tyre.
- Biblioteka ofron shërbime konform kompetencave dhe kapacitetit të saj.
- Qendra sportive në Lipjan ka vazhduar punën sipas orarit të zakonshëm.
- Qendra Rinore në Magure është duke punuar sipas orarit.

Në vazhdim paraqesim raportin në formën tabelare:

ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Proces	Të Pazgjidhura
99	75	23	1	-

Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)
56	37	326 faqe

Raport për Bibliotekën e Qytetit në Lipjan

Vendi	Libra në huazim	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Lexues në sallën e leximit	Libra të dhuruara
Sektori për fëmijë	1018	982	294	2368	110
Sektori për të rritur	620	691	245	3765	275

Raport për Bibliotekën në Gadime

Libra në huazim	Libra të kthyer	Lexues të rinj
848	844	115

Raport për Bibliotekën në Shalë

Libra në huazim	Libra të kthyer	Lexues të rinj
85	80	12

DISKUTIME PUBLIKE

- Kemi realizuar një diskutim publik me të rinjtë e komunës së Lipjanit në muajin shkurt të vitit 2022,
- Plani Veprimi Rinor Lokal ishte në diskutim publik për plotë një muaj.

DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA

HYRJE

Raporti përfshinë të dhënat gjashtë mujore nga sektorët e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa: Sektori i Buxhetit dhe Financave duke përfshirë të dhënat nga Regjistrimi i Pasurisë Komunale dhe Arka, Sektori i Thesarit dhe Sektori i Tatimit në Pronë.

Realizimi (shpenzimi) i Buxhetit të aprovuar (planifikuar) për gjashtë mujor është në vlerë 6,814,072.76€ shprehur në përqindje 35.40%.

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

Buxheti i Komunës së Lipjanit deri në këtë periudhë është në vlerë 19,248,201.10€ dhe financohet nga fondet burimore, grant qeveritar 15,572,604.56€ dhe hyra vetanake në vlerë 2,108,823.00€, të hyrat e bartura 1,000,914.15€ si dhe donacionet 565,859.39€.

Pjesëmarrja e te hyrave vetanake në buxhetin e planifikuar, shprehur në përqindje, është 10.95%.

Në këtë periudhë raportuese janë kryer këto punë:

- Përgaditja dhe dorëzimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2021.
- Përgaditja dhe dorëzimi i planit të rrjedhës së parasë për vitin 2022.
- Alokimi i mjeteve në fillim të vitit buxhetor si dhe zotimi i mjeteve menjëherë pas alokimit.
- Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara të vitit 2021 në vlerë 1,000,914.15€.
- Pyetësori i Vetëvlerësimit për vitin 2021
- Raportimi në Kuvendin Komunal për shpenzimin vjetor të buxhetit 2021, realizimit të investimeve kapitale dhe realizimin e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2021.
- Faza finale e Auditimit të Komunës së Lipjanit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021.

Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025

Bazuar në Qarkoren e Parë Buxhetore 2023/01, KAB-i është analizuar në strukturat Komunale, është prezentuar në Bordin e Drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete, duke vazhduar në zhvillimin dhe përpilimin e KAB-it 2023-2025, kemi organizuar 11 takime të ndryshme (me Kuvend, Komitete, shoqëri civile, OJQ të ndryshme, shoqata të ndryshme, klube sportive, qytetar etj), ku është diskutuar në debate publike Korniza Afatmesme Buxhetore, e cila është pjesë e KASH të Kosovës në perputhje me procedurat buxhetore 2023-2025, të dhëna nga Ministria e Financave, përmes Qarkores Buxhetore .

Po ashtu ky draft dokument i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025, është dërguar në Kuvendin Komunal për aprovim brenda afatit të caktuar kohor. Buxheti i përgjithshëm i planifikuar për vitin fiskal 2023 sipas Qarkores buxhetore 2023/01 me kufijtë fillestar buxhetor kap shumën prej 19,779,849.00€.

Fondet burimore për financim të KAB 2023-2025

FONDI BURIMOR	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025
Grant i Përgjithshëm	8,013,741.00	8,592,891.00	9,159,431.00
Grant Specifik i Arsimit	7,104,836.00	7,660,503.00	7,694,457.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	2,140,282.00	2,247,296.00	2,359,661.00
Të hyrat vetanake	2,337,990.00	2,418,104.00	2,507,742.00
Financimi Sherbimet Rezedenciale	183,000.00	185,000.00	185,000.00
TOTALI	19,779,849.00	21,103,794.00	21,906,291.00

Mjetet janë shpërndarë në kategoritë ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025
Paga e Mëditje	10,327,157.00	10,550,000.00	10,650,000.00
Mallra dhe Shërbime	3,013,000.00	3,200,000.00	3,500,000.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	370,000.00	380,000.00	400,000.00
Subvencione dhe Transfere	962,000.00	980,000.00	990,000.00
Investimet Kapitale	5,107,692.00	5,993,794.00	6,366,291.00
TOTALI	19,779,849.00	21,103,794.00	21,906,291.00

Raportimet periodike për shpenzimin e buxhetit të vitit 2022

Duke u bazuar në raportin përmbledhës nga free bilanci kemi përpiluar raportet përmbledhëse për realizimin e Buxhetit Komunal dhe kemi raportuar në baza të rregullta te ZKA, Ministri i Financave, Drejtoratet komunale dhe Kuvendin Komunal. Raportimet periodike të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa janë bërë si vijon:

- Raportet javore për realizimin e Buxhetit Komunal dhe aktivitetet gjatë periudhës raportuese, raportet mujore të cilat janë publikuar në Web-faqen e Komunës së Lipjanit, raportet mujore për obligimet financiare të raportuara në MF,
- Raportet tre mujore të shpenzimit të Buxhetit para Asamblesë Komunale si dhe raportet tre mujore për Ministrinë e Financave, dhe
- Raporti gjashtë mujor i shpenzimeve për Kuvendin Komunal.

Shpenzimi i buxhetit sipas fondeve burimore në gjashtëmujorin e parë është si vijon:

Kategoritë ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	% shpenz.
GRANTI QEVERITAR	15,572,604.56	6,210,378.77	39.88
TE HYRAT VETANAKE	2,108,823.00	519,566.21	24.64
TE HYRAT VETANAKE TE BARTURA	1,000,914.15	84,127.78	8.41
DONACIONET E BARTURA	565,859.39	0.00	0.00
Gjithsejtë:	19,248,201.10	6,814,072.76	35.40

Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike në gjashtë mujorin e parë është si vijon:

Kategoritë ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	% shpenz.
PAGA DHE MEDITJE	5,144,041.49	5,031,254.21	97.81
MALLRA DHE SHERBIME	1,114,475.61	705,638.81	63.32
SHPENZIME KOMUNALE	182,475.03	120,322.27	65.94
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	418,142.86	257,383.00	61.55
INVESTIME KAPITALE	5,258,286.12	1,803,836.68	34.30
Gjithsejtë:	12,117,421.11	7,918,434.97	65.35

Tabela në vijim ofron informata rreth progresit lidhur me secilin nga projektet kapitale :

Shpenzimet në investime kapitale Janar-Qershor me buxhet	Buxheti për financimin e investimeve kapitale	Shpenzimi për investime kapitale
10 BUXHETI	3,411,947.00	497,021.56
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	2,437,926.00	436,447.97
43089 ASFALTIMI I RRUGES HALLAQ I MADH-RUFÇI RI	68,000.00	0.00
44511 BASHKFINANÇIMI ME DONATOR	65,500.00	29,858.95
45389 NDERTIMI I SHTRATIT TE LUMIT NE GLOGOVÇ	50,000.00	0.00
45396 NDERTIMI I SHTRATIT TE LUMIT NE RIBAR TE MADH	50,000.00	45,737.19
47389 NDËRTIMI I TROTUARËVE ME NDRIQIM PUBLIK NË QALLAPEK	55,000.00	0.00
47440 NDËRTIMI I RRETHOJAVE DHE INFRASTRUKTURES SË VARREZAVE NË TË GJITHA FSHATRA T E KOMUNESSE LIPJANIT	70,000.00	0.00
47780 NDËRTIMI I OBJEKTIT TË RI TË ADMINISTRATËS KOMUNËS LIPJAN	181,268.00	150,000.00
47955 TROTUARET ME NDRIQIM PUBLIK NË GLLAVIÇË DHE MAREVC	68,000.00	0.00
49139 NDERTIMI I SHTRATIT TE LUMIT NE SMALLUSHE	50,000.00	0.00
49150 TROTUARET ME NDRIQIM PUBLIK NE AKLLAP	72,000.00	0.00
49154 ASFALTIMI I RRUGES RIBAR I MADH-RIBAR I VOGEL	52,000.00	0.00
49158 NDERTIMI I RRUGES GRYKA E SHPETIMIT NE KROIMIR	25,426.00	0.00
49162 NDERTIMI I KOLEKTORIT TE UJRAVE TE ZEZA PER FSHATRA T BLINAJ,QYLAGE DOBRAJE E MADHE	90,000.00	0.00
49399 VAZHDIMI I NDERTIMIT TE SHESHIT ADEM JASHARI PJESA II	60,000.00	0.00
50786 NDERTIMI I SHETITORES TE PISHAT NE GADIME	9,500.00	7,237.11
50789 ASFALTIMI I RRUGICAVE , TROTUA REVE, NDRIQIMI PUBLIK I BREGU I ZI	7,636.00	7,544.84
50793 ASFALTIMI I RRUGEVE NE LIPJAN FAZA III	75,000.00	0.00
50797 ZGJERIMI I RRJETIT TE KANALIZIMIT NE GLLAVIÇE, MAGURE , DOBRAJË	35,000.00	29,338.26
50846 NDRIQIMI PUBLIK NE TEQE DHE ZGJERIMI I NDRIQIMIT NE JANJEVE	34,000.00	0.00
50871 NDRIQIMI PUBLIK NE MIRENE	45,000.00	0.00
50874 NDERTIMI I RRUGES BUJAN DERI TE RRUGA PER KRAISHTE	88,000.00	0.00
51309 ASF.RR.NE RUB,JANJ,AKLLAP,RUFÇI,BANU,ZLLAK,KROJM.DHE VERSHVC	133,000.00	0.00
51313 ZGJ.RR.JE TE KAN.FAZA E II , VER,KROJM,GADIME, RIBAR I MADH	12,000.00	2,284.62
51314 ZGJ.NDRIQ.PUBLIK LAGJ. F. MAGURE F2 DHE NË HYRJE TË F.SLOVI	20,000.00	0.00
51407 MJELLJA E DRUNJVE DEKORATIV NE RR.QYTETIT DHE RRUGET LOKALE	40,000.00	0.00
51409 NDERTIMI I RRJETIT TE UJESJELLSIT NE BLINAJ -LELETIQ	60,000.00	0.00
51410 VAZHDIMI I NDERTIMIT TE SHTRATIT TE LUMIT NE GADIME	50,000.00	0.00
51411 RIKO.RR.NE RIBAR TE MADH(RR.VEHBI KOZHANI E BEQIR DURIQI,)	70,000.00	0.00
51413 RIKONSTRUIMI I RRUGES POTUROVÇ- DOBRAJE TE MADHE	75,000.00	0.00
51414 SHITIGJET E ECJES NE SLOVI	50,000.00	0.00
51415 SHITIGJET E ECJES NE GADIME FAZA E DYTE	50,000.00	0.00
51420 RREG.SHTRATIT LUMIT JANJEVKA NE LAGJEN E KONJUHIT NE LIPJAN	50,000.00	0.00
51428 RIKONSTRUIMI I RRUGES ZYLFIË GASHI NE LIPJAN	55,000.00	55,000.00
51429 ND.RR.LAGJET FSH.SLLO,GAD,SMALL,GOMASE,LLUGAXHI,BABU.FAZA IV	110,000.00	0.00
52159 ANEKSET E RRJETIT TE KANALI. NE LIPJAN,GADIME,DOBRAJE E MADHE	50,000.00	0.00
52160 HAPJA E RUGEVE TE REJA BRENDA NE QYTETIN E LIPJANIT	170,000.00	109,447.00
52161 ANEKSE NE RRJETIN E UJES.BREN.NE QYTETIN E LIPJANIT FAZA II	40,000.00	0.00
89225 ASFAL.RRUG.SHQ.HAJ.BAJRAMI	106,596.00	0.00
89262 RRJETI I UJESJELLSIT PER FSHATIN AKLLAP	45,000.00	0.00
73200 SHËRBIMET E KUJESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - LIPJAN	131,741.00	0.00
40202 BLERJA E AUTOAMBULANCËS	60,000.00	0.00
50888 BLERJA APARATURAVE MJEKSORE	40,000.00	0.00
52162 RENOVIMI I QMF-së NË FSHATRA T SHALË DHE MAGURË FAZA II	31,741.00	0.00
75512 SHËRBIMET REZIDENCIALE - LIPJAN	5,000.00	0.00
51426 FASADIMI DHE IZOLIMI I ANEKSI OBJEKTIT ME BAZEN NE KOMUNITET	5,000.00	0.00
85003 SHËRBIMET KULTURORE -LIPJAN	305,000.00	8,057.74
49379 NDËRTIMI I PALESTRES SË RE SPORTIVE NË LIPJAN	100,000.00	0.00
50884 NDERTIMI I SALLES SPORTEVE NE GLOGOVÇ	70,000.00	0.00

51422 NDERTIMI I FUSHAVE TE HAPURA SPORTIVE NE GLLAVIC,MAREVC,	55,000.00	8,057.74
52163 ND.UL.PER SHIKUES DHE VENDOSJA E BARIT ART.NE FUSHAT E HAPUR	80,000.00	0.00
92250 ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHE - LIPJAN	267,280.00	52,515.85
45421 NDERTIMI I QERDHESE FEMIJVE NE RUFC TE RI	65,000.00	0.00
47444 NDERTIMI I QERDHESE FEMIJVE NE SLOVI	77,280.00	52,515.85
50885 NDERTIMI I QERDHESE NE SHALE	60,000.00	0.00
52164 NDË.KËNDEVE TË LOJRAVE PËR FEMIJË NË LIPJAN,SLOVI ,GADIME.	65,000.00	0.00
93060 ARSIMI FILLOR - LIPJAN	265,000.00	0.00
51091 NDERTIM I SHKOLLES SE RE NE RIBAR TE MADHE	100,000.00	0.00
52165 RENOVIMET E SHKOLLAVE PARALELE TË NDARA NË JETA E RE, KONJUH	70,000.00	0.00
52166 NDËRTIMI I PARQEVE DHE LOJRAVE PËR FEMIJË NË SHKOLLAT FILLOR	95,000.00	0.00
21 TE HYRAT VETANAKE	1,201,705.00	150,000.00
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	1,151,705.00	150,000.00
44511 BASHKFINANCI MI ME DONATOR	75,000.00	0.00
47780 NDËRTIMI I OBJEKTIT TË RI TË ADMINISTRATËS KOMUNËS LIPJAN	497,131.00	150,000.00
49154 ASFALTIMI I RRUGES RIBAR I MADH-RIBAR I VOGEL	30,000.00	0.00
49158 NDERTIMI I RRUGES GRYKA E SHPETIMIT NE KROIMIR	104,574.00	0.00
49162 NDERTIMI I KOLEKTORIT TE UJRAVE TE ZEZA PER FSHATRA T BLINAJ,QYLAGE DOBRAJE E MADHE	20,000.00	0.00
51309 ASF.RR.NE RUB,JANJ,AKLLAP,RUFC,BANU,ZLLAK,KROJM.DHE VERSHVC	50,000.00	0.00
89225 ASFAL.RRUG.SHQ.HAJ.BAJRAMI	375,000.00	0.00
85003 SHËRBIMET KULTURORE -LIPJAN	50,000.00	0.00
49379 NDËRTIMI I PALESTRES SË RE SPORTIVE NË LIPJAN	50,000.00	0.00
22 TË HYRAT VETANAKE- 2021	641,411.70	0.00
16303 ADMINISTRATA - LIPJAN	95,000.00	0.00
52169 BLERJA E VETURAVE PËR ADMINISTRATËN KOMUNALE	95,000.00	0.00
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	322,828.75	0.00
47780 NDËRTIMI I OBJEKTIT TË RI TË ADMINISTRATËS KOMUNËS LIPJAN	178,000.00	0.00
51191 NDERTIMI I SHTRATIT TE LUMIT JANJEVKA NE LIPJAN	20,613.01	0.00
51429 ND.RR.LAGJET FSH.SLLO,GAD,SMALL,GOMASE,LLUGAXHI,BABU.FAZA IV	124,215.74	0.00
73200 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - LIPJAN	118,228.00	0.00
50888 BLERJA APARATURAVE MJEKSORE	30,000.00	0.00
51201 ND.RR.PAR.PARK.NE QMF LIPJ.DHE AMF DOB.MA.BAB.GAD.DHE KRAISH	23,228.00	0.00
52170 RENOVIMI I TUALETEVE TË QKMF-VE LIPJAN	26,000.00	0.00
52171 RREGULLIMI I DYSHEMESË ME EXPOXIT NË QKMF LIPJAN	20,000.00	0.00
52172 RENOVIMI I QKMF-SË LIPJAN FAZA II	19,000.00	0.00
85003 SHËRBIMET KULTURORE -LIPJAN	55,354.95	0.00
42097 RREGULLIMI STADIUMIT NE DOBRAJ TE MADHE DHE MAGURE FAZA II	5,354.95	0.00
49379 NDËRTIMI I PALESTRES SË RE SPORTIVE NË LIPJAN	50,000.00	0.00
92250 ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHE - LIPJAN	50,000.00	0.00
52173 BLERJA E PAJISJEVE PËR QERDHE NË GADIME DHE SLOVI	50,000.00	0.00
31 GRANT I DONAT.TË MBRENDSHËM	745.21	0.00
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	553.54	0.00
72010 MEREMETIMI I KANALIZIMIT NE FSHATIN BUJAN	8.50	0.00
72011 RREGULLIMI I VENDKALIMIT LIPJAN-SHTIME	24.00	0.00
72210 NDERTIMI KANALIZIMI FEKAL LIPJAN-BANULL	10.00	0.00
72358 RREGULLIMI I KANALIZIMIT FEKAL-MIRENE	11.04	0.00
92064 RREG.RRJET.SEKOND,KANALIZ.NE FSHATIN MEDVEC	500.00	0.00
47003 BUJQËSIA - LIPJAN	191.67	0.00
72332 BLERJA E MAKINAVE MJELESE	191.67	0.00
52 QEVERIA GJERMANE	2.58	0.00
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	2.58	0.00
95286 NDERTIMI I QENDRES INFORMUESE TURISTIKE	2.58	0.00
61 QEVERIA ZVICRANE	557,583.63	0.00
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	557,583.63	0.00

92069 NGRITJE E PERFORMANCËS 2020	3,028.69	0.00
92111 PERFORMANCA KOMUNALE 2021	55.62	0.00
92136 MBË.FINA.TË PROJ.NGA SKEMA E GRANTIT PËR PERFORMANC.KOMUNALE	554,499.32	0.00
93 COUNCIL OF EUROPE	748.50	0.00
18163 INFRASTRUKTURA PUBLIKE - LIPJAN	747.10	0.00
99347 PROM.QEVERIS.SE MIRE DHE FUQIZ.ROMEVE NE NIV.LOKAL	747.10	0.00
85003 SHËRBIMET KULTURORE -LIPJAN	1.40	0.00
99347 PROM.QEVERIS.SE MIRE DHE FUQIZ.ROMEVE NE NIV.LOKAL	1.40	0.00
Totali:	5,814,143.62	647,021.56

Zotimet e mjeteve

Gjatë kesaj periudhe janë zotuar gjithësejt 573 lëndë në vlerë 3,669,633.70€, prej tyre mallra dhe shërbime 387 lëndë në vlerë 715,295.88€, komunalit 37 lëndë në vlerë 103,788.88€, subvencione 101 lëndë në vlerë 404,653.50€ kapitale 5 lëndë në vlerë 2,445,895.44€ dhe 504 urdhërblere.

Realizimi i të hyrave vetanake në gjashtëmujorin e vitit 2022

Buxheti i Planifikuar për Komunën e Lipjanit për vitin 2022 është në vlerë prej 2,108,823.00€. Realizimi i të hyrave vetanake gjatë gjashtëmujorit të parë në krahasim me planifikimin e të hyrave vetanake është 54.15% ose shprehur në vlerë 1,141,970.77€.

Planifikimi i të hyrave nga Tatimi në Pronë për vitin 2022 është 1,201,705.00€. Realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë për këtë gjashtëmujor, krahasuar me planifikimin është 46.80 ose shprehur në vlerë 562,390.58€.

Të hyrat vetanake të realizuara deri më 30.06.2022 është paraqitur në tabelën e më poshtme:

Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake, periudha Janar-Qershor 2022

Kodet Ekonomike	Planifikimi 2022	Realizimi 2022	Indeksi %	
16303 - ADMINISTRATA-LIPJAN				
50013 - TAX CERTIFIKATAT E LINDJES	30,000.00	22,693.00	75.64	-24.36
50014 - TAX CERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	3,500.00	1,655.00	47.29	-52.71
50015 - TAX CERTIFIKATAT E VDEKJES	1,500.00	357.00	23.80	-76.20
50016 - TAX CERTIFIKATA TJERA	23,000.00	1,221.00	5.31	-94.69
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	8,000.00	3,344.50	41.81	-58.19
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	10,000.00	1,292.14	12.92	-87.08
50019- QENDRA PER SHERBIME SOCIALE	2,000.00	0.00	0.00	-100.00
50107 - GJOBAT TJERA	5,000.00	0.00	0.00	-100.00
16715 - PROKURIMI				
50020 - TAX E PJESMARJES NË TENDER	1,500.00	1,500.00	100.00	0.00
17503 - BUXHETIMI-LIPJAN				
50002 - TAX RRUGORE	100,000.00	62,909.00	62.91	-37.09
40110 - TATIMI NË PRONË	1,201,705.00	562,390.58	46.80	-53.20
- TATIMI NE TOKE				
48003 - PLANIF.ZHV.EKONOM-LIPJAN		0.00		
50290 - LIC.TJERA PËR AFARIZËM	1,000.00	0.00	0.00	-100.00
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	49,000.00	12,161.40	24.82	-75.18
16605 - INSPEKSIONI-LIPJAN				
50104 - GJOBAT MANDTORE	3,500.00	40.00	1.14	-98.86
50205 - LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	6,000.00	1,775.00	29.58	-70.42
65015 - SHËRBIMET KADASTRALE-LIPJAN				
50017 - TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRYSHME	40,000.00	11,572.00	28.93	-71.07
50011 - TAX REGJISTRIMIN E TRASHIGIMIS	55,000.00	31,363.00	57.02	-42.98
50504 - TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	40,000.00	28,768.00	71.92	-28.08
66320 - PLANIF.URBAN.INSPEKC.-LIPJAN				
50009 - TAX PËR LEJE NDËRTIMI	86,618.00	70,501.26	81.39	-18.61
50013 - TAX NDERRIMI DESTINIMI I TOKES	40,000.00	11,247.00	28.12	-71.88
50026 - TAX PER LEGALIZIMIN E OBJEKTE.	40,000.00	4,897.57	12.24	-87.76
50045 -TAX PER LEJE MJEDISORE	30,000.00	5,697.54	18.99	-81.01

20010- TAX PER DEMOLIM (rrenimi i objekteve)	2,000.00	384.08	19.20	-80.80
18163 - INFRASTRUKTURA PUBLIKE				
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	15,000.00	10,793.58	71.96	-28.04
50406 - PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	55,000.00	13,674.68	24.86	-75.14
50103- LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJETEVE	2,000.00	0.00	0.00	-100.00
50019- TAX TJERA ADMINISTRATIVE	500.00	0.00	0.00	-100.00
50029- TAX PER USHTRIMIN E VEPRIMTARIS	2,000.00	0.00	0.00	-100.00
85003 - SHËRBIMET KULTURORE-LIPJAN				
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE (RHIVA)	500.00	137.50	27.50	-72.50
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	500.00	0.00	0.00	-100.00
GJITHESEJT I:	1,854,823.00	863,554.83	46.56	-53.44
92250 - ARSIMI PARAFI & QERDHJA-LIPJAN	45,000.00	37,923.00	84.27	-15.73
73200 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETESIA 73200- 50409	48,000.00	20,845.00	43.43	-56.57
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE (PARTICIPIM) A.GLLAVICA	10,000.00	9,324.00	93.24	-6.76
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	500.00	0.00	0.00	-100.00
50409- SHKOLLA E MESME ULIPIANA	500.00	43.00	8.60	-91.40
GJITHESEJT II:	1,958,823.00	931,689.83	47.56	-52.44
GJOBAT E TRAFIKUT	100,000.00	185,247.50	185.25	85.25
GJOBAT E GJYKATES	49,500.00	24,755.00	50.01	-49.99
AGJENCIONI I PYJEVE	500.00	278.44	55.69	-44.31
GJITHESEJT III:	2,108,823.00	1,141,970.77	54.15	-45.85
DONACIONET		554,499.32		
GJITHESEJT IV:	2,108,823.00	1,696,470.09	80.45	-19.55

Krahasimi i të hyrave vetanake 2021-2022 Janar- Qershor

Kodet Ekonomike	Realizimi 2021	Realizimi 2022	Indeksi	%
16303 - ADMINISTRATA-LIPJAN				
50013 - TAX CERTIFIKATAT E LINDJES	17,446.00	22,693.00	130.08	30.08
50014 - TAX CERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	936.00	1,655.00	176.82	76.82
50015 - TAX CERTIFIKATAT E VDEKJES	618.00	357.00	57.77	-42.23
50016 - TAX CERTIFIKATA TJERA	1,564.00	1,221.00	78.07	-21.93
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	3,487.00	3,344.50	95.91	-4.09
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	0.00	1,292.14	#DIV/0!	#DIV/0!
50019- QENDRA PER SHERBIME SOCIALE	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50107 - GJOBAT TJERA	3,000.00	0.00	0.00	-100.00
16715 - PROKURIMI				
50020 - TAX E PJESMARJES NË TENDER	320.00	1,500.00	468.75	368.75
17503 - BUXHETIMI-LIPJAN				
50002 - TAX RRUGORE	55,880.00	62,909.00	112.58	12.58
40110 - TATIMI NË PRONË	549,148.79	562,390.58	102.41	2.41
- TATIMI NE TOKE				
48003 - PLANIF.ZHV.EKONOM-LIPJAN				
50290 - LIC.TJERA PËR AFARIZËM	0.00	0.00		
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	15,444.03	12,161.40	78.74	-21.26
16605 - INSPEKSIONI-LIPJAN				
50104 - GJOBAT MANDTORE	90.00	40.00	44.44	-55.56
50205 - LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	1,201.00	1,775.00	147.79	47.79
65015 - SHËRBIMET KADASTRALE-LIPJAN				
50017 - TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRYSHME	15,778.00	11,572.00	73.34	-26.66
50011 - TAX REGJISTRIMIN E TRASHIGIMIS	29,130.00	31,363.00	107.67	7.67
50504 - TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	18,340.00	28,768.00	156.86	56.86
66320 - PLANIF.URBAN.INSPEKC.-LIPJAN				
50009 - TAX PËR LEJE NDËRTIMI	284,953.45	70,501.26	24.74	-75.26
50013 - TAX NDERRIMI DESTINIMI I TOKES	48,441.00	11,247.00	23.22	-76.78
50026 - TAX PER LEGALIZIMIN E OBJEKTE.	5,009.23	4,897.57	97.77	-2.23
50045 - TAX PER LEJE MJEDISORE	24,275.93	5,697.54	23.47	-76.53
20010 - TAX PER DEMOLIM (rrenimi i objekteve)	1,450.11	384.08	26.49	-73.51
18163 - INFRASTRUKTURA PUBLIKE				
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	1,475.00	10,793.58	731.77	631.77

50406 - PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	13,175.84	13,674.68	103.79	3.79
50103- LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJETEVE	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50029- TAX PER USHTRIMIN E VEPRIMTARIS				
85003 - SHËRBIMET KULTURORE-LIPJAN				
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE (RHIVA)	143.50	137.50	95.82	-4.18
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
GJITHESEJT I:	1,091,696.88	863,554.83	79.10	-20.90
92250 - ARSIMI PARAFI & QERDHJA-LIPJAN	30,289.00	37,923.00	125.20	25.20
73200 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETESIA 73200- 50409	16,300.50	20,845.00	127.88	27.88
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE (PARTICIPIM) A.GLLAVICA	6,446.00	9,324.00	144.65	44.65
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
50409- SHKOLLA E MESME ULIPIANA	36.00	43.00	119.44	19.44
GJITHESEJT II:	1,144,768.38	931,689.83	81.39	-18.61
GJOBAT E TRAFIKUT	89,383.50	185,247.50	207.25	107.25
GJOBAT E GJYKATES	25,395.00	24,755.00	97.48	-2.52
AGJENCIONI I PYJEVE	0.00	278.44	#DIV/0!	#DIV/0!
GJITHESEJT III:	1,259,546.88	1,141,970.77	90.67	-9.33
DONACIONET	347,947.57	554,499.32	159.36	59.36
GJITHESEJT IV:	1,607,494.45	1,696,470.09	105.54	5.54

SEKTORI I THESARIT

Gjatë kësaj periudhe kohore në Sektorin e Thesarit janë pranuar dhe janë kryer gjithsejt: 1,804 lëndë në vlerë 2,091,849.87€, të gjitha këto lëndë janë bërë shpenzim, janë çertifikuar, Aprovuar në SIMFK pastaj janë regjistruar dhe i janë dorzuar zyrtarit të arhives për arhivim.

Kategorit Ekonomike	Nr.i Lëndëve	Shuma	%
Mallra e Sherbime	904	881,313.56	42.13%
Komunalit	657	152,663.25	7.30%
Subvencione dhe Transfere	222	410,851.50	19.64%
Investime Kapitale	21	647,021.56	30.93%
Totali i shpenzimev në këto kategori ekonomike:	1,804	2,091,849.87	100.00

Tabela e mjetëve të ekzekutara nga Thesari Qendror dhe Përmbauesi Privat për të paguar obligimet financiare të trashëguara nga vitet paraprake:

Mjetet financiare nga janë marrur-Vendim gjyqësor	Kodi ekon.	Shuma	Qellimii pageses -Vendim gjyqësor
Zyra e Kryetarit	14410	250.00	Mallra dhe sherbime
Nga kategoria ekonomike paga dhe meditje -Administrata	11900	7,959.99	Paga dhe meditje
Nga kategoria ekonomike investime kapitale (projekti) 50786 NDERTIMI I SHETITORES TE PISHAT NE GADIME	34000	7,237.11	Nga kategoria ekonomike investime kapitale (projekti) MJETET E DEDIKUARA PER SHPRONSIM
Nga kategoria ekonomike paga dhe meditje -Arsim	11900	37,146.31	Paga dhe meditje
Gjithësejt:		52,343.41	

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjashtë muhori i parë i vitit 2022 i sektorit të tatimit në pronë mundë të llogaritet si një periudhë shumë e suksesshëm.

Në fillimi të vitit 2022, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, gjegjësisht Departamentin e Tatimit në Pronë kemi nxjerre dhe printuar me kohe faturat e tatimit në pronë për vitin 2022, të cilat janë shpërndarë përmes PTK-se. Nga raporti i PTK qe kemi pranuar faturën e shpërndarjes, gjithësej fatura të shpërndara nga PTK janë 14,079 fatura, ku prej të gjitha faturave 1,079 fatura janë kthyer në mungesë adrese.

Në zyrën e tatimit në pronë, sipas kërkesave të tatimpaguesëve dhe për nevoja të tatimpagueseve, periudhës Janar-Qershor, janë printuar përafërsisht 22650 fatura.

Gjatë periudhës Janar- Qershor gjithsej 36 ankesa të tatimpagueseve të cilët nuk janë pajtuar me ngarkesën e tatimit në pronë kanë bërë ankesë pranë zyrës së tatimit në pronë. Prej 36 ankesave 26 ankesa janë aprovuar në favor të tatimpaguesve, ndërsa 10 ankesa janë refuzuar si rezultat të pa bazuara.

Po ashtu kemi edhe kërkesa të tjera të cilat janë prashtruar nga tatimpaguesit, në zyrën e tatimit në pronë si për shembull: kërkesë për ndërrim të pronarit, ndërtime të pronave të reja, apo rrënim të pronave dhe ekipi i zyrtarëve për vlerësim të pronave të paluajtshme kanë dalë në teren për të bërë verifikimin atyre pronave. Numri i kërkesave të tilla është 271 kërkesa, ku 243 janë aprovuar, 9 kërkesa janë refuzuar nga ekipi anketues, 19 kërkesa janë në proces.

Numri i kërkesave të aprovuara të tatimpaguesve për të hyrë në marrveshje për pagesën e tatimit me këste është 85. 6,103 certifikata janë lëshuar me qëllim të regjistrimit të veturave, ndërsa 4170 certifikata janë lëshuar me qëllim të kryerjes së shërbimeve në katastrofë dhe urbanizëm, për subvencione në bujqësi si dhe vërtetime për humbje të nënshtesisë.

Sipas evidencës që e mbanë zyra e tatimit të pronë, inkasimi i të hyrave nga tatimi në pronë gjatë kësaj periudhe është në vlerë 533,298.79€ për objekte, dhe 29,446.25€ për parcela.

Regjistrimi i Pasurisë Komunale

Gjatë kësaj periudhe është bërë regjistrimi i pasurisë kapitale dhe jo kapitale në Simfk, E-pasuri dhe Excel.

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë këtij gjashtëmujori të parë të vitit 2022 në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale, si dhe obligime të tjera nga e drejta pozitive në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Komunikim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë lidhur me çështjen e ndërmarrjes publike me ç'rast kemi kërku informacione lidhur me procesin e hapave që janë ndërmarrë për vazhdimin tutje të këtij procesi, gjithashtu kemi kërkuar vazhdimin e bashkëfinancimit edhe përgjatë këtij viti për parkun industrial të Qytagës ku kemi prezantuar edhe paramasën për punët që janë në planifikim për finalizim të infrastrukturës për fazën e parë.

Takime me përfaqësuesit e UNDP-së dhe diskutime lidhur me bashkëpunimin e disa projekteve në fushën e ambientit si dhe në mes tjerash është ofru informacion për qasje në aplikimin për bizneset edhe të Komunës sonë për grantet që ofrohen nga UNDP për bizneset në fushën e Eko Turizmit, shpallje kjo e publikuar edhe në webfaqen e komunës.

Kemi marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Insitituti Kosovar për Qeverisje lokale, punëtori kjo lidhur me prezantimin e Model Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal si dhe kemi pranuar manualin për hartimin e strategjisë në fjalë kur mbaron afati i strategjisë aktuale 2021-2023, bazuar në udhëzuesin e këtij manuali gjithashtu kemi bërë kërkesë për formimin e një grupi punues lidhur me monitorimin e implementimit të planit të veprimit që është në kuadër të strategjisë për vitet 2019-2021.

Takime të zhvilluara me Koordinatorin për komunat si dhe Drejtorin për Shërbim me Konsumator të KEDS ku jemi konsultuar mbi çështjen e pajisjes me nënstacion të trafos për Parkun Industrial – Qytagë si dhe kemi dorëzuar kërkesën për pëlqim elektroenergjetik për Parkun Industrial Qytagë, faza e parë.

Duke u bazu në ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme kemi hartu një kërkesë me anë të së cilës kërkohet formimin e një grupi monitorues për monitorimin e shfrytëzuesve afatgjatë të pronave komunale, me ç'rast si i tillë komisioni është formuar dhe kemi pranuar raportin final nga ana e komisionit.

Kemi marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës në kuadër të kolegjiut për Ekonomi dhe Zhvillim.

Takime me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë si dhe përfaqësues të KIESA ku kemi informuar mbi çështjen e mbarëvajtjes së punëve për Parkun Industrial – Qylagë.

Duke u bazu në ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme kemi drejtuar kërkesë me anë të së cilës kemi kërkuar nga zyra për çështje pronësoro-juridike listën zyrtare për pronat e lira në zonën industriale të Konjuhut, prona këto të cilat nuk kanë konteste gjyqësore si dhe bazuar në shkresën e tyre kemi inicuar procedurat për dhënie në shfrytëzim për 6 parcela.

Takim me Unionin e Turizmit të Kosovës, nga ku është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi, nga memorandumi Komuna përfiton bashkëpunime në projekte të ndryshme që ndërlihen me Turizmin në përgjithësi, mundësinë e pjesëmarrjes në panairë ndërkombetare të turizmit me qëllim promovimin si dhe bashkëpunime me Unionin në përfshirjen e Komunës sonë në sa më shumë paketa turistike të cilat do të përpilohen nga touroperatorët në nivel vendi, njëashtu janë prezentuar materiale për krijimin e një karte të veçantë për Komunën e Lipjanit e cila parashihet të jetë si guidë në aplikacionin e krijuar nga ky union, ku komuna e Lipjanit paraqitet me resurset e saja si dhe informatat që kërkohen nga turistët eventual që kërkojnë me vizituar Komunën e Lipjanit.

Është lansuar thirrje nga organizata ASB PREDA PLUS në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit ku janë dhënë grante për gratë në bashkëfinancim me Komunën si dhe është mbajtur sesion informues për këtë thirrje, përfituese nga Komuna e Lipjanit kanë qenë 6 gra.

Sesione informuese nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për bizneset e territorit të komunës së Lipjanit lidhur me grantet që ndahen nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Takime tjera të vazhdueshme me KIESA në veçanti për temën e parkut të biznesit kemi kërkuar vazhdimin e financimit për Zonën Ekonomike – Qylagë.

Takime me përfaqësuesit e UNDP-së dhe Ministrisë së Kulturës si dhe me banorët e lokalitetit të Janjevës lidhur me projektin për "Rivitalizimin e Janjevës"

Zhvillim i mëtutjeshëm i fazës së parë të ZE Qylagë nëpërmjet Kuvendit për shpalljen e konkursit për pranim të bizneseve.

Aktivitete në fushën e promovimit të turizmit – Përgatitje të videove promovuese për atraksionet tona turistike.

Kemi bërë faturimin e ngarkesave për shfrytëzuesit e pronave komunale.

STATISTIKAT

Zyra për regjistrim të bizneseve për periudhën Janar-Qershor 2022:

1.	Biznese të reja të regjistruara	150
2.	Shuarje e bizneseve	11
3.	Lëndë të refuzuara	0
4.	Ndrimi i Çertifikatave të Bizneseve	35

SFIDAT

Sfidë për qytetarët dhe bizneset mbetet situata e sjellur nga pandemia si dhe rritja e vazhdueshme e çmimeve.

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka zhvilluar aktivitetet si:

- Është proceduar me Aktin për miratimin e taksave nga fusha e ndërtimit për 2022 dhe është pranuar vendimi përkatës nga MMPHI;
- Bazuar në shkresën nga MMPHI dhe në bashkëpunim me Drejtoritë sektoriale është në process përgatitja e Raportit monitorues për informim vjetor për procesin e zbatimit të HZK;
- Është plotësuar Pyetësori për procesin e administratës komunale kërkuar nga USAID;
- Është realizuar takimi punues me USAD-in rreth procesit të legalizimit;
- Është plotësuar Raporti për përmbushjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar – Dhjetor 2021;
- Sipas kërkesave nga Drejtoritë relevante janë hartuar detyrat projektuese për 13 projekte nga fusha e infrastruktures dhe arsimit të planifikuara sipas buxhetit komunal për vitin 2022.

Është filluar procesi për Propozim Vendim për hartimin e PZHK-së dhe për trajtimin e disa përputhjeve të mundshme në kuadër të HZK-së.

- Është përgatitur Propozim Vendim dhe programi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2023 -2031 si dhe propozim Vendim për përmirësimin dhe harmonizimin e disa vlerave të përcaktuara me HZK. Këto dy propozim vendime janë miratuar në Kuvendin e Komunës.
- Është përgaditur Propozim Vendim për shpalljen e 9 objekteve të caktuara si "Monumente të Natyrës" si dhe është publikuar dokumentacioni për shqyrtim publik në faqen zyrtare të Komunës .
- Pjesëmarrja në Komision për hartimin e Raportit për monitorimin e Strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal dhe Komisionin për monitorimin e Kontratave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale.
- Propozimi dhe trajtimi nga aspekti hapësinor për procesin e shpronësimit me qëllim të implementimit të segmenteve rrugore "Bashkim Krasniqi" dhe rruga ndërlidhëse në zonën perendimore të qytetit.
- Trajtimi i Zonës industriale në Lipjan, specifikisht "Zona A" dhe për zonën komerciale në Qyragë, si dhe është hartuar koncepti për zhvillimin e këtyre zonave.
- Pjesëmarrja në punëtorinë e rregullt të Rrjetit të zyrtarëve komunalë për planifikim hapësinor, në kuadër të kolegjumit për planifikim hapësinor të komunave të Kosovës, organizuar nga AKK në kuadër të grant marrëveshjes me projektin GIZ -SPLM.
- Pjesëmarrja në Punëtori – Procesi i legalizimit organizuar nga VORAE.
- Pjesëmarrja në takimin rreth statusit të sistemit të adresave organizuar nga Agjensioni Kadastral i Kosovës.
- Përgatitja dhe prezantimi në Kuvendin e Komunës të propozim Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Trafos në Lipjan sipas zgjidhjes teknike të parashtruar nga KEDS-i.
- Përgatitja e dokumentacionit kadastral për MKRS, përkatësisht për Institutin e Kosovës për
- Trashëgimi Kulturor lidhur me projektin e UNDP për restaurimin e një numri të caktuar të shtëpive në
- Janjevë.
- Pjesëmarrja në Punëtorinë e organizuar nga VORAE në Lipjan përmes Programit KOSINT në temën "Procesi i legalizimit"
- Pjesëmarrja në Punëtorinë përmbyllëse të projektit Planifikimi Hapësinor dhe Menaxhimi i Tokës organizuar nga GIZ.

Projektet:

- Procedimi i Propozim Vendimit dhe programit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal pas vlerësimit nga MAPL dhe miratuar në Kuvendin e Komunës.
- Organizimi i Aktivitetit një ditor për shënimin e Ditës së Tokës.
- Fillimi i hartimit të Planit Lokal të Veprimtari në Mjedis dhe pjesëmarrja në Grupin punues.
- Aktivitetet në kuadër të Standardit ELoGE

- Përgatitja e materialit për shenjëzimin e monumenteve të natyrës;
- Aktivitetet në kuadër të përfundimit të punës komonale 2021;
- Angazhimet në kuadër të komisioneve të ndryshme, legalizim, leje mjedisore komonale dhe komisionin për shitjen e banesave.
- Pjesëmarrja në Komision për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.
- Projektet komonale të parapara për implementim në vitin 2022 janë në proces final të hartimit.

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar lëndët, duke përfshirë kërkesat e pranuar dhe kërkesat e bartura. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsejt 304 kërkesa, kurse të bartura ishin 107 lëndë që rezultoi në total 411 lëndë, prej tyre janë trajtuar gjithsejt 276 kërkesa, prej tyre të miratuara 191 kërkesa, të refuzuara 72 kërkesa, të bartura në sektorë tjerë 2 kërkesa.

Në procedurë të shqyrtimit janë gjithsejt 135 kërkesa. Lëndët sipas natyrës së tyre i kemi prezentuar në pjesën tabelare, si vijon:

STATISTIKAT

Pranimi dhe Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Nr.	Llojet e kërkesave	Nr i kërkesave të pranuar janar - muajit maj	Nr. i kërkesave nga periudha e kaluar	TëPezulluara	Miratuara	Refuzuara	Të bartura në sektor tjera	Në procedurë
1	Kushte ndërtimore	66	11	6	29	35	1	6
2	Leje ndërtimi/renovimi, vendosje e ob. të përkohshme	36	9	1	15	12	0	17
3	Leje rrënimi	3			2	1	0	0
4	Certifikatë përdorimi	5	5		2		0	8
5	LMK	2	1		3		0	0
6	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	32	74	1	12	4	0	86
	Në listë të pritjes				3			
7	Kërkesa të tjera	160	7	3	125	20	1	18
	Gjithsejt	304	107	11	191	72	2	135

DISKUTIME PUBLIKE: Procesi për shpalljen e 9 objekteve si monumente të natyrës.

DREJTORATI PËR GJEODEZI DHE KDASTRË

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë – Zyra komonale Kadastrale e Komunes së Lipjanit, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët, duke ofruar informacione dhe azhurnime të ndryshme sipas detyrës zyrtare.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë kësaj periudhe objektivat tona kryesore kanë qenë kryesisht në ofrimin e shërbimeve profesionale, avancimi profesional i stafit duke mbajtur trajnime, pastaj vazhdimin e bashkëpunimit me Agjencionin Kadastral të Kosovës dhe organizatat tjera në përfitimin e përkrahjes së tyre në realizimin e projekteve të caktuara.

Rritja e të hyrave gjithashtu ka qenë synim i yni. Ndërkohë objektiv tjetër është edhe kthimi i origjinaleve të manualeve dhe regjistrave kadastrale të marrura nga pushteti i atëhershëm, si dhe azhurnimi i të dhënave në modelin digjital, edhe pse në këtë drejtim nuk ka asnjë rezultat konkret, sepse kjo varet nga niveli i institucioneve qendrore.

Në periudhën janar – qershor kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat që kanë qenë kompetencë e drejtoratit tone, kërkesa këto të pranuar në të dy sektorët, sektorin e gjeodezisë dhe të kadastrit.

Sektori i Gjeodezisë

Të dhënat dhe aktivitetet të cilat janë kryer gjatë gjashtë mujorit të vitit 2022 janë të prezentuara në formë tabelare

Nr. i kërkesave të pranuar gjatë këtij gjashtë mujori	Të pezulluara	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë
296	-	290	-	6

Nr.	Llojet e kërkesave	Sasia
1.	Kopje Plani	801
2.	Regjistrim i ndarjeve të Parcelave	270
3.	Marrje të produkteve(pika të detajit)	245
4.	Regjistrim e pjesëve të ndërtesave	6
5.	Bashkim i parcelave	10
6.	Ndërrim i kulturës së parcelave	3
7.	Regjistrim i ndërtesave	-
8.	Rirregullim kufiri	3
9.	Punë për shërbimin pronsoro juridik	16
10.	Historiati i parces	-

Sektori Kadastrit

Të dhënat dhe aktivitetet të cilat janë kryer gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2022 janë të prezentuara në formë tabelare

Nr.	Llojet e kërkesave	Nr. i kërkesave të pranuar gjatë këtij gjashtë mujori	Nr. i kërkesave nga viti i kaluar	Të pezulluara	Të miratuara (kryera)	Të refuzuara	Në procedurë
1	Bartje pronësie	794	0	-	750	2	42
2	Regjistrim të Hipotekave	111	0	0	98	1	12
3	Të tjera, historiat,modifikim i te dhenave, regjistrim i mases se perkohshme	125	0	0	113	0	12
4	Çertifikata të Pronësisë	2216	0	0	2216	0	0
5	Vërtetime për raste sociale	3784	0	0	3781	3	0

Bashkëpunimet

Gjatë periudhës së gjashtë mujorit të vitit 2022 kemi pasur bashkëpunime me institucione dhe organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare; me zyrtarët e agjencionit kadastral kemi mbajtur takime të rregullta për avancimin e punës profesionale në Drejtorat.

Kemi pasur një bashkëpunim dhe koordinim të mirë edhe me Departamentet tjera në kuadër të Komunës, në realizimin e projekteve të përbashkta.

Gjithashtu kemi përmbushur obligimet të cilat dalin si objektiva dhe detyra nga ana e institucioneve qendrore në përmbushjen e obligimeve për integritet evropiane.

DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të Drejtoratit për Infrastrukturë gjatë periudhës janar – qershor 2022, Drejtorati për Infrastrukturë ka kryer aktivitetet të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara.

Kemi pranuar dhe zgjidhur këto kërkesa:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
65	60	0	0	5

Buxheti i Departamentit të infrastrukturës;

Meqenëse departamenti i infrastrukturës është departament i themeluar me ndryshimet statutare të komunës të datës 24.12.2021 ka funksionuar me buxhet të vitit 2022 i aprovuar për departamentin e Shërbimeve Publike. Prandaj ne po paraqesim vetëm buxhetin e investimeve kapitale të paraparë për vitin 2022, për të cilin është përgjegjës departamenti ynë të menaxhoj.

Gjatë kësaj periudhe Janar – Qershor 2022, Drejtorati për Infrastrukturë ka përgaditur dhe proceduar në procedure të publikimit të gjitha projektet e planifikuara në kuader të drejtoratit, që gjithësej janë 22 Projekte, si dhe ka përgaditur paramasat dhe parallogaritë në bashkpunim me shtëpinë projektuese për 14 projekte të cilat janë në kuadër të Drejtorateve të tjera.

Përveq projekteve të parapara në buxhetin e Komunës për vitin 2022, Drejtorati për Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe ka proceduar me kërkesa për projekte tjera me bashkëfinancim siç janë:

Me MAPL në vlerë 40.000 euro projekt dedikuar për komunitetin jo shumicë për asfaltim të rrugicave në Lipjan dhe fshatin Hallaq i Vogël. Në këtë projekt me marrëveshje bashkëfinancimi, Komuna do të participoj në vlerë prej 10.000 euro.

Gjithashtu Kryetari i Komunës ka nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me MMPHI në vlerë 300.000 euro për “Ndërtimi i rrugëve në lagjet e fshatrave Sllovi, Gadime, Smallush, Gomnasellë, Llugagji Babush”, dhe 120.000 për “Rregullimi i Infrastrukturës në Janjevë”, për të cilët pritet zotimi i mjeteve nga Ministria. Lidhur me këto projekte departamenti infrastrukturës ka aplikuar dhe përgaditur gjithë lëndën për procedura të mëtutjeshme të publikimit të projektit. Komuna sipas marrëveshjes së nënshkruar me Ministrinë do të participoj për dy projektet në vlerë prej **494.215,00 Euro** për projektin “Ndërtimi i rrugëve në lagjet e fshatrave Sllovi, Gadime, Smallushë, Gomnasellë, Llugagji Babush”, dhe **50.000,00 Euro** për projektin “Rregullimi i Infrastrukturës në Janjevë

Departamenti i Infrastrukturës ka përgaditur dhe ka aplikuar edhe në institucione të tjera me projekte konkrete si:

- Ministrinë e Zhvillimit Rajonal për projektin: “Ndërtimi i infrastrukturës tek Zona Ekonomike e QMI-së”.
- Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për projektin: “Faza e tretë e ndërtimit të zonës ekonomike në Kerqevë”.
- Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal me projektin: “Rregullimi i hapësirave publike në Komunën e Lipjanit – rreth Shtratit të Lumit Sitnica”.

Drejtorati i Infrastrukturës pas marrjes së grandit të performancës (GPK) në vlerë **1,021,108.38 €**, ka përgaditur projektet dhe ka proceduar për publikim edhe projektet të cilat janë paraqitur në tabelë, ku shihet vlera e participuar edhe nga Komuna e Lipjanit për çdo projekt.

Nr:	Emri i projektit:	Shuma e mbuluar nga buxheti i Komunës në vitin 2022	Shuma e mbuluar nga buxheti i Komunës në vitin 2023	Shuma Totale nga Komuna 2022-2023	Shuma e mbuluar nga GPK	Shuma e përgjithshme e projektit
1	Vazhdimi ndertimit të shtratit të lumit në Gadime	50,000.0€	120,000.0€	170,000.0€	80,000.0€	250,000.0€
2	Rikonstruimi i rrugëve në Ribar të Madh (rr. Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi)	70,000.0€	110,000.0€	180,000.0€	50,000.0€	230,000.0€
3	Shtigjet e ecjes në Gadime faza e dytë	50,000.0€	130,000.0€	180,000.0€	70,000.0€	250,000.0€
4	Rregullimi i shtratit të Lumit Janjevka në lagjen e Konjuhut në Lipjan	70,613.0€	30,000.0€	100,613.0€	150,000.0€	250,613.0€
5	Ndertimi i rrugëve në lagjet e fshatrave Sllovi, Gadime, Smallush, Gomnasel, Llugaxhi, Babush	234,216.0€	260,000.0€	494,216.0€	240,000.0€	734,216.0€
6	Renovimet e shkollave paralele të ndara (Jeta e re, Konjuh, Vershevc, Resinocv, Lluga, Gadime e ulet etj.)	70,000.0€	100,000.0€	170,000.0€	40,000.0€	210,000.0€
7	Përfundimi i punimeve Stadiumi i Magures	20,000.0€	0	20,000.0€	70,000.0€	90,000.0€
8	Zbatimi i masave eficiente në objektin Qendra në Lipjan	20,000.0€	0	20,000.0€	130,000.0€	150,000.0€
9	Anekse të kanalizimit në fshatra; Rubocv, Sllovi, Grack e vogel, Shale, Miren, Glllogocv, Breg i zi, Bujari, Hallaq i Vogel etj.	5,000.0€	0	5,000.0€	30,108.38€	35,108.38€
10	Ndriqimi publik në rrugën Sadik Shala në Lipjan	5,000.0€	0	5,000.0€	30,000.0€	35,000.0€
11	Rregullimi i kulmit në objektin shumë banesore " Shpresa" Lipjan	15,000.0€	0	15,000.0€	25,000.0€	40,000.0€
12	Ndertimi i rrugëve në lagjet e fshatit Krojmir dhe Kraisht faza dytë	65,000.0€		60,000.0€	106,000.0€	171,000.0€
SHUMA TOTALE NGA KOMUNA PËR VITET 2022-2023				1,424,829.0€		
SHUMA E MBULUAR NGA GRANTI I PËRFORMANCËS KOMUNALE (GPK) PËR VITIN 2022					1,021,108.38€	
SHUMA E PËRGJITHSHME E PROJEKTEVE						2,445,937.38€

Gjate kësaj periudhe ndonëse punimet kanë stagnuar për shkak të ngritjes së çmimeve në projektet që kanë qenë në vazhdim nga vitet paraprake, ka mbikqyrjen, dinamikën dhe ecurinë e punimeve në projektet siç janë: Objekti i Administratës së Komunës, objekti i palestrës sportive në Lipjan, rruga "Marie Shllaku" deri në fshatin Rufc, rruga Lipjan-Rubocv, rrugët në lagjen e Akllapit, Asfaltimi i rrugicave në Rubocv, Janjevë, Akllap, Rufc, Banullë, Zllakuqan, Krojmir dhe Vërshevc faza II.

Disa projekte janë duke i zhvilluar punimet në teren, disa janë në përfundim të punimeve, disa projekte janë kontraktuar dhe pritet fillimi i punëve në ditët në vazhdim. Të njëjtën kohë disa projekte janë në Procedurë të prokurimit për shpallje.

Spektori i menaxhimit të projekteve përveq bashkëpunimit në hartimin e projekteve, hartimit të paramasave dhe parallogarive, procedimit të lëndëve në procedura të publikimit, menaxhimit të projekteve në teren dhe pranimit të përfundimit të punimeve, ka kryer edhe punë të tjera në suaza të kompetencave në bashkëpunim edhe me departamentet tjera.

Në kuadër të aktiviteteve të departamentit, veçojmë angazhimin në kuadër të grupit të performancës, pastaj në grupin e punës për ekselencë, në komisione për vlerësimin e dëmeve, në hartimin e rregulloreve dhe strategjive, etj.

Projektet Aktive që janë duke vazhduar punimet në teren janë:

- Ndërtimi i rrugës Hallaq i Madh – Ruc i Ri
- Ndërtimi i rrugës Ribar i Madh – Ribar i Vogël
- Anekset e rjetit të kanalizimit në Lipjan, Gadime, Dobrajë e Madhe faza II
- Ndërtimi i trotuarit me ndriçim publik në Gllavicë – Marevc
- Ndërtimi i shtratit të Lumit në Ribar të Madh
- Shtigjet e ecjes Sllovi
- Ndriçimi publik në Miren
- Ndërtimi i rrethojave dhe infrastrukturës në varreza
- Ndërtimi i trotuarit me ndriçim publik në Qallapek
- Rikonstruimi i rrugës “Zylfie Gashi” në Lipjan
- Ndërtimi i fushave të hapura sportive në Gllavicë dhe Marevc
- Ndërtimi i shkollës në Ribar të Madh

Drejtorati i infrastrukturës ka ndërtuar sistemin elektronik të të dhënave të infrastrukturës në territorin e komunës tonë të cilat të dhëna përditësohen çdo muaj, varësisht nga zhvillimi i ndërtimit të Infrastrukturës në teren. Aktualisht gjendja e infrastrukturës në Komunën tonë është;

Nr	Emertimi	Metra
1.	Rrugë të asfaltuara	60.411,75m
2.	Trotuar të ndërtuar	11.518,00m
3.	Ndriçim Publik	100.239,00m
4.	Kanalizim	8.184,00m

SFIDAT

Rritja e çmimeve në raport me çmimet e planifikuara për projekte (sepse në shtatorin e vitit 2021 është aprovu buxheti për vitin 2022).

Po ashtu sfiduese për realizimin e projekteve mbetet qështja pronësore.

DREJTORATI PËR INSPEKSION

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në Drejtoratin për Inspeksion në këtë gjashtë muaj me shumë fokus është ndjekur planifikimi i bërë në fillim vit. Pjesë determinuse e agjendës ditore kanë qenë edhe ankesat e qytetarëve të cilat ishin të shumta dhe të ndryshme.

Bashkëpunimi me institucioneve Inspektorat, Polici dhe kompania e Pastrimit për këtë gjashtë muaj ishte faktor i rëndësishëm në realizimin e agjendave dhe përgjegjës sa më të shpejtë në ankesat e qytetarëve.

Inspektime brendakompetencës së Drejtoratit komunal të Inspeksionit është realizuar në vazhdimësi dhe në tërë territorin komunal.

Janë inspektuar subjekte të ndryshme afariste (për regjistrimin e biznesit), si dhe pranimet teknike të bizneseve. Janë inspektuar marketet, fokus i inspektoreve ishin punë brendakompetencës: krahasimi i çmimeve raft-arkë, vendosja e flamujve (tregues të origjinës së produkteve), gjithë ashtu në markete, furra të bukës, mullinj është inspektuar edhe çertifikimi i kalibrimit të peshoreve.

Nga janari është ekzekutuar vendimi Nr.333-80223 i datës 26.12.2019 për dislokimin e tregut (për produktet jo-ushqimore). Në vazhdimësi ditëve të hëna janë inspektuar tregu i gjelbër, imobileve dhe tregu i kafshëve, dhe janë evituar të gjitha parregullësit e hasura.

Inspektorati në vazhdimësi ka ndaluar veprimtaritë ilegale si: shitës ambulant, dru shitës (të cilët edhe demtonin hapësirat gjelbëruese duke u parkuar) dhe gjellëtoret pa-leje pune.

Në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Vrell jemi përgjigjurnë kërkesate taksive të shoqatës "Ulpiana" dhe e kemi pasur prioritet problemin e tyre, të cilin problem e shkaktojnë taksit ilegal. Pas angazhimit të vazhdueshëm ky problem tani më është zvogëluar (e që fokusi ynë është ta evitojmë tërësisht).

Kemi inspektuar pompat e derivateve të naftës lidhur me çmimet, sipas Udhëzimit administrativ Nr.03/0222.

Janë inspektuar kompanitë e autobusëve në lidhje me rendin e udhëtimit, është bërë largimi i auto-taksive nga hapësirat publike të cilat i kanë shfrytëzuar për parking. Inspektim është bërë edhe trotuareve të qytetit prej nga janë larguar reklammat e bizneseve dhe kompanitë furnizuese të cilat shpesh e bëjnë bilokimin e trotuareve e sidomos disa kompani të ndërtimit.

Gjatë këtijgjashhtë mujori ju kemi përgjigjur ankesave të shumta të qytetarëve si për ndotje e ujërave të zeza, mos kyçje në kanalizim, ndotja me mbeturina të ndryshme e hapësirave publike dhe private dhe janë penguar deponit ilegale.

Janë marr masa ligjore ndaj bizneseve për menaxhim jo të mirë të mbeturinave.

Për ruajtjen e hapësirave gjelbëruese nga dëmtimet janë shqiptuar vërejtje dhe gjoha disa qytetarëve dhe pronarëve të cilët i kanë parkuar veturën në hapësira gjelbëruese.

Të gjitha bizneset, kafiterit, shitoret që shfrytëzojnë hapësirën publike para lokaleve të tyre janë detyruar të pajisen me pëlqim për shfrytëzimin e hapësirave publike.

Janë kontrolluar objektet e larta ndërtimore në ndërtim e sipër ku janë vërejtur parregullsi rreth mbeturinave të shpërndara në vendpunishte me që rast investitorëve iu është dhënë urdhër që të menaxhohen mbeturinat në mënyrën e duhur, të vendosen në kontejnerderi në përfundim të punimeve.

Në këtë gjatë mujor inspektorët e ndërtimtarisë kanë inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi përgjatë zonave urbanistike ku kanë evidentuar e konstatuar ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi.

Ndaj ndërtimeve pa leje ndërtimi janë marrë të gjitha masat ligjore. Me procesverbal, aktvendim, fletëparaqitje, vendosje të shiritave dhe kallëzime penale, janë penguar ndërtimet pa leje ndërtimi.

Brenda këtyre gjashtë muajve janë bërë katër rrënimë të objekteve të cilat kanë tentuar të ndërtohen pa leje ndërtimi, si dhe janë bërë katër vet - rrënimë.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë gjashtë mujorit të parë janë:

Është bërë lirimi i parkingut publik, nga rezervime personale-biznesore, ndalimi i parkimit të kamionëve nga furnitoret-biznesor në trotuaret e rrugëve, lirimi i hapësirave publike, nga parkimi i parregullt i automjeteve, si dhe ndalimi i parkingut të veturave në parkun në rrugën "Skënderbeu".

Urdhëresa të vazhdueshme për kompanitë që shkaktojnë dëme infrastrukturore gjatë kryerjes së punëve apo intervenimeve.

Inspektimi i auto-taksive lokale, si dhe auto-taksitë që operojnë në ANP-Adem Jashari dhe ndalesa të vazhdueshme dhe ndëshkim për taksitë ilegal.

Zhvendosja e operatoreve-autobusëve (sipas urdhëresës), nga parkingu te shtëpia e kulturës, tek stacioni i autobusëve.

Kemi pasur bashkëpunim me kompaninë KEDS ku kemi bërë largimin e shtyllave elektrike të drurit, që kanë qenë jashtë funksionit e që kanë paraqitur rrezik.

Vërejtje të vazhdueshme për kompanitë që baltosin rrugët gjatë kryerjes së punëve dhe shkresa të shumta drejtuar policisë për asistencë, për rend në komunikacion.

Është bërë Inspektim për zbatimin e orarit të punës nga bizneset, inspektimi i prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit, Inspektimi i furrave të bukës (deklarimi i peshës së bukës, faturat e furnizimit), Inspektimi i mullinjve, Inspektimi i ordinancave private, Inspektimi i autolarjeve dhe mekanikëve, si dhe ndalim i bizneseve ilegale.

Inspektim i vazhdueshëm (ndërtuesve) për zbatimin e lejes mjedisore komunale, ndëshkim për ndotësit e ajrit dhe ndalim i hedhjes së mbeturinave inerte në tokë bujqësore.

Inspektim dhe ndëshkim për marketet të cilat nuk menaxhojnë mbeturinat që shkaktojnë.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Rrëtime të ekzekutuara	Objekte të vetë rrënuara	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Inspektim i raportit final	Pranime teknike me komision	Punë me palë, ankesa, kërkesa	Lendet e pranuar	Lende të pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Gjoha mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Kallëzime penale	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim pa pranim teknik
Biznesi	1194	197	71	8							494	34	1		2025.00€	62	198			129
Ambienti	241	97		3				20			90		6	2				2	21	
Ndërtimi	197	74		7	4	4	18	32	2	2	15	3				6		30		
Trafiku	1166	248		59				413			219	16	15				69		127	
Gjithsej	2798	616	71	77	4	4	18	465	2	2	822	53	22	2	2025.00€	6	131	230	148	129

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur, por kemi mbajtur takime në mënyrë individuale me qytetarë dhe pronar të bizneseve.

TAKIME TË TJERA

Në gjashtë mujorin e parë të këtij viti kemi mbajtur takime me komandantin e zonës kufitare në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari", qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi dhe bashkëpunimi i punëve të përbashkëta rreth disa problemeve të taksive ilegal dhe atyre legal në mënyrë që të sanohen problemet.

Kemi mbajtur takimetë vazhdueshme me komandantin e stacionit policor në Lipjan, qëllimi i takimeve ka qenë koordinimi i disa punëve të përbashkëta, ku inspektorët gjatë kryerjes së disa detyrave të punës kanë nevojë të vazhdueshme edhe për ndihmën e organeve policore edhe pse kjo nuk ka munguar asnjëherë nga Policia e Kosovës në Lipjan.

Kemi mbajtur takim me pronaret e transportuesve publik në bashkëpunim me Policin dhe Drejtoratin e Shërbimeve Publike, me që rast janë diskutuar disa probleme rreth komunikacionit dhe mënyra për ti sanuar ato.

Janë mbajtur disa takime individuale me pronaret e bizneseve si dhe me qytetarë.

SFIDAT

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike se ai plotësojnë kushtet për të ushtruar veprimtarin e tyre biznesore.

Inspektimi i ndërtimeve pa leje ndërtimorepërgjatë zonave urbanistike-ndërtuesedhe parandalimi i tyre duke ndërmarr masa ligjore.

Inspektimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet si dhe mbrojtja e hapësirave gjelbëruese, ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore.

Inspektime të auto-taksive si dhe i firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra.

DREJTORATI PËR BUJQËSI DHE PYLLTARI

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Ky raport bazohet në aktivitetet e bëra gjatë kësaj periudhe për gjasht mujorin e parë të vitit 2022, të parapara sipas planit vjetorë të punës. Brenda kësaj periudhe jemi munduar që t'i realizojmë qëllimet dhe objektivat e parapara të Drejtoratit të Bujqësisë dhe Pylltarisë, konform nevojave dhe kërkesave të fermerëve.

Kemi zhvilluar takime informues për sektorin e Bujqësisë me përfaqësuesit e KFOR-it Turk që operojnë në Kosovë, - në Lipjan. Po ashtu, kemi vazhduar me takim informues me shoqaten e Bletarve për kërkesat dhe mundësit e subvencionimit të kësaj veprimtarie, si dhe kemi pasur takim bashkpunimi me Komandantin e Stacionit Policor në Lipjan, diskutim rreth planifikimeve të përbashkëta operationale në muajt e ardhshëm për sigurimin dhe parandalimin e prerjes ilegale të pyjeve.

Gjatë kësaj periudhe kemi zhvilluar takime pune me Drejtorin e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Fush Kosovë, Gjilan, Shtime dhe Obiliq, për mundësin e bashkpunimit rreth planeve dhe ideve që potencialisht mund të nderlidhen, ndërsa me ftesë të Kryetarit të Komunës së Prishtinës Përparim Rama kemi marrur pjesë në Puntorinë me temën: "qentë endacak dhe komunikacioni ndër-urban".

Gjatë kësaj periudhe është bërë montimi I serave tek fermerët përfitues, ku montimi i 400 serave është bërë sipas afatit të paraparë që ka qenë deri me 30.06.2022.

Duke e parë të nevojshme bashkpunimin me organizata të huaja, si Drejtorat kemi zhvilluar takim pune me Organizaten e IADK-së, rreth projekteve që do të realizohen në të ardhmen. Ndërsa në memorandum bashkpunimi ndërmjet Komunës dhe organizatën "QATAR CHARITY", do të realizohen disa Projekte si: sera dhe mekanizëm bujqësor.

Me këtë dinamik kemi vazhduar duke marrur pjesë në Puntorin e Ministris së Bujqësisë me "Prezentim dhe Diskutim me Komuna të Kosovës për programet vjetore të MBPZHR-së për vitin 2022. Me ftesë të Ministris së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural kemi marrur pjesë në Puntorin e organizuar për hapjen e programit për Pagesa Direkte për fermerët, i cili është hapur me datë 26.04.2022 dhe është përmbyll me datë 01.06.2022.

Gajtë kësaj kohe kemi pranuar dokumentacionin nga blegtorët që kanë aplikuar për cilësi të qumështit dhe të njejtit dokumentacion e kemi dorzuar në Ministrin e Bujqësisë.

Kemi vazhduar duke bërë monitorimin e kulturave bujqësore të mbjellura në vjeshtë,

Duke e parë të nevojshme të dimë sipërfaqen e të mbjellurave për këtë vit, për këto të mbjellura janë: 7917 hektar, ku 4354 hektar janë grur dhe 3060 hektar janë misër, ndërsa 503 hektar janë kultura të tjera.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur reshjet të shiut ku janë përcjell me erëra dhe breshër. Komuna ka formuar Komisionin për vlersimin e dëmëve të shkaktuara nga breshëri. Nga këto të reshura janë prekur disa fshatra, po më të theksuara kanë qenë si: Babushi, Llugaxhia dhe Rubovci.

Në këto fshatrat dëme të konsiderueshme kryesisht ka pasur në perimkultur ndërsa me një përqindje më të vogël në grur dhe misër.

Krahas kësaj, komisioni ka dalur në teren, duke vizituar edhe ata që kanë bërë kërkesa për tu vlersuar, Ky komision i ka verifikuar të gjitha dosjet dhe janë në pritje për të pranuar një rregullore të hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë rreth përcaktimit të çmimëve të produkteve që kryesisht kanë qenë të dëmtuara nga erëra dhe breshëri.

Me të hyrë në muajin Korrik, fillon sezona e korrje-shirjeve dhe si Drejtorat e kemi bërë vendimin për fillimin e korrje-shirjeve për vitin sipas rekomandimeve të Ministris së Bujqësisë. Krahas këtij rekomandimi, kemi formuar komisionin i përbër prej 3 antarëve, që do ta bëjë monitorimin duke përfshirë gjendjen e Autokombjave dhe do të raportojë mbarvajtjen e procesit të korrje-shirjeve.

Sipas vendimit të Drejtoris së Inspeksionit të Pylltarisë dhe Gjuetisë në Prishtinë te datës. 20.01.2022 kemi bërë kërkesë në Drejtorin e Prokurimit për shkëputje të kontratës me Operatorin Ekonomik M.T.SH. LYPETENI KAQANIK. Pas shkëputjes së kontrates operatorit në fjalë, e kemi formuar Komisionin për regjistrim të Pishave ne Gastren 114 në Gadime Kemi bërë kërkesë në Drejtorin e Prokurimit për ankand publik të masës drurore prej 20m².

Kemi pranuar planin vjetor të Shoqates së gjatarve "SOKOLI", të vendgjuetis Lipjani-Lindje, për vitin 2022-2023.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur disa vatra zjarri sipërfaqësore në lokacione të ndryshme.

Kemi vazhduar me revizion në teren si Hanrovci dhe Janjevës dhe ku tashmë ka përfunduar ky proces.

Me kërkesë të agjencionit të Pyjeve, kemi thirrur njoftim public deri me 31.03.2022 për aplikim për prerjen e pyjeve private, dhe kemi pasur gjithsejt 13 kërkesa të cilat 8 janë shqyrtuar dhe janë damku:385.95 m³ dhe është bërë pages prej 5539.58 euro.

Pjesa tjetër e raportit Janar- Qeshor është në formë tabelare.

PASQYRA E SEANCAVE GJYGJËSORE NË GJYKATAT KOMUNALE DHE PËR KUNDERVAJTJE PËR MUAJIN QERSHOR- 2022

Muajt	Kundervajtje	Penale	Civile
Janar- Qeshor	14	5	0
Gjithsejt	19		

RAPORTI I FLETËPARAQITJEVE TË DËMEVE PYJORE PËR MUAJIN JANAR-QERSHOR 2022 E PARAQITUR NË FORMË TABELARE

Njësia Komunal e Lipjan	Lloji i Fletëparaqitjeve	Fletëparaqitjet e ngritura			Fletëparaqitjet e realizuara			Fletëparaqitjet e perealizuara		
		Nr.fletp	Vëllimi në m ³	Dëmi në €	Nr.fletp	Vëllimi në m ³	Dëmi në €	Vëllimi në m ³	Vëllimi në m ³	Dëmi në €
1	2	3	4	5	6	7	8	9 (3-6)	10 (4-7)	11 (5-8)
LIPJAN	Kundërvajtëse	92	136.83	18,297	00	00	00	00	00	00
	Penale	6	19.78	4,794	00	00	00	00	00	00
	Gjithësej	98	156.61	23,091	00	00	00	00	00	00

PASQYRAE AKTGJYKIMEVE- AKTVENDIMEVE GJYQËSORE PËR MUAJIN JANAR-QERSHOR-2022

Nr.		Dënimet e shqiptuara të Gjykatave																
		<i>Pozitiv</i>	<i>Pezullim</i>	<i>Negativ</i>	<i>Deri 100 €</i>	<i>100-200 €</i>	<i>200-300 €</i>	<i>300 – 400 €</i>	<i>Mbi 400 €</i>	<i>Qor. vërejtje</i>	<i>Masë Eduk.i.</i>	<i>Dënimet me kusht</i>	<i>1-3 muaj</i>	<i>3-6 muaj</i>	<i>mbi 6 muaj</i>	<i>Sasia në m³</i>	<i>Dëmi në € nga gjykata</i>	<i>Kompensimi i dëmit në €</i>
1	LIPJAN	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Kundervajtje	70	5	00	00	70	3	00	1	16	00	00	00	00	00	132.57	17.401	00
3	Penale	8	2	00	00	2	00	3	1	2	00	00	00	00	00	25.73	3,836	00
4	Gjithsej;	78	7	00	00	72	3	3	2	18	00	00	00	00	00	158.30	21.237	00

RAPORTI I REGJISTRIMIT TË TERENEVE TË DËMEVE PYJORE PËR MUAJIN JANAR-QERSHOR-2022

Njësia Komunale e APK-së	Njësia Menaxhuese	Rajoni (Tereni)	Gjithësej dëmi			Dëmi i arsytuar me fletëparaqitje			Dëmi i paarsytuar			
			Nr.i trungjeve	m³	€	nr.i fletëparaq.	Nr.i trungjeve	m³	€	Nr.i trungjeve	m³	€
1	2	3	0	6 (10&13)	7 (11&14)	8	9	10	11	12	13	14
LIPJAN	Lipjan	HONROVC	4.733	161.23	24.463	74	1.618	137.49	17.867	3115	23.74	6596
		JANJEVË	11.138	184.84	24.564	90	6.156	165.13	21.869	4.981	19.71	2695
Gjithsejt: Lipjan		00	15.871	346.07	49.027	164	7774	302.62	39.745	8096	156.28	21.393

DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë periudhës së gash të muorit të parë të vitit 2022, ka kryer aktivitetet që ka pasur në plan për këtë periudhë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Janë mbajtur takime me qytetarë që kanë paraqitur kërkesat individuale, grupore nga përfaqësuesit e vendbanimeve të caktuara si dhe janë dhënë përgjigje kërkesave të parashtruara.

Është raportuar në stacionin policor për dëmtimin e dy shtyllave përgjat rrugës "Shqipëria" dhe "Haredin Bajrami" dhe në rrugë tjera, si dhe kërkesë për lirim të rrugës "Skenderbeu" për krasitjen e drunjëve, si dhe është bërë krasitja e drunjëve dekorativ në rrugë të qytetit dhe në sheshin "Adem Jashari".

Është shpallur njoftimi publik për transportin e udhëtarëve me automjete taksit, është përgaditë dhe është bërë shpallja publike për ndarjen e orareve të rrendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus, është formuar komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e orareve të rrendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus, si dhe është formuar komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të transportit të udhëtarëve me automjete taksit. Bazuar në shpalljet publike janë ndarë rendet e udhëtimit operatorëve të transportit të udhëtarëve me autobus dhe janë licensuar taksit për ushtrimin e veprimtarisë.

Është formuar komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për shfrytëzim të hapësirave publike, si dhe kemi kërkuar nga Drejtorati i Inspeksionit për inspektim të bizneseve të cilat shfrytëzojnë hapësirat publike.

Janë bërë intervenime në rrjetet e kanalizimit në fshatrat: Gadime e Ultë, Ribar i Madh, Torinë, Banullë, Dobrajë, Lipjan, Smallushë, Shalë, Krojmir, Resinocv, Grackë e Vogël, Topliqan, Smallushë, Kraishtë, Bainsë, Mirenë, etj.

Janë bërë intervenime në rrjetin e ndriçimit publik: në rrugët e qytetit dhe në rrugët e fshatave ku shtrihet rrjeti i ndriçimit publik, janë ndërruar poqat e djegur, siguresat, kontaktorët dhe elementet tjera përcjellëse. Është intervenuar në shtylla të aksidentuara dhe është bërë riparimi i tyre.

Janë bërë kërkesa KEDS-it për kyqje të njësorve të rinj elektrik dhe është bërë barazimi me KEDS, i fakturave të ndriçimit publik.

Është bërë vendosja e kapakëve të pusetave në disa rrugë të qytetit.

Janë menaxhuar Kompanitë sipas loteve të ndara për pastrimin e borës në rrugët e qytetit dhe në fshatra: KRM Pastrimi, NJO Lipjan për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror brenda në qytet Loti 1, mbikqyrja e kompanisë Gashi Eg Loti 2 pastrimi i borës në anën lindore dhe mbikqyrja e kompanisë Via Egnatia Loti 3 pastrimi i borës në anën perendimore. Po ashtu është bërë mbikqyrja e kompanisë KRM "Pastrimi" e cila bënë menaxhimin e tregjeve. Gjithashtu është bërë barazimi i të hyrave nga inkasimi i mjeteve nga hapësirat publike si dhe i të hyrave nga tregjet.

Gjatë kësaj periudhe raportuese si drejtorat jemi angazhuar edhe në mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike në qytetin e Lipjanit, mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit veror, mirëmbajtja e varrezave në Komunën e Lipjanit, mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes dhe bicikletave, mirëmbajtja dhe pastrimi i lumenjëve në Komunën e Lipjanit si dhe mirëmbajtja e ndiçimit publik në qytet dhe në fshatra.

Aktivitetet e veçanta

Ndër aktivitetet e Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim që karakterizojnë periudhën kohore të raportimit janë:

- Kërkesë QRA Lipjan për numrin e veturave të regjistruara gjatë vitit 2021.
- Është miratuar Plani i orareve të rrendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus.
- Është bërë përgatitja dhe janë plotësuar formularët për performancë komunale

STATISTIKAT

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
254	163	//	64	27

Pasqyra e aktiviteteve të DSHPMSh-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr. i aktiviteteve
1	Kërkesa, përgjigje, njoftime, vendime, pëlqime të ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	183
2	Përgatitja e paramasave dhe parallogarive	4
3	Vizita në terren	274
4	Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme	2
5	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve	11
6	Mbikqyrja e kontratave kornizë	12

Njësia profesionale e zjarrfikësve ka kryer aktivitet dhe interevnimet në teren sipas kërkesave dhe informatave të marura nga qytetarët

Intervenimet e NjPZSh Lipjan, Janar- Qershor 2022

Lloji i Interven/ muaji	I	II	III	IV	V	VI	Gjithësejt
1 Zjarre	12	10	39	23	16	20	120
Shtëpi banimi/ oxhak	4	2	2/1	2			
Shtëpi ndihmëse			2	2			
Objekte afariste/ industriale*		1		1			
Male/ pemishte		2	18/1	6	5		
Ushqim bagëtish/grunajë*						1	

Bari i thatë/ sternishtë	1		7	2	2	11			
Goma / Mazut *	2	1		1					
Mbeturina - Kontejnerë*	2	2	5	4	6	6			
Trafo /gjenerator */ngrohtor						1			
Orë rryme/ bomb.gazi*	1	1	1	1*	2				
Instalime të rrymës	2								
Shtylla			1	1	1				
Automjete/ kamion*			1	3					
Dru për ngrohje/ thëngjill *		1				1*			
2	Intervenime Teknike		3	3	5	4	4	4	23
Aksidente komunikacioni	2	3	1	1	3	1			
Automjete									
Hapje dyersh/ashensor*	1		1*		1	2			
Rrëtime/ Kulmi i nd.kolektive			3	2					
Intervenime tjera teknike				1		1			
3	Shërbime		2	1		2	3	8	
Furnizime me ujë	2					2			
Pastrim rrugësh/dezinfekt.		1			1	1			
prerje-largim drunjesh					1				
4	Shpëtime					1			
Shpëtime kafshësh					1				
Ushtrim në Aeroport /me nxënës*						2	2		
Alarme të rreme	2				1	1	4		
Zjarre	12	10	39	23	16	20	120		
Shërbime		1		2	2	3	8		
Shpëtime					1		1		
Intervenime Teknike	3	3	5	4	4	4	23		
<i>Gjithsejt</i>	<i>17</i>	<i>14</i>	<i>44</i>	<i>29</i>	<i>24</i>	<i>30</i>	<i>158</i>		

DREJTORATI I PROKURIMIT

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në këtë raport, janë të përfshira të gjitha aktivitetet e prokurimit që Autoriteti Kontraktues – Komuna e Lipjanit ka zhvilluar gjatë kësaj periudhe gjashtëmuajore, për të gjitha kategoritë e shpenzimeve, për mallra, shërbime dhe punë, duke përcjellur planin e punës dhe planin e prokurimit.

Drejtorati i Prokurimit ka përgatitur raportin vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik të Komunës së Lipjanit për atë vit kalendarik.

Ky drejtorat ka një shkallë të lartë të përgjegjësisë për të siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit dhe menaxhimit të fondeve publike.

Drejtorati i Prokurimit gjatë kësaj periudhe ka bashkëpunuar ngushtë me AQP-në, për të ofruar informata të nevojshme për te, kur AQP-ja në planin e saj ka udhëheqjen e prokurimeve të centralizuara për nevoja të autoriteteve kontraktuese të nivelit lokal ose atij qendror, ashtu sikurse është rregulluar me dispozitat e nenit 94 dhe 95 të LPP-së. Po ashtu bashkëpunimi ka vazhduar edhe me organizatat e caktuara jo qeveritare mbi bazën e marrëveshjeve së bashkëpunimit e lidhur mes Komunës së Lipjanit, e cila në fokus ka bashkëpunimin, ofrimin e ndihmës dhe monitorimin e aktiviteteve të punës, me theks të veçantë trajnimin e stafit për kryerjen me sukses të aktiviteteve të punës, hapje tenderëve, vlerësim dhe menaxhim të kontratave dhe punë tjera të nevojshme.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë kësaj periudhe raportuese, shenojmë këto aktivitete të Prokurimit:

- Në AQP, kemi dërguar **Planin e Prokurimit për Vitin Fiskal 2022**,
- Në KRPP, kemi dërguar **Raportin Vjetor të Kontratave të nënshkruara Publike për Vitin 2021**
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit nga kërkesat e njëjësive kërkuese,
- Ankande Publike
- Hapje dhe vlerësim të tenderëve dhe Ankandëve Publike

Kontratat e negociuara:

1. "Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuarëve gjatë sezonit veror (fshirja e rrugëve) në komunën e Lipjanit, zona urbane.
2. Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të institucioneve të komunës së Lipjanit.
3. Kontrollimi i dozimetrave.

Njoftim për nënshkrim të Kontratës

Nr	Lënda e prokurimit	Data e Nënshkrimit
1	Furnizim me Peme dhe Perime	25.05.2022
2	Servisimi i Rregullt i gjeneratorit në SHMU, në Magure	01.06.2022
3	Rregullimi i Kulmit të Objektivit e Bujqësisë Shkolla Adem Gllavica	20.04.2022
4	Furnizim i IEA me perde sheritore mbajtës për perde dhe projektor	23.03.2022
5	Instalimi i GPS, dhe mirëmbajtja e tyre në veturat e Komunës	13.04.2022
6	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në Sllovi	20.04.2022
7	Furnizimi i qerdheve dhe kabineteve në disa shkolla me tepison tepi për dysheme- kontratë kornizë	10.06.2022
8	Transporti i nxenesve me nevoja te veçanta ne relacionin nga vendbanimi deri ne shkolle dhe asjelltas	09.03.2022
9	Rikonstruimi i rrugës Zylfie Gashi në Lipjan	12.04.2022
10	Ndërtimi i rrugës Hallaq i Madh - Rufe i Ri	29.04.2022
11	Ndërtimi i shkollës në Ribar të Madh	02.06.2022
12	Ndërtimi i rrugës Ribar i Madh-Ribar i Vogël	20.04.2022
13	Ndërtimi i rrjetit të ndriqimit publik Lot1 Në fshatin Mirenë ;	18.06.2022
14	Ndërtimi i trotuarit me ndriqim publik ne Gllavice-Marevc Llot1	20.04.2022
15	Ndërtimi i Trotuarit me ndriqim publik ne Qallapek Llot 2	29.04.2022
16	Furnizimi me oksigjen medicinal për QKMF-LIPJAN - Ritenderim	11.05.2022
17	Furnizimi me bomba të Oksigjenit medicinal për QKMF-LIPJAN	19.05.2022
18	Kryerja e shërbimeve të DDD në IEA-Lipjan	13.04.2022
19	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale-Ritenderim	15.06.2022
20	Ndërtimi i shtratit të lumit në Ribar i Madh	13.05.2022
21	lot 1 dhe llot 2 Angazhimi i konsulentëve për shërbime te veqanta në Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm	06.04.2022
22	Furnizimi me pjesë të imta për mirëmbajtjen e objekteve shendetsore QKMF,QMF DHE AMF.	11.05.2022
23	Kontrollimi i dozimetrave	28.04.2022
24	Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të institucioneve të Komunës së Lipjanit	07.06.2022
25	Ndërtimi i fushave të hapura sportive në Gllavicë dhe Marevc	13.05.2022
26	Renovimi i kulmit të objektit të familjeve të Dëshmorëve	18.05.2022
27	Shqyrtimet Gjeomekanike dhe Gjeoteknike te projektit te egzekutuar Ndertimii shtigjeve te ecjes rreth shtratit te lumit Sitnica faza dyte	01.06.2022
28	Organizimi i puntorisë për implementimin dhe monitorimin e strategjisë 2019-2023	18.06.2022
29	Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapsirave tjera në qytetin e Lipjanit	24.06.2022
30	Ndërtimi i ulseve për shikues dhe vendosja e barit artificial në fushat e Hapura Sportive	28.06.2022
31	Ndërtimi i rrethojave dhe infrastrukturës në varreza - Janjevë	14.06.2022
32	Ndërtimi i anekseve të rrjetit të Kanalizimit në Lipjan, Gadime, Dobrajë e Madhe	08.06.2022

33	Transporti i nxënësve për testin e arritshmërisë të SHFMU -ve të Komunes Lipjan në relacione nga shkolla amë deri në qendrën e testimit & anasjelltas.	25.05.2022
34	Furnizim me Peme dhe Perime II	21.02.2022
35	Shërbimet e akomodimit dhe fjetjes së rezidentëve të Shtëpisë së Komunitetit gjatë muajit maj dhe muajit tetor	25.05.2022
36	Organizimi i puntorisë për plotsimin e standartit ELoGE	05.07.2022
37	Furnizim me pajisje teknologjike -Laptop	23.06.2022
38	Organizimi i puntorisë tri ditore për komisionin e SMPK-së	04.05.2022
39	Furnizimi i IEA me Inventor, akumulator për inventar dhe gjenerator kontratë kornizë	20.04.2022
40	Furnizimi me autoambulancë	22.06.2022
41	Mirmbajtja dhe pastrimi i rrugëve gjatë sezonit verorë në qytetin e Lipjanit	21.02.2022

ANKANDE PUBLIKE

Shitja e drunjëve të pa prera

SFIDAT

Sfidat kanë qenë të natyrave të ndryshme:

Mosfunksionimi i bordit të Organi Shqyrtues i Prokurimi (OSHP), ka sjellur pasoja në mos lidhjen e kontratave duke pritur vendime të tyre, gjithashtu kërkesat për Ri-shqyrtim nga OE në vlerësimi të ofertave nga Drejtoria e Prokurimit. Inflacioni apo ngritja e përgjithshme e çmimeve ka shkaktuar shumë pasiguri në aspektin e kryerjes së punimeve nga kontratat nga vitet paraprake, dhe disa nga aktivitetet për vitin 2022, janë Ri-tenderuar si pasojë e ngritjes së çmimeve.